


# Forcimi i kulturës gjyqësore si mjet për zbatimin e efektshëm të reformës në drejtësi dhe roli i ILD





Kingdom of the Netherlands

# Forcimi i kulturës gjyqësore si mjet për zbatimin e efektshëm të reformës në drejtësi dhe roli i ILD

## Autorë

Ilvana Dedja  
Anila Shehi (Dollani)  
Nino Strati

## Rishikim i brendshëm

Arjan Dyrmishi

## Design and layout

Ergys TEMALI

## Images

unsplash.com



© December 2023, Center for the Study of Democracy and Governance (CSDG)

### **Acknowledgments**

This policy paper is produced by the Center for the Study of Democracy and Governance in the framework of the project “Improved Policy Debate and Accountability to Delivering on Fundamentals First, through the Establishment of Cluster One EU Negotiations Platform – Albania (C1-EU-NPA)” with the support of the Netherlands Embassy in Tirana.

### **Disclaimer**

The opinions, findings and recommendations expressed in this publication are those of the author and do not necessarily reflect the opinions or views of the Netherlands Embassy in Tirana.



# Tabela e përmbajtjes

Shkurtime.....	5
Përmbledhje ekzekutive .....	7
1 Hyrje .....	12
1.1 Prezantimi i dilemës kërkimore.....	15
1.2 Pyetja(et) kërkimore .....	16
1.3 Metodologjia .....	17
1.4 Qëllimi i studimit.....	20
1.5 Struktura .....	20
2 Standardet e pavarësisë dhe kulturës së pavarësisë së gjyqësorit .....	22
3 Vështrim historik mbi mandatin kushtetues dhe statusin e pavarësisë së strukturave gjyqësore gjatë tranzicionit .....	36
4 Inspektori i Lartë të Drejtësisë .....	44
4.1 Statusi dhe mandati kushtetues i ILD .....	47
Statusi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë .....	47
Mandati i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë .....	48
4.2 Roli dhe performanca e ILD.....	50
4.3 ILD si një institucion kyç për të promovuar dhe mbrojtur kulturën gjyqësore dhe pavarësinë e institucioneve gjyqësore .....	61
5 Formalizmi dhe mungesa e mendimit kritik, si karakteristika të kulturës .....	68
6 Përfundime .....	71
7 Rekomandime .....	72
Bibliografia .....	76



## Shkurtime

BE	Bashkimi Evropian
CEPEJ	Komisioni Evropian për Efiçencën e Drejtësisë
DUDNJ	Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut
GJEDNJ	Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut
GJK	Gjykata Kushtetuese
GjL	Gjykata e Lartë
ILD	Inspektori i Lartë i Drejtësisë
ILDKPKI	Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesave
KE	Komisioni Evropian
KED	Komisioni i Emërimeve në Drejtësi
KEDNJ	Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut
KiE	Këshilli i Evropës
KLD	Këshilli i Lartë i Drejtësisë
KLJG	Këshilli i Lartë Gjyqësor
KLP	Këshilli i Lartë i Prokurorisë
KPK	Komisioni i Pavarur i Kualifikimit
MD	Ministria e Drejtësisë
OJF	Organizata Jo Fitimprurëse
ONM	Operacioni Ndërkombëtar i Monitorimit
PP	Prokurori i Përgjithshëm



*"Disa standarde mund të parashikohen nga ligji, por fryma dhe cilësia e shërbimit të ofruar nga një profesion varet shumë më tepër nga respektimi i standardeve etike. Këto janë shumë më rigorozë se standardet ligjore... Ato mësohen jo nga parimet, por nga shembulli dhe ndikimi i kolegëve të respektuar. Standardet gjyqësore fitohen, si të thuash, me osmozë profesionale. Ato zbatohen menjëherë nga ndërgjegjja."*

Justice J.B. Thomas i Australisë<sup>1</sup>

---

<sup>1</sup> Judicial Ethics in Australia, 2d ed. Sydney: LBC Information Services, 1997, cituar në CoE, "Magistrates ethics and deontology". <[https://www.coe.int/t/dghl/cooperation/lisbonnetoork/themis/Ethics/Paper2\\_en.asp](https://www.coe.int/t/dghl/cooperation/lisbonnetoork/themis/Ethics/Paper2_en.asp)>



## Përmbledhje ekzekutive

Në lëmin e studimeve dhe raporteve mbi sistemin e drejtësisë në Shqipëri dhe reformat e kryera, fokusi është vendosur kryesisht në elementë, si strukturat, baza ligjore, mandati kushtetues, ndikimi politik, apo dhe korrupsioni, ndër elementë të tjerë.

Duke njohur tre periudha kryesore të ndryshimeve substanciale të sistemit gjyqësor, periudhën 1991-1998 (*si periudha pas rënies së sistemit monist, dhe fillesave të ngritjes së modelit të parë të gjyqësorit demokratik*), 1998-2016 (*periudha e cila nis me miratimin e Kushtetutës së parë, dhe përfundimit me kritikën për mosarritjen e garantimit të pavarësisë së gjyqësorit*), dhe 2016- në vijim (*e njohur ndryshe, si periudha e reformës në drejtësi*), ky studim fokusohet tek kultura e gjyqësorit, si kuadër analitik dhe indikator për të vlerësuar ecurinë e reformës.

Gjatë 30 viteve të fundit në Shqipëri, janë zbatuar modele të ndryshme me qëllim gjetjen e qasjes së duhur në mënyrë që dega e gjyqësorit të garantojë pavarësinë e duhur. Në një periudhë në tjetrën, me synimin për të arritur këtë qëllim janë përcaktuar kompetencat, institucionet, dhe struktura.

Debati në vitet që nga fillimi i zbatimit të reformës është fokusuar tek diskutimi se sa ndryshimi i strukturës së qeverisjes së gjyqësorit, krijimi i institucioneve të reja të drejtësisë, ka arritur të adresojë problemet e evidentuara në sistemin pararendës, si: *"keqfunksionimi, mungesa e integritetit dhe e profesionalizmit, korrupsioni, pavarësia, eficienta, besueshmëria, transparenca, llogaridhënia dhe përgjegjshmëria"*.

Me qëllim dhënien e kontributit në debatin se jo në çdo rast përcaktimet ligjore për ndarjen e gjyqësorit si degë më vehte përkthehen në pavarësi, ky dokument synon të nxjerrë në pah rëndësinë e kulturës gjyqësore. Në bazë të gjetjeve të kësaj analize, duke evidentuar mungesat dhe pikat e forta të sistemeve të mëparshme, fokusi vendoset tek Inspektori i Lartë i Drejtësisë si institucion i cili mund të ndikojë pozitivisht në forcimin e kulturës së pavarësisë si objektiv dhe tregues i zbatimit të efektshëm të reformës. Kjo pasi ILD ka një rol kyç në forcimin e kulturës së integritetit në sistemin gjyqësor, rrjedhimisht, ky institucion mund të ndikojë në përmirësimin e kulturës gjyqësore në përgjithësi. Më konkretisht Shqipëri në këto drejtime:

- Me kryerjen e hetimeve, ankesave, dhe adresimin e shkeljeve etike, ILD-ja përforcon rëndësinë e sjelljes etike mes gjyqtarëve, e cila është integrale për të forcuar kulturën e integritetit dhe nxitur një kulturë pozitive gjyqësore;
- ILD mund të promovojë organizimin e trajnimeve të dedikuara për anëtarët e gjyqësorit me fokus forcimin e kulturës së pavarësisë së gjyqësorit.



- ILD mund të propozojë politika ose udhëzime që synojnë forcimin e kulturës gjyqësore, që mund të përfshijnë kode sjelljeje, praktika të mira, ose rekomandime drejtuar gjykatave, prokurorive dhe këshillave, për promovimin e një gjyqësori të drejtë, transparent dhe të pavarur;
- Gjithashtu, duke siguruar procese transparente për hetimet e kryera mbi ankesat e depozituara te ILD-ja, ai mund të nxisë kulturën e llogaridhënies brenda gjyqësorit.
- Duke evidentuar problematikave në lidhje me shkelje të vazhdueshme të disiplinës parë nga këndvështrimi kulturor, ILD mund të propozojë dhe iniciojë bashkëpunime brenda gjyqësorit, si me Këshillat dhe me prokurorinë, për të advokuar mbi reforma dhe praktika që mbështesin një kulturë gjyqësore pozitive.

Ideja qendrore e këtij diskutimi është se ILD-ja është në pozicionin më të mirë në sistemin gjyqësor për të ndikuar në elementët e sipërpërmendur, dhe përmirësimin e kulturës gjyqësore, e cila reflekton ndikimet historike, sociale dhe ligjore që i japin formë sjelljeve dhe qasjeve së individëve brenda gjyqësorit, si dhe gjyqësorit në tërësi.

Në vitet e fundit janë bërë përpjekje për të përmirësuar kulturën gjyqësore në Shqipëri, duke synuar nxitjen e transparencës, llogaridhënies dhe profesionalizmit brenda gjyqësorit. Kjo përfshin promovimin e vlerave të tilla si drejtësia, paanshmëria dhe respektimi i shtetit të së drejtës ndërmjet gjyqtarëve dhe profesionistëve të ligjit; pavarësisht kësaj, besimi në institucionet e drejtësisë vazhdon të jetë i ulët.

Gjithsesi, gjetjet e këtij hulumtimi tregojnë se ndryshimi i ligjeve mund të ndikojë në sjelljen e gjyqësorit, por jo gjithmonë kjo mund të përkthehet në mënyrë të drejtëpërdrejtë në ndryshime të menjëhershme ose gjithpërfshirëse në sjelljen ose kulturën e gjyqësorit. Ndërsa reformat ligjore përcaktojnë kornizën dhe udhëzimet për mënyrën se si duhet administruar drejtësia, zbatimi dhe ndikimi aktual varen nga faktorë të tillë, si interpretimi dhe zbatimi i ligjit, kultura institucionale, shkalla dhe cilësia e arsimit dhe trajnimit, zbatimi i ligjeve, si dhe perceptimi dhe besimi i publikut mbi sistemin gjyqësor.

Risia e këtij studimi konnsiston në faktin se këta elementë janë analizuar dhe gjetjet janë evidentuar për të indentifikuar çështje për diskutim dhe rekomandime.

Së pari, reforma në drejtësi solli një ndryshim në strukturën e gjyqësorit, nëpërmjet themelimit të institucioneve të reja, siç janë Këshilli Gjyqësor i Lartë, Këshilli i Lartë i Prokurorisë dhe Inspektori i Lartë i Drejtësisë. Këto institucione u krijuan me detyrën kryesore për të rritur pavarësinë dhe profesionalizmin e gjyqësorit.





Pavarësisht kësaj, praktikat dhe kulturat e rrënjosura historike brenda gjyqësorit, si nepotizimi, korrupsioni apo ndikimi i paligjshëm, janë shfaqur si faktorë që i rezistojnë ndryshimit të menjëhershëm. Edhe me një kuadër ligjor gjithëpërfshirës, elementë kulturorë si hierarkia, zakonet, si dhe rrjetet informale, ndikojnë në rezistencën ndaj ndryshimit pozitiv.

Së dyti, perceptimet e kaluara dhe eksperiencat e lidhura me korrupsionin në sistemin gjyqësor ndikojnë në besimin e qytetarëve tek sistemi gjyqësor. Pavarësisht reformës, akoma ekzistojnë shqetësime mbi prezencën e korrupsionit apo ndikimit të paligjshëm në sistemin gjyqësor. Për këtë arsye, institucionet e sistemit gjyqësor nuk mundet të konformohen në premisën se ndryshimi i kuadrit ligjor, do të rezultojë në rritjen e besimit të publikut në sistemin gjyqësor. Sistemi gjyqësor, dhe specifikisht, secila pjesë përbërëse e saj, ka nevojë të ketë një nivel më të lartë transparence në lidhje me proceset dhe vendimarrjen e tyre. Gjithashtu, përpjekjet për përmirësimin e kulturës gjyqësore mund të arrihen duke përmirësuar besimin e publikut në sjelljen dhe praktikën e gjyqësorit.

Së treti, nga interpretimi përgjigjeve gjatë përpjekjes për të intervistuar gjyqtarë, prokurorë, dhe anëtar KLGJ apo KLP, mund të dilet në konkluzionin se disa prej të intervistuarve nuk ndihen mjaftueshëm të lirshëm dhe të sigurtë në shprehjen e mendimit të tyre. Në disa raste, funksionarët e gjyqësorit mund të ndihen të kufizuar për të shprehur opinionet e tyre në lidhje me gjyqësorin, për disa faktorë të ndryshëm, si: (i) frika se mund të përballen me pasoje ose 'hakmarrje' nëse shprehin kritika ndaj sistemit duke ndikuar në karrierën e tyre; (ii) mungesa ose efektiviteti i sinjalizuesve brenda gjyqësorit që mund të pengojë individë të flasin kundër çështjeve ose vlerave anti-kulturore që mund të dëshmojnë brenda sistemit; (iii) struktura hierarike ose norma kulturore mbizotëruese brenda gjyqësorit mund të dekurajojnë diskutimet e hapura dhe debatin konstruktiv; (iv) presionet e jashtme, duke përfshirë ndikimet politike, mund të kufizojnë lirinë e anëtarëve të gjyqësorit për të shprehur mendimet e tyre të vërteta si dhe (v) mungesa e platforma të pavarura që u japin mundësinë anëtarëve të gjyqësorit për të shprehur mospajtimet e tyre në një mënyrë të sigurtë.

Gjithashtu, pavarësisht ndryshimeve ligjore dhe zhvillimit shoqëror ende nuk ka një shkëputje nga mendësia e varësisë nga politika. Pavarësisht se modeli i ri i qeverisjes gjyqësore krijon mundësi për të garantuar kulturë të re të pavarësisë së gjyqësorit, ai vijon të ketë nevojë për ndryshime ligjore si pasoje e vakumeve ligjore ekzistuese. Një rast që mund të përmendur për të përkrahur këtë gjetje është ekzistenca e evidentuar gjatë intervistave për një trinitet në konkurrencë të vazhdueshme "Prokurori i Përgjithshëm, Këshilli i Lartë i Prokurorisë dhe Drejtuesi i SPAK" për të cilët ligji jo vetëm nuk parashikon cili organ është i pavarur nga tjetri por me ndryshimet e fundit ligjore të vitit 2023, fuqizohet roli i "Prokurorit të Përgjithshëm" i cili ndërhyr në karrierën e magistratëve duke përmbysur kështu konceptin e ashtuquajtur të "decentralizimit".



Së katërti, prezantimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë si një institucion kyç që mundet të ndikojë thellësisht në përmirësimin kulturës së pavarësisë së gjyqësorit në vend konsiderohet një sfidë herkuliane, nëse nuk merren në konsideratë elementët e tjera të ekuacionit. Në përgjithësi, kuadri ligjor për sistemin e disiplinimit dhe sanksionimit të magjistratëve konsiderohet si i plotë. Gjithashtu, kuadri ligjor në fuqi për garantimin e pavarësisë dhe ndarjes së ILD-së është i përshtatshëm. Por, ILD aktualisht ka mungesa në radhët e inspektorëve me profil gjyqtar, e cila është një çështje që i duhet dhënë prioritet. Gjithashtu, ILD ka nevojë për më shumë burime njerëzore dhe staf të specializuar. Elementi i mungesës së pavarësisë financiare është evidentuar si shqetësues si gjatë intervistave, dhe fokus-grupit.

Së pesti, aktorët që e kanë detyrim ligjor 'referimin', si drejtuesit e prokurorive edhe gjykatave, Prokurori i Përgjithshëm apo Ministri i Drejtësisë, duhet të jenë më proaktiv. ILD mund të vlerësojë ankesat e dërguara te institucioni si në nivel personal, por dhe institucional. Në rast se ndodhin sjellje në kundërshtim me ligjin dhe normat kulturore në vijueshmëri, titullari i institucionit ose personat në hierarki të cilët kanë detyrimin ligjor për të monitoruar administrimin e drejtësisë në mënyrë të rregullt, ILD mund të hetojë vetë kontekstin e lejitimit të shkeljes së disiplinës nga subjekti i hetimit.

Së gjashti, në rast se pavarësia individuale dhe institucionale e gjyqësorit mbetet formalisht e lidhur me parashikimet ligjore, dhe nuk kthehet në një element kyç të kulturës gjyqësore, ky sistem mund të mos e përmbushë misionin e dhënë nga kushtetuta dhe ligjet.

Përsa i përket diskutimit në këtë hulumtim, boshti kryesor në lidhje me përmirësimin e kulturës gjyqësore ka të bëjë me ndryshimin e botëkuptimit se ndryshimi i ligjit sjell në mënyrë automatike ndryshimin e kulturës, të formësuar nga sjellje, zakone dhe norma historike, sociale dhe ligjore të kultivuara prej dekadash. Kështu, pritmëria se ndryshimet në Kushtetutë dhe ligjet vijuese pas vitit 2016, ku parashikohet një sistem i pavarur i pandikuar nga politika apo ndikime të tjera të paligjshme, është disi abstrakte nëse nuk pasohet dhe nga vëmendja e duhur tek ndryshimet kulturore brenda gjyqësorit.

Në këtë linjë arsyetimi, ky dokument propozon rekomandimet:

- Edukimi është baza mbi ku mund të ngrihet reformimi i kulturës gjyqësore. Trajnimet dhe programet arsimore duhet të përfshijmë elementet e duhur të formimit për krijimin e një kuptimi më të thellë mbi kulturën e pavarësisë gjyqësore. Gjithashtu, këto programe afatgjata trajnimi, me fokus përforsimin e vlerave të kulturës gjyqësore në vend, duhet të përfshijnë trajnime dhe seminare praktike mbi etikën profesionale dhe integritetin,



pavarësinë gjyqësore, komunikimin transparent, dhe respekti mbi sundimin e ligjit.

- Promovimi i rëndësisë së një kulture gjyqësore të fortë, që ka në fokus advokimin mbi pavarësinë, integritetin, dhe sjelljen etike. Kjo mund të arrihet nëpërmjet fushatave ndërgjegjësuese, forumeve, dhe bashkëpunimeve me organizata ndërkombëtare ose ekspertë që specializohen në zhvillimin e kulturës gjyqësore.
- Përmirësimin e dialogut dhe bashkëpunimit ndërmjet ILD, KLGJ dhe KLP mbi rëndësinë e përmirësimit dhe mënyrës së përmirësimit të kulturës gjyqësore në institucionet e tyre, si reflektim i gjyqësorit në tërësi.
- Për të adresuar problemet me kuptimin, interpretimin dhe aktualizimin e pavarësisë e gjyqësorit krahas forcimit të pavarësisë finaciare, duhet të rritet bashkëpunimi ndërinstitutional, të zhvillohen fushata sensibilizimi dhe edukim ligjor ne komunitet, magjistratët të përfaqësohen në shoqata të vetme dhe jo të fragmentarizuara, të forcohet parimi i meritokracisë në promovim dhe trajtim financiar, si dhe të përzgjidhen kandidatë me nivel formimi të lartë dhe cilësor;
- Në mënyrë të tillë që vendimmarrja të jetë më cilësore, nevojitet që magjistratëve t'u plotësohen kushtet të punojnë me ngarkesë optimale, si dhe zhvillimin e kushteve adekuate për promovimin e vlerave dhe parimeve të pavarësisë së gjyqësorit.

Së fundmi, ky studim evidenton boshllëqe në literaturë në lidhje me reflektimin e ndryshimeve ligjore dhe implementimin e tyre, si dhe fokusin në çështje mikro të problemeve dhe sfidave të sistemit gjyqësor. Ky studim njeh limitet se nuk mund të pasqyrojë të gjitha elementët që mund të ndikojnë në kulturën gjyqësore apo mënyrat se si mund të përmirësohet ajo. Thënë kjo, duke përdorur metoda të ndryshme të hulumtimit, si analiza krahasimore, intervista dhe fokus grupe, studimi synoi të trajtojme në mënyrë holistike të gjitha pikëpamjet mbi pavarësinë dhe kulturën gjyqësore. Edhe pse kultura gjyqësore nuk mund të matet me ndonjë indikator të vecantë, indikatorët për matjen e pavarësisë së gjyqësorit janë tregues të vlefshëm që mund të përdoren. Për këtë arsye, një rekomandim i fundit i këtij dokumenti diskutimi është thellimi i mëtejshëm i hulumtimeve mbi pavarësinë e gjyqësorit duke përdorur kulturën si kuadër analitik.



# 1 Hyrje

Kultura gjyqësore i referohet tërësisë së vlerave, besimeve, normave dhe sjelljeve që karakterizojnë gjyqësorin brenda një sistemi ligjor apo vendi të caktuar. Ajo përfshin qëndrimet dhe praktikën e përbashkëta midis gjyqtarëve, personelit të gjykatës dhe profesionistëve ligjorë në lidhje me administrimin e drejtësisë, proceset e vendimmarrjes dhe funksionimin e përgjithshëm të sistemit gjyqësor, si dhe me praktikën gjyqësore dhe edukimin ligjor të pjesëtarëve të gjyqësorit.<sup>2</sup>

Sipas Bell, kultura gjyqësore e një vendi përcakton se si parimi i pavarësisë së gjyqësorit, ndër të tjera, prezantohet dhe kuptohet në formën e tij institucionale.<sup>3</sup> Sipas tij,

[n]dërsa përpqemi ta zërthejmë deri në thelb parimin e pavarësisë së gjyqësorit, duhet të marrim parasysh llojet e institucioneve dhe parimeve operacionale që presim. Por në momentin kur ne përpqemi të bëhemi më specifike, ne priremi të devijojmë në zbatimin e parimit. Kjo nuk është për të mohuar parimin, por për të demonstruar që, gjykimi se çfarë do të thotë parimi në një vend të caktuar gjatë një periudhe të caktuar kërkon vëmendje ndaj kontekstit historik dhe politik në të cilin ai vepron. Institucionet aktuale shpesh justifikohen duke iu referuar problemeve historike që ato zgjidhin. Për më tepër, një krahasim me të kaluarën jep dëshmi për shkallën në të cilën një vend ka përparuar në arritjen e pavarësisë gjyqësore.<sup>4</sup>

Duke thënë këtë, Bell po sugjeron se koncepti i pavarësisë së gjyqësorit nuk është një model i vetëm; ai formësohet nga kultura gjyqësore, konteksti historik dhe mjedisi politik i një vendi. Gjatë zbatimit të parimit të pavarësisë së gjyqësorit, çdo komb mund të ketë institucione dhe qasje të ndryshme operacionale të përshtatura për rrethanat e tij unike.

Ai tërheq vëmendjen për faktin se megjithëse vetë parimi mund të pranohet gjerësisht, zbatimi dhe interpretimi i tij mund të jetë i ndryshëm në vende dhe në periudha kohore të ndryshme. Kjo divergjencë është në një vijë logjike me argumentin se mjedisi historik dhe politik i një kombi të caktuar duhet të merret parasysh kur përcaktohet pavarësia gjyqësore brenda atij kombi. Bell sugjeron gjithashtu se mënyra se si funksionojnë institucionet aktuale shpesh formësohet nga problemet apo vështirësitë e së kaluarës. Analizimi i rrethanave të kaluara hedh

---

<sup>2</sup> D Preshova, *Judicial Culture and the role of judges in developing the laë in North Macedonia* (2021); CEELI Institute, *Manual on independence, impartiality and integrity of justice, a thematic compilation of international standards, policies and best practices* (2022).

<sup>3</sup> J Bell, *Judicial Cultures and Judicial Independence*, Cambridge University Press, f 13.

<sup>4</sup> *ibid*, f 60.



dritë mbi atë se sa larg ka arritur një komb në arritjen e pavarësisë gjyqësore dhe ndihmon për të kuptuar se si është zhvilluar sistemi i tij ligjor.

Për këto arsye, një shqyrtim i plotë i nevojës së Shqipërisë për reforma në drejtësi me kalimin e kohës është thelbësor për të kuptuar evoluimin e sistemit gjyqësor. Duke analizuar kontekstin historik dhe politik, mund të kuptohen kompleksitetet e zbatimit të drejtësisë në Shqipëri. Kjo analizë mund të ndihmojë në përcaktimin e hapave që mund të ndërmerren drejt krijimit të një gjyqësori të pavarur dhe të ndarë.

Gjatë 30 viteve të fundit në Shqipëri, janë zbatuar modele të ndryshme me qëllim gjetjen e formulës e cila do të garantojë sigurimin e pavarësisë gjyqësore në Shqipëri, si *de facto*, dhe *de jure*. Në një periudhë në tjetrën, me synimin për të arritur këtë qëllim, sistemi gjyqësor ka pësuar rishikim dhe riorganizim kompetencash, institucionesh, dhe njerëzish, shoqëruar me ndryshimet përkatëse të kuadrit ligjor. Duke analizuar nevojën për reforma në drejtësi në Shqipëri ndër kohë, vërejmë se korrupsioni, influenca nga ekzekutivi, dhe mungesa e besimit në institucionet gjyqësore evidentohen si emërues të përbashkët.<sup>5</sup> Mbi këto baza, ka lindur përgjithësisht nevoja për reforma.<sup>6</sup>

Krijimi i një gjyqësori të pavarur dhe funksional ka provuar të jetë një sfidë komplekse për Shqipërinë.<sup>7</sup> Kjo sfidë mori proporcione më të mëdha kur potencialisht mund të ndikonte hapjen e negociatave për anëtarësimin e Shqipërisë në BE.<sup>8</sup> Në këto kushte, lindi nevoja për reformën në drejtësi në vitin 2016.<sup>9</sup>

---

<sup>5</sup> A Hoxha et al, Monitorimi i Zbatimit të Reformës në Drejtësi (2019). Shih për më tepër Komisioni Parlamentar Ad Hoc mbi reformën në sistemin e drejtësisë, Analiza e sistemit gjyqësor në Shqipëri (2015), f 98. Analiza e sistemit të drejtësisë e kryer në vitin 2015 nga Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën në Drejtësi theksoi se sistemi gjyqësor në Shqipëri, me formën e organizimit institucional ekzistues, po haste probleme të shumta dhe "nuk po performonte në mënyrë të duhur misionin e tij për të konsoliduar sundimin e ligjit". Probleme të tilla si perceptimi i publikut mbi sistemin e drejtësisë si i korruptuar dhe i influencueshëm në dhënien e drejtësisë, pozicioni i dobët i pushtetit gjyqësor përkundrajt dy pushteteve të tjera, si dhe dështimi i sistemit i vënies para përgjegjësisë prokurorët dhe gjyqtarët e korruptuar, u evidentuan ndër të tjera në analizë.

<sup>6</sup> I Topalli, Kontrolli i kushtetueshmërisë së ligjit në Shqipëri: Qasje krahasimore, PhD (2015).

<sup>7</sup> Në Raportin e Progresit të Komisionit Evropian për Shqipërinë 2015, sistemi gjyqësor i Shqipërisë u konsiderua në një fazë të hershme përgatitjeje, duke vënë në dukje se administrimi i drejtësisë është i ngadaltë dhe vendimet gjyqësore nuk zbatohen gjithmonë. Gjithashtu, "Trajnimi profesional i gjyqtarëve është i pamjaftueshëm dhe pavarësia e tyre nuk sigurohet plotësisht. Ka llogaridhënie të pamjaftueshme të gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe korrupsioni brenda sistemit të drejtësisë është i përhapur. Bashkëpunimi ndër-institucional është i dobët dhe burimet janë të pamjaftueshme." Mbi këtë bazë, KE rekomandoi miratimin e një strategjie për një reformë të re gjyqësore. Albania Proges Raporti 2023, f 19. Në 2023, Shqipëria ka arritur një nivel të moderuar përgatitjeje në funksionimin e gjyqësorit. Boshllëqe të evidentuara, dhe rekomandime për përmirësim, janë evidentuar nga KE përse i përket përmirësimit të efencës së gjykatave dhe shërbimeve të prokurorisë, si dhe reduktimit të dosjeve të patrajtuara, mbushja e vendeve vakante, si dhe forcimi i kapacitetit dhe pavarësisë së gjyqësorit dhe institucioneve qeverisëse, ndër të tjera.

<sup>8</sup> Progress Report Albania 2016, f 89. <[https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2018-12/20161109\\_report\\_albania.pdf](https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2018-12/20161109_report_albania.pdf)>

<sup>9</sup> Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë, Grupi i Ekspertëve i Nivelit të Lartë, f 2. <<https://rm.coe.int/strategjia-ne-refomen-e-sistemit-te-drejtisesise/16809eb53a>> " Synimi i përgjithshëm i procesit të reformës është krijimi i një sistemi drejtësie të besueshëm, të drejtë, të pavarur, profesional dhe të



Modeli i prezantuar nga Reforma në Drejtësi parashikon krijimin e institucioneve të reja qeverisëse të gjyqësorit, si Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ), Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP) dhe Inspektori i Lartë i Drejtësisë (ILD).<sup>10</sup> Me synim ndalimin e ndërhyrjes së ekzekutivit apo legjislativit në sistemin gjyqësor, këshillat gjyqësore, janë përgjegjës për procedurat e emërimit, shkarkimit, dhe disiplinës, ndër të tjera, të gjyqtarëve, prokurorëve dhe anëtarëve të sistemit gjyqësor. Gjithashtu, u krijua institucioni i ILD-së, i cili ka mandat për të *"verifikuar ankesat, hetimin e shkeljeve dhe fillimin e procedimit disiplinor"* ndaj disa pjesëve kryesore të sistemit gjyqësor.<sup>11</sup> Si një institucion i pavarur i sistemit të drejtësisë misioni i ILD është i fokusuar në çështjet e disiplinimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe të Prokurorit të Përgjithshëm, është konsideruar si thelbësor për garantimin e pavarësisë së gjyqësorit.<sup>12</sup>

Çështja e shtruar për diskutim në këtë studim është sa ndryshimi i strukturës gjyqësore, si dhe përfshirjes së institucioneve të reja të drejtësisë, ka arritur të përmbushë problemet e evidentuara në sistemin gjyqësor pararendës, si: *"korrupsioni, keqfunksionimi, mungesa e integritetit, profesionalizmit, pavarësisë, efikasitetit, besueshmërisë, transparencës, llogaridhënies dhe përgjegjshmërisë së sistemit"*.<sup>13</sup>

Me qëllim dhënien e kontributit në debatin se jo në ndarja e gjyqësorit si degë nuk përkthehet automatikisht në pavarësi gjyqësore,<sup>14</sup> ky dokument diskutimi synon të nxjerrë në pah rëndësinë e elementit të kulturës gjyqësore. Dokumenti analizon standartet e pavarësisë së gjyqësorit në tre periudha: 1991-1998, 1998-2016 dhe 2016 e në vijim. Në bazë të gjetjeve të kësaj analize, duke evidentuar mungesat dhe pikat e forta të sistemeve të mëparshme, fokusi vendoset tek institucioni i Inspektoriatit të Lartë të Drejtësisë.

---

orientuar drejt shërbimit, të hapur, të përgjegjshëm dhe eficient, i cili të gëzojë besimin e publikut, të mbështesë zhvillimin e qëndrueshëm social-ekonomik të vendit dhe të mundësojë integrimin e tij në familjen evropiane."

<sup>10</sup> Paketa e ligjeve të reformës në drejtësi. <<https://klgj.al/ep-content/uploads/2019/09/Paketa-e-Ligjeve-t%C3%AB-Reform%C3%ABs-n%C3%AB-Drejt%C3%ABsi-2018.pdf>>

<sup>11</sup> <<https://ild.al/sq/zyra-e-inspektorit-te-larte-te-drejtësisë/>>

<sup>12</sup> Në bazë të GJEDNJ, Resolutionon Judicial Ethics (2008), pavarësia e gjyqësorit duhet të garantohet në lidhje me veprimtaritë gjyqësore dhe në veçanti në lidhje me rekrutimin, emërimin deri në moshën e pensionit, ngritjet në detyrë, palargueshmërinë, trajnimin, imunitetin gjyqësor, disiplinën, shpërblimin dhe financimin e gjyqësorit. Ky konsiderohet si standarti ndërkombëtar i pavarësisë, i parashikuar dhe në Parimet Bangalore të Sjelljes Gjyqësore <<https://www.google.com/search?q=bangalore+rules&oq=bangalore+rules>>..

<sup>13</sup> <<https://www.reformanedrejtësi.al/pse-nje-reforme-ne-drejtësi>>

<sup>14</sup> F Caka, E Merkur, Judicial Culture and the role of judges in developing the laë in Albania IDSCS (2023); T Marinkovic, Personal Guarantees of judicial independence and judicial culture in Serbia IDSCS (2022); D Preshova, Judicial Culture and Individual Independence of Judges in North Macedonia: independent judiciary ëith depended judges IDCS (2022). Në bazë të gjetjeve të studimeve, kultura gjyqësore mbizotëruese shfaq se autonomia gjyqësore në Shqipëri, Serbi dhe Maqedoninë e Veriut nuk përkthehet në pavarësi gjyqësore. Pavarësisht ekzistencës së këshillave gjyqësore në këto tre shtete, në bazë të intervistave të kryera, autorët kanë gjetur se ekziston një frikë dhe mosbesim i gjërë ndërmjet gjyqtarëve brenda institucioneve.



Me bazë të gjetjeve të kësaj analize, synohet të identifikohen rekomandime zbatimi i të cilave do të ndikonte për të forcuar kulturën e pavarësisë gjyqësore dhe sesi Inspektori i Lartë i Drejtësisë mund të kontribuojë në përmirësimin e kësaj kulture.

## 1.1 Prezantimi i dilemës kërkimore

Në veprën e Platonit, "Republika", interlokutorët arrijnë në përkufizimin përfundimtar të drejtësisë, si një koncept që gjen zbatim si tek individ, ashtu dhe tek shteti.<sup>15</sup> Platoni argumenton se drejtësia tek individ arrihet kur arsyeja e një personi udhëheq veprimet e tij apo të saj, dhe se dëshirat e personit janë në përputhje me atë që është moralisht e drejtë. Në konceptualizimin e drejtësisë në qytet-shtetin e tij ideal, drejtësia arrihet kur secila klasë e qytetarëve kryen rolin dhe funksionin e saj të caktuar, pa ndërhyrë në rolet e njëra-tjetres.<sup>16</sup>

Gjithashtu Zhan Zhak Ruso në veprën "Kontrata Sociale" shprehet se "do të përpiqem vazhdimisht të bashkoj atë që e drejta e lejon me atë që interesi e urdhëron, me qëllim që drejtësia dhe dobia të mos ndodhen aspak të ndara nga njëra tjetra".

Me reformën në drejtësi të kryer në vitin 2016, përmes dispozitave kushtetuese, ligjeve të vecanta dhe institucioneve të ngritura, *de jure* sistemit gjyqësor i është dhënë një pavarësi e plotë. Sistemi ka kompetenca të plota për të rregulluar procedurat e brendshme, çështjet e brendshme, dhe sjelljet e anëtarëve të tij përmes "vetëqeverisjes së gjyqësorit".<sup>17</sup> Në parim, një sistem gjyqësor vetëqeverisës funksionon i lirë nga influencat e jashtme, qofshin ato nga ekzekutivi, legjislativi, apo burime të tjera, si dhe ka autonomi në vendimmarrje, rregullimin e brendshëm, procedurat e disiplinës, si dhe krijimit të këshillave, ndër elementë të tjerë.<sup>18</sup>

Në pamje të parë, një sistem i tillë i cili garanton ndarjen e pushteteve, pavarësinë e tyre dhe funksionimin e ushtrimit të balancës dhe kontrollit, është një sistem optimal për çdo shoqëri demokratike. Por realiteti mund të jetë larg parashikimeve ligjore. Mbi këtë premisë ngrihen tre hipotezat e studimit, të cilat do të analizohen në vijim:

---

<sup>15</sup> Plato, *The Republic*. Përkthyer nga Jowett, B., Oxford University Press, 1888.

<sup>16</sup> *Ibid.*

<sup>17</sup> Resolution of the ENCJ on Self Governance for the Judiciary: Balancing Independence and Accountability (2008). Shih më tepër D Kosar, *Perils of Judicial self-government in transitional societies*, Cambridge University Press (2016). < <https://www.cambridge.org/core/books/abs/perils-of-judicial-selfgovernment-in-transitional-societies/judicial-accountability-and-judicial-councils/CF8944B8888D1B9FA21886B96C5E2B72> >

<sup>18</sup> Karta Evropiane për Statusin e Gjyqtarëve, Parimet Bazë të Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Pavarësinë e Gjyqësorit, Parimet e Bangalorit për Sjelljen e Gjyqtarëve, Magna Carta e Gjyqtarëve, 2010 dhe Këshilli Konsultativ i Gjyqtarëve Evropianë, Opinioni 1 (2001).



**Hipoteza 1:** Niveli i pavarësisë reale të gjyqësori ndikohet jo vetëm nga ndryshimet ligjore dhe strukturore të sistemit, por dhe nga niveli i kuptimit dhe operacionalizmit të gjyqësorit nga zyrtarët e këtij sistemi;

**Hipoteza 2:** Kuptimi i rëndësisë së kulturës si element i fokusit të reformës në drejtësi, do të përmirësojnë pavarësinë e synuar nga reforma.

**Hipoteza 3:** Qasja strikte legalistike në ndjekjen dhe përmbushjen e objektivave të reformës në drejtësi, pa përfshirë forcimin e kulturës së pavarësisë nuk mund të jetë e favorshme për progresin drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian.<sup>19</sup>

Transformimi i një kulture gjyqësore negative, e ndikuar nga dinamikat politike dhe anti-vlera gjyqësore, nuk mund të kryhet vetëm nëpërmjet parashikimeve ligjore. Për të qenësuar parimet e parashikuara në legjislacion, transformimi kërkon adresimin e antivlerave gjyqësore, sjelljeve, dhe zotimit të gjyqtareve dhe anëtarëve që janë pjesë të sistemit gjyqësor.

## 1.2 Pyetja(et) kërkimore

Një sistem gjyqësor efektiv dhe i pavarur është i domosdoshëm për të ruajtur rendin e ligjit dhe ndarjen e pushteteve, si dhe për garantimin e respektimit të parimeve thelbësore për dhënien e drejtësisë, sidomos në rastet e mosmarrëveshjeve ndërmjet personave, apo personave dhe shtetit.

Bazuar në diskutimin vijues, pyetjet kërkimore që analizohen në këtë punim janë:

- (i) Cilat janë standardet e pavarësisë së gjyqësorit?
- (ii) Si ka evoluar nocioni i pavarësisë gjatë tre periudhave kyçe të tranzicionit të sistemit gjyqësor (1991-1998, 1999-2016, dhe 2016-në vijim) me fokus në strukturat që e garantojnë pavarësinë.
- (iii) Në çfarë mase ndryshimet strukturore në sistemin gjyqësor kontribuojnë ose pengojnë arritjen e pavarësisë së gjyqësorit, veçanërisht në periudhën pas reformës të vitit 2016?

---

<sup>19</sup> Integrimi në Bashkimin Evropian është ngushtësisht i lidhur me pavarësinë e gjyqësorit si garanci për funksionimin e demokracisë, sundimit të ligjit dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut në Shqipëri. Në bazë të metodologjisë së re të zgjerimit të BE-së, Kapitulli 23 i cili fokusohet te Gjyësori dhe të Drejtat Themelore, bën pjesë në grupin e parë të kapitujve negociues (Cluster 1), të cilët do të hapen të parët dhe do të mbyllën të fundit.





- (iv) Cila është rëndësia e kultivimit të një kulture gjyqësore brenda gjyqësorit dhe si ndikon kjo në punën e ILD-së dhe në rolin e tij për forcimin e sundimit të ligjit?
- (v) Si kanë kontribuar elementë të ndryshëm, përfshirë ndryshimet strukturore në sistemin vetëqeverisës gjyqësor, ndryshimi i procedurës disiplinuese dhe kultivimi i kulturës gjyqësore në krijimin e një sistemi gjyqësor efektiv dhe të pavarur në Shqipëri?

Në këtë analizë me qasje periodizimi, vëmendje të veçantë i kushtohet kuptimit të rolit të shumëanshëm që luajnë mekanizmat disiplinorë në formësimin dhe ruajtjen e pavarësisë së gjyqësorit.

Një aspekt kritik i kësaj analize përfshin një analizë e institucionit të ILD-së në periudhën pas 2016.

### 1.3 Metodologjia

Me qëllim analizën e të dhënave të larmishme dhe duke pasur parasysh vështirësinë në interpretimin dhe operacionalizimin të kulturës ky punim përdor një gërshetim të metodave të ndryshme të kërkimit shkencor.

#### *Analiza e literaturës*

Fillimisht është kryer një rishikim i gjerë i literaturës, dokumenteve ligjore dhe doktrinës, me qëllim dhënien e nocioneve kyçe, si ndarja e pushteteve, pavarësi e gjyqësorit, pavarësi individuale, rëndësia e institucioneve të vetëqeverisjes gjyqësore dhe rëndësia e një kulture gjyqësore pozitive. Për dhënien e një panorame mbi rolin kushtetues dhe performancën e ILD-së, analiza është bazuar në analizën e ligjeve kryesore të reformës në drejtësi, Kushtetutës, raporteve të ndryshme me fokus ILD dhe sistemet e reja të drejtësisë.

#### *Intervista*

Për të marrë të dhëna mbi kuptimin dhe interpretimin e kulturës u zhvilluan intervistave me gjyqtarë dhe prokurorë të juridiksionit të përgjithshëm dhe të posaçëm, anëtarë të KLGJ dhe KLP. Duke respektuar dhe ruajtur privatësinë e të intervistuarve, do të bëjmë një përshkrim të karakteristikave të tyre.

- Veçoria e parë e përzgjedhjes së të intervistuarve është e lidhur me statusin si nëpunës publikë që punojnë në strukturat e gjyqësorit dhe drejtësisë, si psh: Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë



për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Prokuroria e Posaçme, Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë;

- Veçoria e dytë qëndron në përzgjedhjen e të intervistuarve me vjetërsi pune të larmishme. 2 prej të intervistuarve kanë 20-25 vite eksperiencë profesionale, 3 prej tyre ka 10-18 vite eksperiencë, 1 prej tyre ka më shumë se 25 vite eksperiencë.

Gjithsej janë kryer 6 intervista. Me qëllim pasjen e një qasjeje sa më gjithëpërfshirëse, larmishmëria e përzgjedhjes së të intervistuarve sipas specifikave të lartpërmendura, na mundëson krijimin e një pamje më të qartë dhe objektive të mënyrës se si zbatohet legjislacioni në fuqi, sa e njohin magistratët e jo vetëm, kuadrin ligjor, a ndihen realisht të pavarura brenda sistemit të drejtësisë, si dhe a është ky sistem eficient.

U kontaktuan 18 individë që i përshtateshin demografisë të synuar të studimit dhe më pas u përdor metoda e kërkimit *snoëballing*, duke i kërkuar të pyesnin njerëz të tjerë për të qënë pjesë të intervistave. Nga 18 persona të kontaktuar, gjashtë ranë dakord të merrnin pjesë. Gjithashtu, një kërkesë iu drejtua KLGJ-së, KLP-së, Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke i kërkuar që të ndajnë anketimin me anëtarët e tyre. Pavarësisht kontaktit tonë, nuk morëm asnjë përgjigje.

Kodimi i të intervistuarëve me qëllim referimin në vijim të përgjigjeve të tyre është:

- Gjyqtar
- Ish-Gjyqtar
- Prokuror
- Ish-Prokuror
- Anëtar KLP
- Ish-Anëtar KLGJ

Pyetjet e intervistave janë strukturuar në mënyrë të tillë që të ndihmojnë në identifikimin e problematikave dhe identifikimin e mangësive.

Pyetjet e intervistave grupohen në (i) Pyetje mbi përshtatshmërinë e kuadrit kushtetues dhe ligjor për të garantuar dhe mbështetur pavarësinë dhe vetëqeverisjen e vërtetë gjyqësore; (ii) Pyetje mbi performancën reale të sistemit të qeverisjes gjyqësore për të siguruar dhe mbajtur pavarësinë në praktikë; (iii)



Pyetje mbi rëndësinë e kulturës së përgjithshme për sigurimin e pavarësisë së gjyqësorit; (iv) Pyetje mbi mënyrën për të përmirësuar situatën; dhe (v) Pyetje mbi kuadrin ligjor dhe praktikën e ILD.

Sfidat e hasura gjatë zhvillimit dhe analizimit të intervistave kanë të bëjnë me:

- Mungesa e një numri të madh të intervistave;
- Mungesa e përgjigjeve për pyetje specifike nga të intervistuarit, duke anashkaluar qëllimin e pyetjes;
- Përgjigja e dhënë nuk ka qenë relevante me pyetjen.

Arsyeja e zberthimit jo të duhur të pyetjes mund të jetë perceptimi jo i saktë i pyetjes nga i intervistuari, ose mënjanimi i përgjigjes negative për shkak të detyrës që i intervistuari kryen. Në këtë kontekst, për të pasur një vlerësim sa më të plotë dhe të saktë si në vijim, konsiderojmë marrjen në konsideratë të kufizimeve më lart.

Siç do të thellohet në vijimësi të këtij punimi, kultura gjyqësore është një element joformal. Intervistat me anëtarëve të sistemit gjyqësor mund të na mundësojnë një dritare në perceptimin e tyre ndaj kulturës gjyqësore mbizotëruese. Duke u ndalur në qasjet individuale të të intervistuarve, ne mund të kuptojmë vlerësimet individuale të nocionit të pavarësisë së gjyqësorit. Duke kryqëzuar përgjigjet e intervistuesve, në synojmë të kuptojmë nëse standardi i ri i pavarësisë gjyqësore i prezantuar pas reformës në drejtësi po bëhet pjesë e kulturës gjyqësore, si dhe të kuptojmë perceptimin e të intervistuarëve mbi rolin e ILD-së në forcimin e pavarësisë dhe rëndësisë.

#### *Fokus-grup me Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*

Në fokus-grupit morën pjesë 6 zyrtarë të Zyrës së ILD-së: 1 inspektor magjistrat, 1 inspektor jo magjistrat, 2 këshilltarë ligjorë dhe 2 nëpunës, pjesë e administratës së Zyrës së ILD-së.

Qëllimi kryesor i këtij fokus-grupi ishte diskutimi mbi rëndësinë së kulturës në forcimin e parimit të pavarësisë së gjyqësorit.

Fokus-grupi u konceptua me qëllim për të marrë këndvështrime të zyrtarëve të ILD-në tre nivele të analizës:

- Analiza në nivel individual të perceptimit të kulturës gjyqësore tek Inspektorët;



- Analiza në nivel institucional, duke analizuar politikat e brendshme të ILD-së, proceset, strukturat për garantimin dhe kultivimin e kulturës gjyqësore;
- Analiza në nivel makro, se si kuadri ligjor dhe faktorë të jashtëm socialë, kulturor dhe sistemik mund të ndikojnë në kulturën gjyqësore në ILD.

Gjetjet nga fokus grup dhe analiza me tre nivele japin njohuri të vlefshme për nuancat e kulturës gjyqësore ekzistuese dhe ndikimin e saj në parimin e pavarësisë së gjyqësorit.

#### 1.4 Qëllimi i studimit

Qëllimi i studimit është të shqyrtojë dhe të analizojë ndikimin dhe zhvillimin e kulturës gjyqësore në sistemin e drejtësisë në Shqipëri, veçanërisht pas reformës së fundit në drejtësi. Ky studim synon të theksojë se vlerat, besimet, normat dhe sjelljet në brendësi të sistemit gjyqësor ndikojnë në pavarësinë, integritetin dhe efikasitetin e gjyqësorit dhe për pasojë në konsolidimin e sundimit të ligjit në vend. Në një plan tjetër, duke analizuar rolin, punën dhe përgjegjësitë e ILD-së, qëllimi është të kuptohet s roli që mund të luajë institucioni i ILD-së në zhvillimin e kulturës gjyqësore në Shqipëri.

Për shkak të mungesës së literaturës mbi elementët që përbëjnë kulturën gjyqësore në Shqipëri, dhe ndarjes së përvojës praktike nga anëtarët e gjyqësorit, për të mbushur hapësirën e kërkimit shkencor dhe për të zbuluar informacione të reja në lidhje me kulturën gjyqësore në Shqipëri, ky studim synon të kontribuojë në zhvillimin e një debati konstruktiv mbi forcimin e kulturës gjyqësore në Shqipëri. Për më tepër, gjatë leximit dhe diskutimit mbi gjetjet e këtij studimi, synojmë të prezantojmë perspektiva për hulumtime të mëtejshme dhe për të nxitur interesin për këtë fushe në nivel akademik dhe profesional.

#### 1.5 Struktura

Studimi konsiston në tre pjesë: hyrja, katër seksione kryesore dhe gjetjet/përfundimet. Si pikë fillimi, hyrja vendos lexuesin në kontekstin e debatit mbi pavarësinë e sistemit gjyqësor në Shqipëri dhe tre periudhat mbi bazën e të cilës do të bazohet debati. Në hyrje identifikohen çështjet kryesore të hulumtimit, të cilat lidhen me hipotezën nëse ndryshimi i formës së sistemit gjyqësor nuk sjell në efektivitet apo pavarësi të këtij sistemi, pa marrë në konsideratë elementin e kulturës gjyqësore. Koncepti i kulturës gjyqësore është tepër fluid dhe jo lehtësisht i matshëm me indikatorë. Për këtë arsye, në hyrje, përcaktohet metodologjia se si do të arrihet vendosja e pikave udhëheqëse në lidhje me diskutimin në fjalë. Në



vijim, bëhet një parashtrim i standardeve në lidhje me pavarësinë gjyqësore dhe kulturën gjyqësore.

Në seksionin e trete, do të trajtohet sistemi gjyqësor në mënyrë krahasuese në tre periodha të ndryshme: 1991-1998, 1998-2016 dhe 2016-në vijim. Gjithashtu, seksioni do të qeveriset nga këto tre çështje brenda seksionit:

- 1.** Pavarësia e sistemit gjyqësor nga sistemi ekzekutiv dhe legjislativ;
- 2.** Pavarësia e organeve brenda sistemit gjyqësor;
- 3.** Kush e kryente rolin e ILD-së para krijimit të ILD-së (dhe një vlerësim të pavarësisë gjatë procesit të kryerjes së këtij roli).

Në seksionin e katërt, punimi analizon risinë e reformës në drejtësi, krijimin e institucionit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, i cili është i lidhur ngushtë me forcimin e integritetit në sistemin drejtësisë. Duke u bazuar në raporte, norma ligjore dhe analizës vijuese të punimit, studimin ndalet në rolin dhe performancën e ILD-së në vetëqeverisjen gjyqësore.

Në fund, gjetjet e këtij studimi përmbledhin diskutimet dhe analizat në këtë mënyrë: Si fillim, japin një përgjigje dilemës së rëndësisë së elementit të kulturës gjyqësore në pavarësinë e gjyqësorit si rrjedhojë e ngritjes së hipotezës nëse sisteme të mëparshme dështuan për këtë arsye; si dhe në bazë të intervistave dhe fokus-grupit, jepen rekomandime për sa i përket forcimit të elementit të kulturës gjyqësore në të gjitha strukturat e sistemit gjyqësor.



## 2 Standardet e pavarësisë dhe kulturës së pavarësisë së gjyqësorit

Pavarësi gjyqësore krijohet nga bashkimi i dy fjalëve: "pavarësi" dhe "gjyqësore". Termi e ka origjinën nga fjala latine *judicious*, si një cilësi e lidhur me një gjykatë ose gjykatës.<sup>20</sup> Parimi i gjyqësorit të pavarur është i lidhur ngushtësisht me teorinë e ndarjes së pushteteve, ku pushteti ekzekutiv, legjislativ dhe ekzekutiv, formojnë tre degë të ndara të shtetit, të cilët janë pjesë e një sistemi që ushtron kontroll dhe balancë, me qëllim mos abuzimin dhe shkeljes së lirisë së shoqërisë.<sup>21</sup>

Pavarësia e gjyqësorit nënkupton se si gjyqësori si pushtet, dhe anëtarët e gjyqësorit në nivel individual, duhet të jenë të lirë të ushtrojnë kompetencat dhe përgjegjësitë e tyre pa u ndikuar nga pushteti ekzekutiv, legjislativ, ose nga ndonjë burim tjetër influence.<sup>22</sup> Sipas Komisionit të Venecias, vetëm një gjyqësor i pavarur është i aftë të japë drejtësi në mënyrë të pavarur, në bazë të ligjit, dhe si rrjedhim, të mbrojë të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të individit.<sup>23</sup>

Gjithashtu, ndarja e pushteteve dhe balancimi i pushteteve përbëjnë thelbin e shtetit të së drejtës.<sup>24</sup> Nga njëra anë, pushteti legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor duhet të jenë të pavarur nga njëri tjetri, pasi kombinimi legjislativ-ekzekutiv, legjislativ-gjyqësor apo gjyqësor-ekzekutiv, sjell që (i) një person/organ do miratonte ligje tiranike, për t'i zbatuar më vonë në mënyrë tiranike; (ii) vendimet e gjyqtarit do kishin fuqinë e ligjit dhe zbatoheshin në mënyrë arbitrare, dhe (iii) gjyqtari ekzekutiv do të ishte tiran.<sup>25</sup> Nga ana tjetër, tre pushtetet interferojnë, balancojnë e kontrollojnë reciprokisht njëri-tjetrin, bazuar gjithnjë në normat kushtetuese e ligjore, në atë që quhet parimi i balancimit të pushtetit ('check and balance').<sup>26</sup> Ideja qendrore është që parimi i ndarjes dhe balancimit të pushteteve nuk gjen zbatim vetëm në rastin e pavarësisë së tre pushteteve, por dhe në institucione të tjera kushtetuese, të cilat ngarkohen me detyra e funksione të ndryshme në një shtet të së drejtës.<sup>27</sup>

Ekziston një literaturë e gjerë mbi standardet e pavarësisë së gjyqësorit, bazuar në traktate ndërkombëtare, parime ndërkombëtare dhe rajonale, udhëzime, opinione

---

<sup>20</sup> English Oxford Living Dictionary, "Definition of Judicial in English" (2018)

<<https://en.oxforddictionaries.com/definition/judicial>>

<sup>21</sup>< <https://www.ohchr.org/sites/default/files/Documents/Publications/training9chapter4en.pdf>>

<sup>22</sup> ibid.

<sup>23</sup> Shih CoE, European Commission for Democracy through Law (Venice Commission), Compilation of Venice Commission Opinions and Reports concerning Judges (2023). <

[https://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-PI\(2023\)019-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-PI(2023)019-e)>

<sup>24</sup> Zaganjori, f 28.

<sup>25</sup> Charles de Montesquieu, "De l'esprit des lois", Libre II, Chap.II, cituar në Zaganjori Xh. et al, Demokracia dhe Shteti i së Drejtës, Shtëpua Botuese Adelprint, f 99.

<sup>26</sup> Zaganjori Xh. et al, Demokracia dhe Shteti i së Drejtës, Shtëpua Botuese Adelprint, f 29.

<sup>27</sup> Zaganjori Xh. et al, Demokracia dhe Shteti i së Drejtës, Shtëpua Botuese Adelprint, f 30.



me karakter deklarativ, praktika të përgjithshme nëpër shtete, rekomandimet e të tjera.<sup>28</sup> Në nivel evropian, neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut<sup>29</sup> dhe neni 47 i Kartës së BE-së për të Drejtat Themelore<sup>30</sup> shërbejnë si gur themeli për mbrojtjen e pavarësisë së gjyqësorit. Përveç kësaj, Karta Evropiane për statutin e gjyqtarëve<sup>31</sup>, Magna Carta e Gjyqtarëve<sup>32</sup>, Karta e Gjyqtarëve në Evropë<sup>33</sup>, Rekomandimi i Këshillit të Evropës për Gjyqtarët: Pavarësia, efikasiteti dhe përgjegjësitë<sup>34</sup>, Rekomandimet e Komisionit të Venecias<sup>35</sup>, Rekomandimet e Kievit për Pavarësinë Gjyqësore në Evropën Lindore, Kaukazin e Jugut dhe Azinë Qendrore<sup>36</sup>, Opinionet e CCJE-së<sup>37</sup> dhe Raportet e ENCJ<sup>38</sup> janë instrumentet kryesore ligjore që mund të drejtojnë çdo strukturë gjyqësore në përpjekjet e tyre drejt pavarësisë së gjyqësorit.

Në një interpretim të Nenit 14 të Paktit Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike (PNDKP), Komiteti për të Drejtat e Njeriut është ndalur në elementët që përbëjnë kërkesat e pavarësisë së gjyqësorit, ku thuhet se:

*Kërkesat e pavarësisë në kuptimin e Nenit 14 i referohen, në veçanti, procedurës dhe kualifikimet të caktimit të gjyqtarëve dhe garancitë në lidhje me përfundimin e mandatit të tyre, si dhe kur kushte të tilla ekzistojnë, kushtet në lidhje me ngritjen në detyrë, transferimin, pezullimin dhe përfundimin e funksioneve të tyre,*

---

<sup>28</sup> Shih CoE, European Commission for Democracy through Law (Venice Commission), Compilation of Venice Commission Opinions and Reports concerning Judges (2023).

<sup>29</sup> Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut - Neni 6: Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile ose për çdo akuzë penale kundër tij, çdokush ka të drejtë për një gjykim të drejtë dhe publik brenda një kohe të arsyeshme nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e krijuar me ligj. Praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, kur kërkohet të vlerësojë nëse një organ gjyqësor mund të etiketohet si i "pavarur" i referohet, kryesisht, katër kritereve të dallueshme: (1) Mënyra e emërimit të anëtarëve gjyqësorë; (2) Kohëzgjatja e mandatit të funksionit gjyqësor; (3) Ekzistenca e garancive të caktuara kundër presioneve të jashtme; (4) Nëse trupi paraqet një pamje të pavarur. Findlay kundër Mbretërisë së Bashkuar: Campbell dhe Fell kundër Mbretërisë së Bashkuar; Maktouf dhe Damjanovic kundër Bosnjë dhe Hercegovinës; Brudnicka dhe të tjerët kundër Polonisë. Lexoni më tej në M Mastracci, Pavarësia Gjyqësore: Standardet Evropiane, Kriteret e GJEDNJ dhe plani i riorganizimit të organeve gjyqësore në Poloni, Athina Journal of Law - Volume 5, Issue 3 – 323-350 (2019). <<https://www.athensjournals.gr/law/2019-5-3-6-Mastracci.pdf>>

<sup>30</sup> Karta e BE-së për të Drejtat Themelore - Neni 47: E drejta për një mjet juridik efektiv dhe për një gjykim të drejtë. Gjithkush ka të drejtë për një seancë të drejtë dhe publike brenda një kohe të arsyeshme nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e krijuar më parë me ligj.

<sup>31</sup> Karta Evropiane për statutin e gjyqtarëve (1998). <<https://rm.coe.int/090000168092934f>>

<sup>32</sup> Magna Carta e Gjyqtarëve (2010). <<https://rm.coe.int/16807482c6>>

<sup>33</sup> Judges Charter in Europe (1997). <<https://www.icj.org/wp-content/uploads/2014/10/Judges-charter-in-europe.pdf>>

<sup>34</sup> Rekomandimi nr. R (94) 12. <<https://advokat-prnjavorac.com/zakoni/Recommendation.pdf>>

<sup>35</sup> Përpilimi i opinioneve, raporteve dhe studimeve të Komisionit të Venecias në lidhje me gjyqtarët (2023). <[https://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-PI\(2023\)019-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/?pdf=CDL-PI(2023)019-e)>

<sup>36</sup> Rekomandimet e Kievit për pavarësinë e gjyqësorit në Evropën Lindore, Kaukazin e Jugut dhe Azinë Qendrore (2010). <<https://www.osce.org/files/f/documents/a/3/73487.pdf>>

<sup>37</sup> OPINIONET e CCJE-së. <<https://www.coe.int/en/web/ccje/ccje-opinions-and-magna-carta>>

<sup>38</sup> Projekti ENCJ mbi Pavarësinë dhe Përgjegjëshmërinë. <<https://www.ency.eu/articles/71>>



*si dhe pavarësinë faktike të gjyqësorit nga ndërhyrjen politike nga ekzekutivi dhe legjislativi.*<sup>39</sup>

Natyrisht, pavarësia e të gjithë strukturave të drejtësisë, përfshirë prokurorët, anëtarët e ILD, si dhe anëtarët e KLP dhe KLGJ është po aq kritike sa pavarësia e gjyqtarëve. Pavarësia e gjyqtarëve është thelbësore për të siguruar që vendimet e tyre të jenë të paanshme dhe të bazohen në ligj dhe fakte. Ata duhet të jenë të lirë nga ndikimet politike, financiare, apo ndonjë lloj presioni të jashtëm për të siguruar drejtësi.<sup>40</sup> Pavarësia e prokurorëve është kritike për të siguruar një hetim të pavarur dhe të drejtësi të paanshme. Ata duhet të kenë aftësinë për të ndjekur çështjet penale pa ndikime të jashtme dhe të përfaqësojnë interesat publike në mënyrë të pavarur.<sup>41</sup> Pavarësia e ILD është e rëndësishme për të kryer hetimet e mundshme të shkeljeve etike apo të përgjegjësisë së gjyqtarëve dhe prokurorëve. Duke qenë një organ që vlerëson veprimtarinë e aktorëve të drejtësisë, pavarësia e ILD është thelbësore për besueshmërinë e procesit të vlerësimit.<sup>42</sup>

Pas shqyrtimit të përmbajtjes së këtyre dokumenteve të rëndësishme ligjore dhe përdorimit të manualit të ofruar nga Instituti CEELI<sup>43</sup>, figura e mëposhtme përmbledh të gjithë komponentët kryesorë të pavarësisë së gjyqësorit.

---

<sup>39</sup> UN Human Rights Committee General Comment No. 32 on Article 14 of the International Covenant on Civil and Political Rights (ICCPR): Right to Equality Before Courts and Tribunals and to Fair Trial, para. 18, 2007.

<sup>40</sup> Në Komentin e tij të Përgjithshëm Nr. 32 (2007), Komiteti i të Drejtave të Njeriut, i krijuar në bazë të Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike (“PNDCP”), identifikoi se kërkesa e pavarësisë në nenin 14(1) të ligjit PNDCP i referohet, në veçanti, (i) procedurës dhe kualifikimeve për emërimin e gjyqtarëve; (ii) garancitë në lidhje me sigurinë e tyre të qëndrimit deri në moshën e pensionit të detyrueshëm ose skadimin e tij mandati i tyre, kur ekziston; (iii) kushtet që rregullojnë promovimin, transferimin, pezullimin dhe ndërprerjen e funksioneve të tyre; dhe (iv) **pavarësia aktuale e gjyqësorit nga ndërhyrjet politike nga pushteti ekzekutiv dhe legjislativ.**

<sup>41</sup> Shih CoE, European Commission for Democracy through Law (Venice Commission), Compilation of Venice Commission Opinions and Reports concerning Judges (2023).

<sup>42</sup> CDL-AD(2016)009, Final Opinion on the revised draft constitutional amendments on the Judiciary (15 January 2016) of Albania, §33. Komisioni i Venecias vëren se Inspektori [...] do të ketë statusin e Gjykatës së Lartë gjyqtari (neni 147/d f. 3), por në të njëjtën kohë ai/ajo është në një masë të caktuar nën kontrollin e Ministri i Drejtësisë. Është e dëshirueshme të lihet ekzekutivi në një distancë të caktuar nga vendimi për të përgjegjësinë disiplinore e gjyqtarëve. Si alternativë, Kushtetuta thjesht mund të parashikojë një procedurë për vendosjen para përgjegjësisë të Inspektorit për shkelje të disiplinës, në gjykatën disiplinore duke pasur fjalën e fundit për këtë çështje.”

<sup>43</sup> Instituti CEELI, Manual mbi Pavarësinë, Paanshmërinë dhe Integritetin e Drejtësisë: Një përmbledhje tematike e standardeve, politikave dhe praktikave më të mira ndërkombëtare (2022).





Figura 1: Komponentët kryesorë të pavarësisë së gjyqësorit.




Figura e mësipërme përshkruan një peizazh kompleks dhe jo një pamje lineare të thjeshtuar mbi parimin e pavarësisë së gjyqësorit. Megjithatë dispozitat kushtetuese janë padyshim një bazë thelbësore për ruajtjen e pavarësisë së gjyqësorit, është gjithashtu e nevojshme të pranohen pjesët ëvizëse që përbëjnë pavarësinë e gjyqësorit.

Kultivimi dhe ruajtja e një kulture pozitive gjyqësore janë të ndërlidhura thellë me zbatimin e disiplinës gjyqësore. Kur anëtarët e gjyqësorit i përmbahen rreptësisht standardeve etike dhe shfaqin sjellje shembullore, ata krijojnë një themel për një gjyqësor që vlerëson integritetin dhe drejtësinë. Për më tepër, respektimi i vazhdueshëm i kodeve disiplinore nxit një mjedis të përgjegjshmërisë, respektit për sundimin e ligjit dhe integritetit brenda gjyqësorit. Ky përkushtim ndaj disiplinës formon themelin e një kulture gjyqësore të përqendruar në drejtësinë, besueshmërinë dhe besimin e publikut.



Duke pasur parasysh fokusin e studimit të ILD, seksioni vijues do të japë një pasqyrë të shkurtër të standardeve dhe praktikave më të mira që lidhen me punën e organeve disiplinore. Objektivi i këtij ushtrimi është të ofrojë një prezantim mbi standartet në lidhje me procedurën e disiplinimit të anëtarëve të gjyqësorit. Zbatimi i standardeve efektive disiplinore mund të ndihmojë në ruajtjen e integritetit të gjyqësorit, gjë që do të forconte kulturën e pavarësisë, transparencës dhe llogaridhënies brenda gjyqësorit. Pavarësia në këto raste shikohet në dy nivele: pavarësia e secilit individ të përfshirë në sistemin gjyqësor, për të punuar në mënyrë të pavarur dhe të paanshme, bazuar në ligj dhe fakte; dhe pavarësia institucionale e këtyre strukturave që të jenë të pavarura nga ndikimet e jashtme politike, ekonomike, apo të tjera, dhe të kenë lirinë për të kryer përgjegjësitë e tyre në mënyrë të pavarur dhe të paanshme.<sup>44</sup>

## 2.1 Standardet për disiplinimin e anëtarëve të gjyqësorit

Disiplina është një nga elementët që mund të ndërhyjë në parimin e pavarësisë së gjyqësorit.<sup>45</sup> Rekomandimi Nr. R (94) 12, Parimi VI (2) dhe (3) parashikon që

Shtetet duhet të konsiderojnë krijimin, me ligj, të një organi të posaçëm kompetent, i cili ka për detyrë të zbatojë çdo sanksion dhe masë disiplinore, kur ato nuk trajtohen nga një gjykatë, dhe vendimet e të cilit do të kontrollohen nga një këshill i lartë gjyqësor, ose nga organi më i lartë gjyqësor.<sup>46</sup>

Ekzekutivi mund të marrë pjesë vetëm në proceset disiplinore ndaj anëtarëve të gjyqësorit ose në referimin e ankesave kundër tyre; por nuk mund të ketë rol vendimarrës.<sup>47</sup> Megjithëse në disa kultura juridike mund të ketë shembuj të vendimmarrjes së pavarur gjyqësore nën administratën ekzekutive, në përgjithësi, dhe veçanërisht për shtetet ish-komuniste ku ekzekutivi ka dominuar kryesisht gjyqësorin, ky lloj modeli nuk rekomandohet.<sup>48</sup> Mbi këtë arsye, kompetenca për të disiplinuar ose shkarkuar një gjyqtar rekomandohet të jetë në një institucion që është i pavarur nga ekzekutivi.<sup>49</sup>

<sup>44</sup> <<https://rm.coe.int/16807481a1>>

<sup>45</sup> Rezolutë për Etikën Gjyqësore, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, Miratuar nga Gjykata Plenare më 23 qershor 2008. <[http://www.echr.coe.int/Documents/Resolution\\_Judicial\\_Ethics\\_ENG.pdf](http://www.echr.coe.int/Documents/Resolution_Judicial_Ethics_ENG.pdf)> Pavarësia e gjyqësorit do të garantohet në lidhje me aktivitetet gjyqësore dhe në veçanti në lidhje me rekrutimin, emërimin deri në moshën e pensionit, ngritjet në detyrë, pandryshueshmërinë, trajnimin, imunitetin gjyqësor, disiplinën, shpërblimin dhe financimin e gjyqësorit.

<sup>46</sup> Rekomandimi Nr. R (94) 12, Parimi VI (2) dhe (3). <<https://advokat-prnjavorac.com/zakoni/Recommendation.pdf>>

<sup>47</sup> Standardet minimale të pavarësisë së gjyqësorit, 8 Praktikë juridike ndërkombëtare. 65 (1983). <<https://heinonline.org/HOL/LandingPage?handle=hein.journals/jlp8&div=27&id=&page=>>

<sup>48</sup> USAID, Udhëzues për promovimin e pavarësisë dhe paanshmërisë gjyqësore, PN-ACM-007. <[https://pdf.usaid.gov/pdf\\_docs/PNACM007.pdf](https://pdf.usaid.gov/pdf_docs/PNACM007.pdf)>

<sup>49</sup> Shoqata Ndërkombëtare e Pavarësisë Gjyqësore, Mount Scopus Standards Ndërkombëtare të Pavarësisë Gjyqësore (2008), f. 4. <<https://www.icj.org/wp-content/uploads/2016/02/Mt-Scopus-Standards.pdf>>



Standardet në lidhje me procedurat disiplinore:

- S 1 Rregullat procedurale për procedimet disiplinore duhet të garantojnë një proces të rregullt.<sup>50</sup>
- S 2 Procedurat për disiplinimin dhe largimin e gjyqtarëve duhet të sigurojnë drejtësi ndaj gjyqtarit dhe mundësi adekuate për t'u dëgjuar.<sup>51</sup>
- S 3 Procedurat disiplinore zhvillohen para një organi të pavarur.<sup>52</sup>
- S 4 Duhet të ekzistojë mundësia e rekursit në gjykatë.<sup>53</sup>
- S 5 Të njëjtat rregulla që zbatohen për emërimin e gjyqtarëve zbatohen edhe për promovimin dhe disiplinën:
  - Transparenca: vendimet duhet të publikohen<sup>54</sup>;
  - Vendimet duhet të bazohen në kriteret më objektive të mundshme<sup>55</sup>;
  - Nëse degët ekzekutive dhe/ose legjislative janë të përfshira në proces, ato nuk duhet të kenë ndikim të tepruar<sup>56</sup>;
  - Një proces me dy hapa mund të rrisë transparencën dhe mbështetjen në kriteret objektive. Një autoritet vlerëson performancën dhe një autoritet i veçantë merr vendimet përfundimtare në lidhje me promovimin ose disiplinën<sup>57</sup>;
  - Vlerësimi individual i gjyqtarëve duhet të mbahet i ndarë, si nga inspektimet që vlerësojnë punën e një gjykate në tërësi, ashtu edhe nga procedurat disiplinore<sup>58</sup>;
  - Shkarkimi nga detyra duhet të bëhet vetëm në rast të shkeljeve të rënda të rregullave disiplinore ose dispozitave penale të përcaktuara me ligj ose kur përfundimi i pashmangshëm i procesit të vlerësimit është se gjyqtari është i paaftë ose nuk dëshiron të kryejë funksionet e tij/saj gjyqësore në mënyrë objektive, në bazë të standardeve minimale të pranueshme<sup>59</sup>;
  - Mungesa e njohurive ligjore nuk duhet të rezultojë në sanksione disiplinore ose të ndikojë në vlerësimin e punës së gjyqtarit dhe duhet parë si një element i pavarësisë së gjyqësorit.<sup>60</sup>

---

<sup>50</sup>CDL(1995)074rev Opinion mbi ligjin shqiptar për organizimin e gjyqësorit (kapitulli VI i Kushtetutës Transitore të Shqipërisë), miratuar në Mbledhjen e 25-të Plenare të Komisionit, dhjetor 1995, kreu B.2.i.c) , al. 5-8.

<sup>51</sup>Standardet Minimale të Pavarësisë Gjyqësore, Shoqata Ndërkombëtare e Avokatëve (IBA) (1982).  
<<http://www.ibanet.org/Document/Default.aspx?DocumentUid=bb019013-52b1-427c-ad25-a6409b49fe29>>

<sup>52</sup>Magna Carta e Gjyqtarëve, Ceje, Këshilli i Evropës, Strasburg, (2010).

<sup>53</sup>po aty.

<sup>54</sup>USAID, Udhëzues për promovimin e pavarësisë dhe paanshmërisë gjyqësore, PN-ACM-007.

<[https://pdf.usaid.gov/pdf\\_docs/PNACM007.pdf](https://pdf.usaid.gov/pdf_docs/PNACM007.pdf)>

<sup>55</sup>po aty.

<sup>56</sup>po aty.

<sup>57</sup>po aty.

<sup>58</sup>Opinion nr. 17 (2014), paragrafët 29, 39.

<sup>59</sup>po aty, paragrafët 29, 44.

<sup>60</sup>Këshilli Konsultativ i Gjyqtarëve Evropianë (CCJE) - opinion nr. 20 roli i gjykatave në lidhje me zbatimin uniform të ligjit (2017).



- Ankesa kundër gjyqtarit do të procedohet në mënyrë të shpejtë dhe të drejtë sipas një praktike të përshtatshme dhe gjyqtari do të ketë mundësinë të komentojë ankesën në fazën fillestare.<sup>61</sup>
- Të gjitha masat disiplinore do të bazohen në standardet e vendosura të sjelljes gjyqësore.<sup>62</sup>

Në përgjithësi rekomandohet që Këshilli i Lartë Gjyqësor të jetë autoriteti përfundimtar që do të vlerësojë çështjet që lidhen me disiplinën dhe shkarkimin e gjyqtarëve. Megjithatë, ekzekutivi nuk duhet të jetë pjesë e këshillit apo vendimmarrjes për çështjet disiplinore.<sup>63</sup>

Këshilli Konsultativ i Gjyqtarëve Evropianë (CCJE), kur merret me çështjet e etikës dhe disiplinës në Opinionin e saj Nr. 3 (2002), ka theksuar nevojën për të bërë dallimin e qartë midis këtyre dy çështjeve: etikës (sjellja profesionale) dhe disiplinës (veprimet e ndërmarra në shkelje të etikës).<sup>64</sup> CCJE vëren se organi përgjegjës për etikën duhet të jenë vetë gjyqtarët, ose këshilli, nëse ky Këshill “nuk ka funksion disiplinor ose ka një organ të veçantë për çështjet disiplinore me përbërje të veçantë brenda Këshillit Gjyqësor”.<sup>65</sup> Nëse Këshilli ka natyrë disiplinore, atëherë rekomandohet krijimi i komisionit të etikës, funksioni i vetëm i të cilit do të ishte hartimi dhe monitorimi i rregullave të etikës profesionale.<sup>66</sup> Kjo lejon një ndarje të qartë midis roleve të respektimit të sjelljes etike dhe procedimit disiplinor, duke siguruar që organi përgjegjës për etikën të jetë i ndryshëm nga ai që trajton masat disiplinore për shkelje të disiplinës brenda gjyqësorit.

Në këtë rast, organi disiplinor është mekanizmi për të adresuar dhe korrigjuar sjelljen e pahijshme ose shkeljet e etikës dhe disiplinës midis anëtarëve gjyqësorë. Duke vepruar kështu, organi disiplinor mund të jetë në gjendje të ndryshojë kulturën gjyqësore.

Në Opinionin nr. 3, CCJE ka vënë në dukje se inspektoratet gjyqësore, “në bazë të vëzhgimeve të tyre të sjelljes së gjyqtarëve, mund të kontribuojnë në zhvillimin e të menduarit etik; pikëpamjet e tyre mund të bëhen të njohura përmes raportet e tyre vjetore”. Më tej theksohet se autoriteti i pavarur i përfshirë në procedimet

---

<sup>61</sup>Deklarata e Montrealit Deklarata Universale për Pavarësinë e Drejtësisë, shoqata ndërkombëtare e pavarësisë së gjyqësorit dhe paqes botërore (jiwp) (1983).

<sup>62</sup>po aty.

<sup>63</sup>CDL-AD(2007)028 Emërimet Gjyqësore (raporti), para. 4, 10, 18-20, 25, 37. CDL-INF(1998)009 Opinion mbi ndryshimet e fundit në ligjin për dispozitat kryesore kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, para. 16, cituar në CDL-AD(2007)028 Emërimet Gjyqësore (raporti), para.34.

<sup>64</sup>Opinionin Nr.10, Këshilli Konsultativ i Gjyqtarëve Evropianë (KKGJJE) në vëmendje të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës për Këshillin për Gjyqësorin në shërbim të shoqërisë (2007).

<https://rm.coe.int/168074779b>

<sup>65</sup>po aty.

<sup>66</sup>po aty.



disiplinore, nëpërmjet publikimit të vendimeve të tyre, mund të jetë një formë e ndërjegjësimi efektiv për vlerat pozitive të kulturës gjyqësore.

Gjithsesi, duhet thënë se eksperiencat nga shumë vende çojnë në aksiomën se "rregullat më të mira institucionale nuk funksionojnë pa vullnetin mirë të personave që janë përgjegjës për implementimin dhe aplikimin e tyre".<sup>67</sup> Kjo reflekton nevojën për një kulturë të pavarësisë së gjyqësorit, e cila përfaqëson një ndërtesë kryesore për funksionimin e një shoqërie moderne demokratike. Besimi i publikut në drejtësinë dhe integritetin e gjyqësorit nxit një mjedis ku ligji zbatohet në mënyrë të drejtë dhe pa përcartje, duke ndihmuar në ruajtjen e parimeve themelore të drejtësisë dhe lirisë individuale.

### *Rasti i Polonisë*

Polonia është anëtare e Bashkimit Evropian që nga 1 maji 2004.<sup>68</sup> Në vitin 2017, ngjashëm në harkun kohor si Shqipëria, gjyqësori i Polonisë iu nënshtrua një reforme me qëllimin e për të "rritur përgjegjshmërinë demokratike të gjyqësorit polak".<sup>69</sup> Polonia është zgjedhur si një rast studimor për shkak të shqetësimeve të saj të vazhdueshme për sundimin e ligjit në lidhje me pavarësinë e sistemit gjyqësor në vitet e fundit<sup>70</sup> dhe perceptimit të ulët të besimit nga qytetarët për pavarësinë e drejtësisë polake.<sup>71</sup> Analiza do të fokusohet veçanërisht në regjimin disiplinor të vendosur në kuadër të reformës në drejtësi në Poloni.

Reforma gjyqësore polake, e cila u zbatua me synimin për të "rritur efikasitetin e gjykatës, për të zvogëluar "korporatizmin gjyqësor", dhe për të rritur përgjegjshmërinë dhe profesionalizmin e gjyqtarëve dhe për të rivendosur besimin e publikut në gjyqësor"<sup>72</sup>, solli këto ndryshime këto<sup>73</sup>:

- (i) Përpara reformës në drejtësi, 15 nga 25 anëtarë të Këshillit Kombëtar të Gjyqësorit (National Council of the Judiciary - NCJ) zgjidheshin nga kolegët e tyre. Pas reformës në drejtësi, legjislatura u përfshi në

<sup>67</sup> J. E. Meyer, B. Rowan, American Journal of Sociology Vol. 83, No. 2 (1977).

<sup>68</sup> Polonia <[https://european-union.europa.eu/principles-countries-history/country-profiles/poland\\_en](https://european-union.europa.eu/principles-countries-history/country-profiles/poland_en)>

<sup>69</sup> Komisioni i Venecias, Opinioni nr. 977/2020, datë 16.11.2020, p. 3.

<[https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-PI\(2020\)002-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-PI(2020)002-e)>

<sup>70</sup> po aty, fq 3.

<sup>71</sup> Komisioni Evropian, Raporti i Shtetit 2023, Poloni, Dokument Institucional 245 (2023), f. 15.

<[https://economy-finance.ec.europa.eu/system/files/2023-06/ip245\\_en.pdf](https://economy-finance.ec.europa.eu/system/files/2023-06/ip245_en.pdf)>

<sup>72</sup> GRECO, Shtojcë në Raportin e Vlerësimit të Raundit të Katërt Polonia, (Rregulla 34), Miratuar nga GRECO në Mbledhjen e 80-të Plenare (Strasburg, 18-22 qershor 2018), f. 5. <<https://rm.coe.int/addendum-to-the-fourth-round-evaluation-report-on-poland-rule-34-adopt/16808b6128>>

<sup>73</sup> Opinioni i Komisionit të Venecias nr. 977/2020, datë 16 janar 2020

<[https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-PI\(2020\)002-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-PI(2020)002-e)> dhe Shtojca GRECO për Raporti i Vlerësimit të Raundit të Katërt për Poloninë, i miratuar nga GRECO në Mbledhjen e 80-të Plenare (Strasburg, 18-22 qershor 2018) <<https://rm.coe.int/addendum-to-the-fourth-round-evaluation-report-on-poland-rule-34-adopt/16808b6128>>



- zgjedhjen e anëtarëve gjyqësorë të NCJ-së, ku 15 do të zgjidheshin nga Parlamenti në vend të gjyqtarëve;
- (ii) Pas reformës në drejtësi, Presidenti do të propozonte kandidatë për postin e Kryetarit të Gjykatës së Lartë;
  - (iii) Ministri i Drejtësisë mori rolin e Prokurorit të Përgjithshëm dhe fitoi kompetencën për të emëruar/shkarkuar kryetarët e gjykatave më të ulëta sipas gjykimit të tij gjatë periudhës kalimtare prej gjashtë muajsh;
  - (iv) Ministri i Drejtësisë mori edhe kompetenca të tjera "disiplinore" kundrejt kryetarëve të gjykatave dhe kryetarëve të gjykatave më të larta.<sup>74</sup>
  - (v) U krijuan dy dhoma të reja brenda Gjykatës Supreme: Dhoma e Disiplinës dhe Dhoma e Shqyrtimit të Jashtëzakonshëm dhe Çështjeve Publike (Dhoma e Jashtëzakonshme).<sup>75</sup>
  - (vi) U prezantuan rregullime të reja përsa i përket moshës së daljes në pension, emërimet dhe procedimet disiplinore.

Komisioni i Venecias vuri në dukje në Opinionin e tij Nr. 977/2020, se "[Komisioni i Venecias] nuk ka mbrojtur modelin e një gjyqësori vetëqeverisës si një standard të përgjithshëm dhe se ai është shumë i vetëdijshëm për diversitetin e sistemeve ligjore në Evropë në këtë drejtim."<sup>76</sup> Do të thotë se emërimet gjyqësore të bëra nga pushteti ekzekutiv nuk është gjithmonë një reflektim i një pengese të parimit të pavarësisë së gjyqësorit. Megjithatë, pranohet se krijimi i këshillave gjyqësorë është një hap pozitiv, veçanërisht në demokracitë më të reja ku gjyqësori historikisht është përballur me nënshtrimin ndaj degëve të tjera të qeverisë.<sup>77</sup>

Në Poloni, Këshilli Kombëtar i Gjyqësorit (NCJ - homolog i Këshillit të Lartë Gjyqësor në Shqipëri), u krijua për të "mbrojtur pavarësinë e gjykatave dhe gjyqtarëve".<sup>78</sup> NCJ ka një përbërje të ndryshme në krahasim me KLGJ-në në Shqipëri, megjithëse qëllimi i tyre është i njëjtë.<sup>79</sup>

---

<sup>74</sup>Ky model krijoi një strukturë hierarkike vartësie brenda gjyqësorit, në çështjet administrative, me Ministrin e Drejtësisë/Prokurorin e Përgjithshëm në krye.

<sup>75</sup>Këto dhoma të reja u plotësuan me gjyqtarë të sapoemëruar, të përzgjedhur nga NCJ-ja e re, dhe iu besuan kompetenca të veçanta – duke përfshirë kompetencën e Dhomës së Jashtëzakonshme për të shfuqizuar vendimet përfundimtare të marra nga gjykatat më të ulëta ose nga vetë Gjykata e Lartë me anë të rishikimit të jashtëzakonshëm, ose kompetenca e Dhomës së Disiplinës për të disiplinuar gjyqtarët e tjerë. Kjo i vendosi këto dhoma të reja mbi të gjitha të tjerat dhe krijoi de fakto një "Gjykatë të Lartë brenda një Gjykate Supreme". Dhoma disiplinore ishte përgjegjëse për shqyrtimin e vendimeve të nxjerra në procedurat disiplinore kundër gjyqtarëve.

<sup>76</sup>Opinionin i Komisionit të Venecias nr. 977/2020, 16 janar 2020, f. 9.

[https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-PI\(2020\)002-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-PI(2020)002-e)

<sup>77</sup>po aty.


<sup>78</sup>Kushtetuta polake, neni 186. [https://www.constituteproject.org/constitution/Poland\\_1997#s56](https://www.constituteproject.org/constitution/Poland_1997#s56)

<sup>79</sup>Kushtetuta e Shqipërisë, neni 147. "Këshilli i Lartë Gjyqësor siguron pavarësinë, përgjegjshmërinë dhe funksionimin e duhur të pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë".

[https://www.gjk.gov.al/web/constitution\\_of\\_albania\\_1722.pdf](https://www.gjk.gov.al/web/constitution_of_albania_1722.pdf)



**Tabela 1: Përbërja e Këshillit të Lartë Gjyqësor (Shqipëri) dhe Këshillit Kombëtar të Gjyqësorit (Poloni)**



Pas reformës në drejtësi, në Poloni u ngritën shqetësime mbi ndryshimet që rrodhën nga reforma. Ndryshimet i përkisnin rënies së numrit të gjyqtarëve që ishin pjesë të NCJ-së, riorganizimit të NCJ, Ministri i Drejtësisë po zëvendësonte kryetarët e gjyqtarëve në një masë të lartë, si dhe rritjes në numrin e procedimeve disiplinore ndaj gjyqtarëve. Për shkak të këtyre ndryshimeve, një numër gjykatash polake paraqitën ankesa në Gjykatën e Drejtësisë së Bashkimit Evropian (GJED) "për vendime paraprake nëse pjesë të gjyqësorit polak pas reformës mund të konsiderohen si të pavarura".<sup>80</sup>

GJED-ja vendosi për këtë çështje duke vënë në dukje se një gjykatë nuk është një gjykatë e pavarur dhe e paanshme kur "rrethanat objektive në të cilat është formuar ajo gjykatë, karakteristikat e saj dhe mjetet me të cilat janë emëruar anëtarët e saj janë në gjendje të shkaktojnë dyshime të ligjshme [...] për ndikimin e drejtpërdrejtë ose të tërthortë të legjislativit dhe ekzekutivit dhe neutralitetin e tij [...]".<sup>81</sup> Lidhur me emërimin e anëtarëve të gjykatës brenda NCJ-së, GJED-ja pranoi se megjithëse faktorët individualë mund të mos ngrenë shqetësime në veçanti, kur konsiderohen kolektivisht së bashku me kontekstin e procesit të vendimmarrjes, ata mund të "hedhin dyshime mbi pavarësinë e një organi të përfshirë. në procedurën e emërimit".<sup>82</sup> Përvojat dhe sfidat me të cilat përballen vendet e tjera, si zhvillimet në Poloni të shqyrtuara nga GJED-ja, mund të ofrojnë mësim të vlefshme për rafinimin dhe forcimin e mekanizmave ekzistues disiplinor në Shqipëri. Duke shqyrtuar këto raste, Shqipëria mund të vlerësojë se sa mirë funksionon sistemi i saj

<sup>80</sup>Opinionii i Komisionit të Venecias nr. 977/2020, f 5.

<sup>81</sup>Opinionii i Komisionit të Venecias nr. 977/2020, po aty, duke cituar CJEU C-585/18 - AK (Pavarësia e Dhomës Disiplinore të Gjykatës së Lartë) Vendimi i Gjykatës (Dhoma e Madhe) i datës 19 nëntor 2019, AK dhe të tjerët kundër Sązy Najwyżs , CP v Sąd Najwyższy dhe DO v Sąd Najwyższy <<https://eur-lex.europa.eu/legal-content/en/TXT/PDF/?uri=ecli:ECLI%3AEU%3AC%3A2019%3A982>>

<sup>82</sup>Opinionii i Komisionit të Venecias Nr. 977/2020, duke cituar C-585/18 - AK (Pavarësia e Dhomës Disiplinore të Gjykatës së Lartë), f. 5.



disiplinor, ose ndoshta dhe të identifikojë pjesët që kanë nevojë për ndryshime me qëllim garantimin e mëtejshme të pavarësisë dhe paanshmërisë.

Reforma gjyqësore rezultoi në krijimin e dy dhomave të reja të Gjykatës së Lartë: Dhoma e Disiplinës (Izba Dyscyplinarna) dhe Dhoma e Shqyrtimit të Jashtëzakonshëm dhe Çështjeve Publike (Izba Kontroli Nadzëyczajnej i Spraë Publicznych), si dhe apeli i jashtëzakonshëm (skarga nadzëyc) në sistemin ligjor polak.<sup>83</sup> Akti i vitit 2017 për Gjykatën e Lartë i siguron Prokurorit të Përgjithshëm, ndër të tjera, kompetencën për të bërë një ankim të jashtëzakonshëm kundër një vendimi përfundimtar (orzeczenie) të një gjykate të zakonshme ose të një gjykate ushtarake që përfundon procedimin në një çështje nëse (1) vendimi shkel parimet ose liritë dhe të drejtat e njeriut të përcaktuara në Kushtetutë dhe/ose; (2) vendimi shkel rëndë ligjin nëpërmjet keqinterpretimit ose zbatimit të tij të gabuar, dhe/ose (3) ka një kontradiktë të dukshme ndërmjet gjetjeve të rëndësishme të gjykatës dhe përmbajtjes së provave të mbledhura në këtë rast - dhe vendimi nuk mund të ndryshohet ose ndryshuar sipas ankesave të tjera të jashtëzakonshme".<sup>84</sup>

Në thelb, qeveria e Polonisë është vënë para përgjegjësisë mbi mungesën e një gjyqësori të pavarur dhe të paanshëm. Gjendja vazhdoi e tillë deri në momentin kur GJED-ja vendosi se "masat e miratuara në këtë mënyrë nga legjislatura polake janë të papajtueshme me garancitë e aksesit në një gjykatë të pavarur dhe të paanshme, të krijuar më parë me ligj"<sup>85</sup>, duke mbështetur urdhrin e Komisionit që "Republika e

---

<sup>83</sup> *Walesa v Poland*, App no 50849/21 (12 tetor 2022). Paraqitja e apelit të jashtëzakonshëm sipas Aktit të vitit 2017 për Gjykatën e Lartë u bë në bazë të Ustawa z dnia 8 grudnia 2017 o Sądzie Najwyższym; "Akti i 2017 mbi Gjykatën e Lartë", datë 8 dhjetor 2017. Në *Walesa v Polonië*, GJEDNJ konstaton se ka pasur shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës në lidhje me të drejtën për një gjykatë të pavarur dhe të paanshme të themeluar me ligj, ku gjykata vëren "Siç është vënë në dukje nga Gjykata në Grzęda, e gjithë sekuenca e ngjarjeve - duke përfshirë veçanërisht ligjet për riorganizimin e gjyqësorit në Poloni - ka treguar qartë se reformat e njëpasnjëshme gjyqësore kanë synuar dobësimin e pavarësisë së gjyqësorit. duke filluar nga parregullsitë e rënda në zgjedhjen e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese në dhjetor 2015, më pas, në veçanti, në rimodelimin e NCJ-së dhe ngritjen e dhomave të reja në Gjykatën e Lartë, duke zgjeruar kontrollin e Ministrit të Drejtësisë mbi gjykatat dhe duke shtuar ose rolin e saj në çështjet e disiplinës gjyqësore Si rezultat i reformave të njëpasnjëshme, gjyqësori – një degë autonome e pushtetit shtetëror – është ekspozuar ndaj ndërhyrjeve nga pushteti ekzekutiv dhe legjislativ dhe si rrjedhim është dobësuar ndjeshëm (shih Grzęda, § 358). " Çështjet e gjetura nga gjykata janë (1) procedura e dëmtuar për emërimet gjyqësore që përfshin KKGJ-në, siç është krijuar në bazë të Aktit Ndryshues të vitit 2017, i cili në thelb dhe vazhdimisht ndikon në pavarësinë e gjyqtarëve të emëruar në këtë mënyrë, (2) gjyqtarët e emëruar në dy dhoma të tëra të Gjykata e Lartë nuk plotëson kërkesat e një "gjykate të pavarur dhe të krijuar me ligj", (3) kompetencën ekskluzive të Dhomës së Shqyrtimit të Jashtëzakonshëm dhe Çështjeve Publike të Gjykatës së Lartë në çështjet që përfshijnë pretendimin për mungesë pavarësie nga ana e gjyqtari ose gjykata, (4) të metat e procedurës së jashtëzakonshme të ankesës dhe (5) kompetenca ekskluzive e Dhomës së Shqyrtimit të Jashtëzakonshëm dhe Çështjeve Publike të Gjykatës Supreme për t'u marrë me ankesat e jashtëzakonshme.

<sup>84</sup> Akti i 2017 mbi Gjykatën Supreme, Seksioni 89. Gjetur në *Walesa kundër Polonisë*, Aplikacioni nr. 50849/21 (12 tetor 2022), para 33.

<sup>85</sup> Vendimi, Çështja C-204/21, *Commission v Poland* (Independence and private life of judges), Press Release No 89/23. <<https://curia.europa.eu/jcms/upload/docs/application/pdf/2023-06/cp230089en.pdf>> "GJED, duke u mbështetur në jurisprudencën e saj të mëparshme [Aktgjykimi i 15 korrikut 2021, Komisioni kundër Polonisë





Polonisë t'i paguajë Komisionit Evropian një gjobë periodike prej 1 000 000 euro në ditë, nga data në të cilën ky urdhër i është njoftuar Republikës së Polonisë dhe deri në momentin kur ai Shtet Anëtar respekton detyrimet që rrjedhin nga urdhri i Komisionit së datës 14 korrik 2021<sup>86</sup>.<sup>87</sup> Në zbatimin të kësaj mase, BE pengoi zbatimin e RRF-së, fondin e rimëkëmbjes së COVID-19 të BE-së, derisa Polonia të bënte ndryshime ligjore, të cilat rrjedhimisht çuan në shpërbërjen e Dhomës Disiplinore të Gjykatës së Lartë.<sup>88</sup>

Në këtë proces, gjykata e Lartë polake krijoi "një test që synon të përcaktojë ndikimin e parregullsive në emërimin e gjyqtarëve në ligjshmërinë e përbërjes së gjykatës" në vitin 2020 pas shpërbërjes së Dhomës Disiplinore.<sup>89</sup> Një tjetër test u prezantua më vonë si pjesë e një Ligji për ndryshimin e Gjykatës së Lartë.<sup>90</sup>

Ndërsa Polonia mund të mos shërbejë si një model ideal për emulim, është ende e arsyeshme të shqyrtohen elementë në sistemin gjyqësor të Shqipërisë që kanë ngjashmëri me ato në Poloni. Në seksionin vijues, do të kryhet analiza e Këshillit të Lartë të Drejtësisë (KLD), si autoriteti i mëparshëm kushtetues, i kryesuar nga Presidenti i Republikës, me kompetenca për emërimet, vlerësimin profesional dhe etik, ngritja në detyrë, transferimi, masa disiplinore ndaj gjyqtarëve. NCJ në Poloni, njëlloj si në Shqipëri, pati një ndikim të drejtpërdrejtë në pavarësinë e gjyqtarëve, veçanërisht në lidhje me ngritjen në detyrë, transferimin, procedimet disiplinore, shkarkimin dhe daljen në pension të parakohshëm. Në rastin e NCJ-së, është shqyrtuar nga GJEDNJ dhe CCJE, të cilat kanë rekomanduar që

[ç]do vendim në lidhje me emërimin e gjyqtarit, karrierën dhe masat disiplinore të rregullohen me ligj, të bazuara në kritere objektive dhe të merren nga një

---

(Regjimi disiplinor për gjyqtarët), C-791/19] rithekson vlerësimin e saj se Dhoma Disiplinore e Gjykatës së Lartë nuk e plotëson kërkesën Për pavarësinë dhe paanshmërinë Nga kjo del se perspektiva e thjeshtë, për gjyqtarët e thirrur për të zbatuar ligjin e BE-së, për të rrezikuar që një organ i tillë të vendosë për çështje që kanë të bëjnë me statusin e tyre dhe kryerjen e detyrave të tyre, veçanërisht duke autorizuar procedimi penal kundër tyre ose arrestimi i tyre ose duke miratuar vendime në lidhje me aspekte thelbësore të punësimit, të sigurimeve shoqërore ose të regjimit të pensionit të zbatueshëm ndaj tyre, mund të cenojë pavarësinë e tyre".

<sup>86</sup> Order of the Vice-President of the Court of 14 July 2021 in Case [C-204/21 R](#) (see also press release No [127/21](#)).

<sup>87</sup> Order of the Vice-President of the Court of 27 October 2021 in Case [C-204/21 R](#) (see also press release No 192/21).

<sup>88</sup> J Jaracqewski, Europe's Sick Success Child: Poland is not all lost ... yet., VerfBlog, 2023/10/11, <<https://verfassungsblog.de/europes-sick-success-child/>>, DOI: 10.59704/03e824be4d469ec6. Under the RRP in 2023-2024, "Poland committed to reform the disciplinary regime for judges and to set up a review process before an independent court for judges affected by decisions of the Disciplinary Chamber of the Supreme Court." Venice Commission Opinion No. 977/2020.

<[https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-PI\(2020\)002-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-PI(2020)002-e)>

<sup>89</sup>Kjo ka të bëjë me emërimet e parregullta në drejtësi të bëra nga NCJ pas reformës së 2018 në Poloni. M Szwed, Testimi i pavarësisë gjyqësore: Mbi zhvillimet e fundit në krizën polake të sundimit të ligjit, VerfBlog, 2022/8/18. <<https://verfassungsblog.de/testing-judicial-independence/>>, DOI: 10.17176/20220818-182010-0>

<sup>90</sup>po aty.



autoritet i pavarur ose t'u nënshtrohen garancive ligjore, për shembull rishikimi gjyqësor, për të siguruar që ai të mos merret ndryshe sesa në bazë të kriterëve të vendosura me ligj. Konsideratat politike duhet të jenë të papranueshme, pavarësisht nëse ato bëhen në kuadër të Këshillave Gjyqësorë, Ekzekutiv apo Legjislativ.”<sup>91</sup>

Testi i prezantuar nga gjykata e Lartë polake, me qëllim për të analizuar pavarësinë dhe paanshmërinë e gjyqtarëve që u zgjodhën nga NCJ, që përfshin elementë që duhen rishikuar në raste kur pavarësia e një gjyqtari vendoset në dyshim, si "nivelin e gjyqësorit në të cilin është bërë emërimi; nëse emërimi ishte kërkuar për herë të parë apo për një promovim gjyqësor; shkelje të tjera të ligjit gjatë procedurës së emërimit; marrëdhëniet me [legjislativin/pushtetin ekzekutiv]; nëse një person i rekomanduar për emërim kishte kompetencë dukshëm inferiore ndaj kundërkandidatit të tyre"<sup>92</sup>, mund të jetë një qasje për t'u reflektuar. Szëed vëren në blogun e tij në Verfassungsblog nëse një test i tillë është me të vërtetë i nevojshëm, duke qënë se GJEDNJ në çështjen Reczkoëicz, vendosi se emërimi gjyqtari me kërkesë të NCJ-së së riorganizuar (e konstatuar si jo organ i pavarur) është një faktor i mjaftueshëm për të deklaruar shkeljen e Neni 6 § 1 i KEDNJ.<sup>93</sup> Testi alternativ i paraqitur në Poloni në amendamentin e Aktit për Gjykatën e Lartë prezantoi dispozita që autorizojnë gjykatat të shqyrtojnë, me kërkesë të palës në proces, "përputhshmërinë e një gjyqtari me kërkesat e pavarësisë dhe paanësisë, duke marrë parasysh rrethanat që lidhen me emërimin dhe sjelljen e gjyqtarit emërimit".<sup>94</sup> Përkundër disa kritikave për amendamentin<sup>95</sup>, shqyrtimi i masave të tilla në Shqipëri mund të jetë i vlefshëm, veçanërisht në fusha që nuk mbulohen nga legjislacioni ekzistues, si vlerësimi i sjelljes së gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe ndikimi i tyre në pavarësinë e gjyqësorit (të cilat përbëjnë elementë të kulturës gjyqësore<sup>96</sup>). Një test i këtij lloji mund t'i bëjë më të qarta standardet për vlerësimin

---

<sup>91</sup> CCJE-BU(2020)3, Raport mbi pavarësinë dhe paanshmërinë gjyqësore në shtetet anëtare të Këshillit të Evropës (botimi 2019), 30 mars 2020.

<sup>92</sup> Shihni për më shumë detaje M Szwed mbi temën e testit të prezantuar nga Gjykata e Lartë e Polonisë. Gjykata e Lartë shqyrtoi me kujdes procesin e përzgjedhjes së gjyqtarit dhe lidhjet e tij me Ministrinë e Drejtësisë, ndërsa vlerësoi "pavarësinë dhe paanshmërinë" e JD, gjyqtarit të emëruar në mënyrë të parregullt të gjykatës së apelit.

<sup>93</sup> po aty.

<sup>94</sup> po aty.

<sup>95</sup> Shihni për më shumë detaje M Szwed mbi këtë temë.

<sup>96</sup> *Dolińska-Ficek dhe Ozimek kundër Polonisë*, para 86. Dispozitat përkatëse të Aktit të vitit 2011 për KKGJ-në, të ndryshuar me Aktin Ndryshues të 2017, neni 11a, i cili vë në dukje procedurën e zgjedhjes së kryetarit të një gjykate të rrethit, një gjykate rajonale ose ushtarake, ose një gjykate të apelit, gjykatës administrative të rrethit ose gjykatës së rrethit ushtarak, kryetari i Kuvendit do të përgatisë një dosje me "informacion mbi arritjet gjyqësore të kandidatit, duke përfshirë gjykime të rëndësishme shoqërore ose precedentë, dhe informacione përkatëse mbi kulturën gjyqësore të kandidatit, të zbuluar kryesisht gjatë inspektimeve dhe lustrimeve."



e sjelljes dhe kualifikimeve të gjyqtarëve, gjë që do të përmirësonte transparencën e gjyqësorit.

Seksioni tjetër synon të shqyrtojë evolucionin e pavarësisë së gjyqësorit gjatë fazave të tranzicionit 1991-1998, 1998-2016 dhe 2016-tani. Ideja është të kuptojmë nëse në 30 vitet e fundit që ne jemi zhvendosur rreth institucioneve, a kemi arritur në modelin që nuk do të garantonte asnjë ndërhyrje nga pushteti ekzekutiv, asnjë korrupsion midis anëtarëve të gjyqësorit dhe një rritje të besimit të anëtarëve në sistemin e drejtësisë.



### 3 Vështrim historik mbi mandatin kushtetues dhe statusin e pavarësisë së strukturave gjyqësore gjatë tranzicionit

Evoluimi i sistemit gjyqësor në Shqipëri mund të ndahet në tre perioda: Perioda e parë, nga viti 1991 deri më 1998 me hyrjen në fuqi të Kushtetutës së 1998. Kjo periudhë karakterizohet nga përpjekjet e para të krijimit të bazave të pavarësisë së një sistemi gjyqësor të pavarur. Perioda e dytë, nga viti 1998 deri më 2016, është një periudhë tranzitore, me prova dhe ndryshime për të provuar modele të ndryshme vetëqeverisjeje të gjyqësorit dhe përpjekjes për të luftuar korrupsionin në sistem.<sup>97</sup> Kjo periudhë përfundon me reformën në drejtësisë në vitin 2016, e cila është pikënisja e periodës së tretë. Perioda e tretë, nga viti 2016 e deri më tani, parashtron sistemin e reformuar të drejtësisë, pas ndryshimeve substanciale të Kushtetutës në vitin 2016. Kjo periudhë karakterizohet nga themelimi i institucioneve të reja të drejtësisë, ndarjes më të qartë të funksioneve midis organeve, më tepër përgjegjësi dhe llogaridhënie, si dhe një sistem gjyqësor që synon të vetëqeveriset dhe të jetë i pavarur nga pushtetet e tjera.

Kryerja e analizës mbi kulturën gjyqësore nuk mund të kryhet në vakum, pa kryer një analizë të përqendruar në kuptimin dhe ndryshimet që kanë ndodhur në mandatin kushtetues dhe pavarësinë e strukturave gjyqësore gjatë periudhës së tranzicionit. Në këtë seksion, do të përfshihen aspektet kryesore të trajtimit të pavarësisë së gjyqësorit, në bazë të gjetjeve nga krahasimi i sistemeve gjyqësore ndër kohë në bazë të tabelës së standardeve.

Duke synuar dhënien e një përgjigjeje të hipotezave të parashikuara më sipër, ky seksion kërkon të paraqesë një panoramë në kohë të evoluimit të drejtësisë dhe në veçanti, të organet që kanë pasur tagrin për të kryer inspektimin dhe disiplinimin e organeve të drejtësisë, duke u ndalur në tre periudha: 1991-1998, 1998-2016, dhe 2016 deri tani.

Periudha e parë e tranzicionit, menjëherë pas rënies së regjimit komunist, u karakterizua nga largimi gradual i elementeve të sistemit monist dhe krijimi i strukturave të reja. Ky proces i largimit të elementeve moniste u shoqërua me përpjekjet për të rikrijuar dhe reformuar sistemin gjyqësor. Institucione të reja u themeluan,<sup>98</sup> trajnimi dhe profesionalizimi i gjyqtarëve dhe prokurorëve u bënë

---

<sup>97</sup> Reforma në Drejtësi, Material shpjegues për ndryshime kushtetuese, <[https://www.reformanedrejttesi.al/sites/default/files/material\\_shpjegues\\_per\\_ndryshimet\\_kushtetuese\\_24.09.2015.pdf](https://www.reformanedrejttesi.al/sites/default/files/material_shpjegues_per_ndryshimet_kushtetuese_24.09.2015.pdf)>

<sup>98</sup> Ligji Nr. 7574, datë 24.6.1992, Për organizimin e drejtësisë dhe disa ndryshime në kodet e procedurave penale e civile, dha konturet e para të sistemit të drejtësisë pas ndryshimit të regjimit. Në këtë periudhë, sistemi gjyqësor përbëhej nga Gjykata e Kasacionit, Gjykata e Apelit, gjykatat e shkallës së parë dhe gjykatat ushtarake, si dhe prania e institucioneve të tjera si Prokuroria dhe Këshilli i Lartë i Drejtësisë.



pjesë e përpjekjeve për të siguruar një sistem gjyqësor më të pavarur nga ndikimet politike.<sup>99</sup> Kjo përbën reformën e parë institucionale të gjyqësorit.

Në fillim të 1991, themelimi, organizimi, dhe aktiviteti i sistemit gjyqësor u rregulluan nga ligji "Për Dispozitat Kryesore Kushtetuese"<sup>100</sup>, e cila zëvendësoi Kushtetutën e fundit të regjimit komunist.<sup>101</sup> Gjithsesi, këto elemente nuk patën ndryshime të konsiderueshme nga sistemi i mëparshëm, përveç rasteve kur këto binin në kundërshtim me strukturën e re kushtetuese.<sup>102</sup> U prezantua koncepti i përgjegjësisë disiplinore, duke nënkuptuar një zhvendosje drejt një sistemi gjyqësor më të përgjegjshëm.<sup>103</sup> Siç vëren Luarasi në studimin e tij mbi reformën ligjore dhe institucionale në vitin 1991-1997, "bashkë me reformën ligjore, u bënë përpjekje për të kryer një reformë institucionale. Të gjitha strukturat e shtetit totalitar u shkatërruan dhe në vend të tyre zunë struktura të reja institucionale [sipas modeleve perëndimore]".<sup>104</sup> Megjithatë, sfidat vazhduan për shkak të praktikave të rrënjësura dhe mungesës së përshtatjes së menjëhershme ndaj këtyre reformave.<sup>105</sup>

Pas një viti, u miratua një amendament i Dispozitave Kryesore Kushtetuese, në bazë të së cilës, u krijua Gjykata e parë Kushtetuese dhe Këshilli i Lartë i Drejtësisë (KLD).<sup>106</sup> KLD pati kompetenca të reja siç janë emërimi, promovimi, transferimi apo shkarkimi i gjyqtarëve, prokurorëve dhe hetuesve, caktimi i masave disiplinore etj.<sup>107</sup> Për shkak të natyrës quasi ekzekutive të KLD, u shfaqën problematika në lidhje me zbatimin e funksioneve të tij. Në disa vendime të GJK parashtrohet se KLD ndiqte procedura jo të rregullta në lirim nga detyra e gjyqtarit "për shkelje të rëndë të disiplinës në punë", "për shkelje të etikës së gjyqtarit", "për shkelje të ligjit dhe paaftësi në detyrë", duke mos i njoftuar, thirrur personat, apo lejimin e tyre për t'u dhënë mundësi për t'u mbrojtur.<sup>108</sup>

---

<sup>99</sup> Në ligjin Nr. 7491, datë 29.4.1991, Për Dispozitat kryesore kushtetuese, sanksionohet parimi kushtetues i ndarjes së pushteteve legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor, si dhe parimi i pavarësisë së gjykatave në ushtrimin e pushtetit gjyqësor. Neni 3 "Parimi themelor i organizimit shtetëror është ndarja e pushtetit legjislativ, ekzekutiv dhe atij gjyqësor", dhe Neni 5 "Pushtetin gjyqësor e ushtrojnë gjykatat që janë të pavarura dhe udhëhiqen vetëm nga ligji."

<sup>100</sup> Ligji nr. 7491, datë 29.4.1991.

<sup>101</sup> Shih më tepër OSCE, Analizë e sistemit ligjor në Shqipëri (2004), f 1.

<sup>102</sup> ibid.

<sup>103</sup> ibid.

<sup>104</sup> A Luarasi, Legal and Institutional Reform in Albania after the democratic revolution (1991-1997) (1997), p 33. < <https://www.nato.int/acad/fellow/95-97/luarasi.pdf> >

<sup>105</sup> ibid.

<sup>106</sup> Ligji nr 7561, datë 29.4.1991 "Mbi disa ndryshime dhe shtesa ndaj Ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 "Për Dispozitat Kryesore Kushtetuese". KLD ishte organi që mund të jepte masa për shkelje të disiplinës në punë ndaj gjyqtarëve, prokurorëve dhe hetuesve.

<sup>107</sup> Organizimi dhe administrimi i gjykatave në Shqipëri: Roli i kryetarëve të gjykatave, kancelarëve dhe asistentëve ligjorë në këndvështrimin e rekomandimeve të SEJ-it dhe në kuadrin e reformës në drejtësi në Shqipëri

<sup>108</sup> Gjykata Kushtetuese, Vendim Nr. 15, datë 3.6.1997. Gjykata e ka çmuar këtë si çënim të procesit të rregullt ligjor, dhe çënim i pavarësisë së gjyqtarëve dhe prokurorëve si subjekte të pushtetit gjyqësor të pavarur. Në këtë vendim, GJK çmoi se ishte e nevojshme që të bëhej një shtesë nenin 20 të ligjit nr.7574, datë 24.06.1992 "Për



Në vitin 1991-1998, parlamenti kishte një rol të gjerë në emërimin dhe përzgjedhjen e gjyqtarëve, pasi Kuvendi, me rekomandimin e Presidentit në disa raste, mund të emëronte (i) Kryetarin dhe nënkryetarin e Gjykatës së Kasacionit (Gjykata e Lartë)<sup>109</sup>; (ii) gjyqtarët e Gjykatës së Lartë<sup>110</sup>, (iii) Prokurorin e Përgjithshëm<sup>111</sup>; (iv) pesë nga 9 anëtarë të Gjykatës Kushtetuese<sup>112</sup>. Presidenti i Republikës ishte kryetar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë dhe Ministria e Drejtësisë ishte një nga anëtarët e Këshillit. Disa çështje në këtë hark kohor kanë të bëjnë me pavarësinë e gjyqësorit. Sipas GJEDNJ-së, "të rëndësishme në vlerësimin e pavarësisë (dhe paanshmërisë) të një gjykate janë 'mënyra e emërimit të anëtarëve të saj dhe mandati i tyre, ekzistenca e garancive kundër presioneve të jashtme dhe pyetja nëse organi paraqet një paraqitje të pavarësisë". Në këtë rast, politizimi i gjerë i procesit mund të ketë rrezikuar neutralitetin e gjyqësorit në Shqipëri.

KLD-ja kishte prerogativë të tij për të kontrolluar emërimin, transferimin e gjyqtarëve, vlerësimin periodik të gjyqtarëve, hetimin e ankimeve kundër gjyqtarëve, masat disiplinore dhe shkarkimin e gjyqtarëve.<sup>113</sup> Për sa i përket shkarkimit të gjyqtarëve, KLD-ja mund ta kryente këtë në rastet kur gjyqtarët kryenin një krim, kishin paaftësi mendore a fizike, akte apo sjellje që diskreditojnë pozitën dhe figurën e gjyqtarit, ose pamjaftueshmëri profesionale.<sup>114</sup> Në rastet kur gjyqtarët nën nivelin e Gjykatës së Lartë procedoheshin penalisht, kur këta të fundit procedoheshin penalisht, nëse KLD-ja nuk jepte pëlqimin e tij brenda 24 orëve nga njoftimi i akuzës, organi i procedimit penal duhej të lironte gjyqtarin. Në sistemin aktual, ky imunitet i gjyqtarit dhe ky rol i KLD-së (ose qoftë i KLGJ-së sot) nuk ekziston.

Në këtë periudhë, kultura gjyqësore karakterizohej nga dinamikat e trashëguara nga periudha e mëparshme, duke përfshirë ndikime të politikës në proceset gjyqësore dhe një nivel të caktuar të rezistencës ndaj ndryshimeve të shpejta.<sup>115</sup> Këto sfida rezultuan në një proces më të ngadalshëm të transformimit të sjelljeve dhe normave në sistemin gjyqësor, sidomos në rolin kontrollues të pushtetit ekzekutiv mbi çështjet që kanë të bëjnë me emërimet, statusin, karrierën dhe disiplinimin e funksionarëve të drejtësisë.<sup>116</sup>

---

organizimin e drejtësisë dhe disa ndryshime në Kodet e Procedurave Penale e Civile", me këtë përmbajtje:

"Kundër vendimit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë mund të bëhet ankim në Gjykatën e Kasacionit.

<sup>109</sup> Ligji nr 7561, datë 29.4.1991, Neni 6. Presidenti dhe anëtarët e Gjykatës së Lartë zgjidhen një herë në 7 vjet, me të drejtë rizgjedhjeje.

<sup>110</sup> Ligji nr 7561, datë 29.4.1991, Neni 6.

<sup>111</sup> Ligji nr 7561, datë 29.4.1991, Neni 6. Neni 14.

<sup>112</sup> Ligji nr 7561, datë 29.4.1991, Neni 18. 4 anëtarë të Gjykatës Kushtetuese zgjidhen nga Presidenti.

<sup>113</sup> Ligji nr 7561, datë 29.4.1991, Neni 147.

<sup>114</sup> ibid.

<sup>115</sup> Në tetor të vitit 2012 Qendra për Transparencë dhe të Drejtën e Informimit zhvilloi një anketim me 58% të numrit të përgjithshëm të gjyqtarëve. 25% e tyre ishin të mendimit se sistemi i drejtësisë është i korruptuar, ndërsa 58% besonin se sistemi perceptohej si i korruptuar. 50% e gjyqtarëve ishin të mendimit se sistemi gjyqësor nuk ishte i çliruar nga ndikimi politik.

<sup>116</sup> ibid.



Prezantimi i nocionit të përgjegjësise disiplinore mund të ishte një faktor kontribues i një sistemi ligjor më të përgjegjshëm.<sup>117</sup> Megjithatë, pengesat vazhduan për shkak të sjelljeve të rrënjosura dhe një reagimi të vonuar ndaj këtyre ndryshimeve.<sup>118</sup> Në vlerësimin e tij për reformën institucionale dhe sistemin ligjor shqiptar në vitet 1991-1997, Luarasi theksoi se

Ndërsa reforma ligjore mund të konsiderohej e suksesshme në përgjithësi, reforma institucionale nuk e përmbushi detyrën e vendosjes së shtetit të së drejtës dhe krijimit të një demokracie të qëndrueshme. Institucionet e sapokrijuara zbuluan mangësi. Autoritarizmi i periudhës së vjetër të regjimit komunist u shfaq mbi institucionet e reja. Po instalohet një ideologji në vend të shtetit ligjor, e cila shumë shpejt bëri që njerëzit të humbnin besimin. Këto institucione nuk i rezistuan provës së zjarrit. Në një farë mënyre ata nxitën rebelimin e vitit 1997 dhe u shpërbënë përballë ngjarjeve dramatike që gjeneruan kaos dhe anarki. Krijimi i institucioneve të qëndrueshme dhe efikase mbetet sine-qua-non për funksionimin e shtetit ligjor dhe demokracisë pluraliste në Shqipëri. Kriza e vitit 1997 ishte në radhë të parë një krizë institucionale.<sup>119</sup>

Ky është rasti i parë që nxjerr në pah mundësinë që elementët kulturorë të rrënjosur thellë mund të pengojnë ndryshimet strukturore brenda një shoqërie.

Nga miratimi i Kushtetutës së vitit 1998, dhe deri në amendimet e saj substanciale në vitin 2016<sup>120</sup>, ndarja e pushteteve dhe garantimi i pavarësisë së gjyqësorit nuk u arrit.<sup>121</sup> Arsyet në lidhje me këtë, sipas grupit të ekspertëve të lartë në raportin analitik dhe strategjinë për reformën në drejtësi, kishte të bënte me kakofininë e shkaktuar nga tradita e marrjes së ligjeve të vendeve të tjera dhe miratimit të tyre, pa marrë në konsideratë elementin kontekstual të zbatimit të ligjit në vend, apo dhe harmonizimin e atij ligji me kuadrin ligjor në tërësi.<sup>122</sup> Gjithashtu, thënë nga ekspertët, "Kushtetuta e vitit 1998 nuk ka arritur të izolojë sa dhe si duhet institucionet e pavarura nga ndikimi i shumicave politike. Po kështu Kushtetuta nuk ka arritur të sigurojë një mbikëqyrje të vërtetë dhe të efektshme të Kuvendit mbi qeverinë. Megjithatë, është e qartë për të gjithë aktorët dhe vëzhguesit e jetës politike dhe institucionale në Shqipëri se dështimi më i spikatur i Kushtetutës së vitit

---

<sup>117</sup>ibid.

<sup>118</sup>ibid.

<sup>119</sup> A Luarasi, *Legal and Institutional Reform in Albania after the democratic revolution (1991-1997)* (1997), p 33. <<https://www.nato.int/acad/fellow/95-97/luarasi.pdf>>

<sup>120</sup> Kushtetuta e miratuar në 1998 ka pësuar disa ndryshime në vitin 2008, për sa i përket ndryshimit të sistemit të votimit miks në sistemin proporcional rajonal, ndryshimi i mandatit të qeverisjes vendore nga tre në katër vjet, mënyra e zgjedhjes së presidentit, dhe vendosjes së një mandati të kufizuar pesë vjeçar për Prokurorin e Përgjithshëm. Këto ndryshime janë jashtë fokusit të analizës së këtij studimi.

<sup>121</sup> Draft 24/09/2015, Material shpjegues për ndryshimet kushtetuese, f 2. <[https://www.reformanedrejtesi.al/sites/default/files/material\\_shpjegues\\_per\\_ndryshimet\\_kushtetuese\\_24.09.2015.pdf](https://www.reformanedrejtesi.al/sites/default/files/material_shpjegues_per_ndryshimet_kushtetuese_24.09.2015.pdf)>

<sup>122</sup> Komisioni i reformës <<http://www.reformanedrejtesi.al/dokumenti-strategjik-dhe-plani-i-veprimit>>.



1998 ka qenë paaftësia e saj për të krijuar një sistem drejtësie të pavarur, të përgjegjshëm dhe efikas."<sup>123</sup>

Për sa i përket parregullsive në proceset disiplinore gjatë këtij harku kohor, Gjykata Kushtetuese është shprehur disa here mbi çështjet e shtetit të së drejtës dhe shkeljes së të drejtave të njeriut, që lindin nga mungesa e pavarësisë së KLD-së dhe mekanizmave të tjerë disiplinorë. Për të ilustruar, në Vendimin nr. 43, datë 4.6.1999, Gjykata Kushtetuese shprehet mbi vendimin nr.4, datë 10.11.1997, të Këshillit të Lartë i Drejtësisë, ku ka vendosur shkarkimin e kërkuesit Rushit Demo nga detyra e gjyqtarit, me motivacionin se: "pa shkaqe të arsyeshme nuk është paraqitur në punë për një kohë të gjatë". Gjykata Kushtetuese vëren se procesi i dëgjimit të gjyqtarit është shoqëruar me mangësi të mëdha që çënojnë parimin e paanësisë së Gjykatës në zgjidhjen e çështjeve.<sup>124</sup>

Megjithatë, Gjykata Kushtetuese ka konstatuar se përfshirja e Ministrisë së Drejtësisë është në proces nuk është një tregues i paracaktuar i shkeljes së paanshmërisë së procedimeve disiplinore. Në vendimin nr.11, datë 27.05.2004, Gjykata Kushtetuese u shpreh se

Nga njëra anë përbërja e KLD-së, ku 2/3 janë përfaqësues të gjyqësorit, dhe nga ana tjetër, funksionimi i tij mbi baza demokratike, e bëjnë këtë organ që të jetë objektiv dhe të marrë masa të drejta kur vërtetohen shkelje, si dhe të vihet në mbrojtje të gjyqtarëve ndaj akuzave të padrejta. Kështu që, për këtë organ pak rëndësi ka se kush bën propozimin. Jo vetëm kaq. Sipas nenit 16 shkronjës "ç" të ligjit për KLD-në, ky organ ka të drejtë dhe detyrë që të kryej verifikime për procedimin disiplinor të propozuar nga Ministri i Drejtësisë, në rastet kur çmohet dhe kërkohet nga KLD-ja. Në këto kushte KLD-ja ka dhe instrumentat e duhura, Inspektoriatin e tij, që të verifikojë çdo propozim që i vjen për procedimin disiplinor. Duke qenë kështu, fakti që sipas ligjit, Ministri ka të drejtë të kryej inspektime dhe në përfundim, kur vërteton shkelje që passjellin përgjegjësi disiplinore, të nis procedimin disiplinor, nuk përbën ndonjë zgjidhje me karakter antikushtetues, sepse nuk vjen në kundërshtim me nenet 7 e 145 të Kushtetutës.<sup>125</sup>

Në përgjithësi, Gjykata Kushtetuese në Shqipëri është shprehur se Kushtetuta e Shqipërisë garanton pavarësinë e pushtetit gjyqësor, duke u garantuar paprekshmërinë dhe palëvizshmërinë e gjyqtarëve pa arsye të arsyeshme, si dhe ndalimin e procedimit penal pa autorizimin e Këshilli i Lartë i Drejtësisë. Të drejtën e rishikimit të vendimeve gjyqësore kanë vetëm gjykatat".<sup>126</sup> Në këtë mënyrë, Gjykata Kushtetuese mban një qëndrim se kuadri ligjor në atë kohë ofronte modelin

---

<sup>123</sup> ibid.

<sup>124</sup> Gjykata Kushtetuese, Vendim Nr. 43, 4.6.1999.

<sup>125</sup> Gjykata Kushtetuese, Vendimi Nr. 11, 27.05.2004.

<sup>126</sup> po aty.





e nevojshëm për të garantuar pavarësinë e gjyqësorit, si në nivel institucional ashtu edhe në atë individual. Megjithatë, realiteti në këtë kohë ishte dukshëm i ndryshëm. Në analizën e sistemit të drejtësisë në Shqipëri të kryer nga grupi i ekspertëve të nivelit të lartë, vihet re se

Në kushtet e mungesës së një presioni të artikuluar nga publiku, të një marrëveshjeje të gjerë politike, si dhe nga mungesa e një tradite të pamjaftueshme demokratike të vendit, shumicat parlamentare dhe qeveritë e kohës janë mjaftuar me ndërhyrje të pjesshme e kozmetike në sistemin e drejtësisë, kryesisht të mbështetura vetëm me votat e shumicës. Ç'është më e keqja, vetë natyra e këtyre ndërhyrjeve ka krijuar hapësira për politikën, që në ndonjë rast synojë kontrollin mbi qeverisjen e institucioneve të drejtësisë për parandalimin e rreziqeve që mund t'i vijë politikës nga një drejtësi e pavarur. Politika nuk i ka shpëtuar tundimit për të ruajtur sa më shumë rol kontrollues në çështjet që kanë të bëjnë me emërimet, statusin, karrierën dhe disiplinimin e funksionarëve të drejtësisë, duke ndikuar në këtë mënyrë edhe mbi sjelljen e tyre. Ndoshta shembulli më i spikatur i kësaj prirjeje konstante është këmbëngulja për të ruajtur një rol ekskluziv të ekzekutivit në inspektimin e veprimtarisë së gjyqtarëve dhe në disiplinimin e tyre.<sup>127</sup>

Në nivelin e prokurorisë, ekzistonte gjithashtu një shqetësim gjithëpërfshirës mbi çështjen e pavarësisë. Për shembull, Prokurori i Përgjithshëm i propozonte Presidentit rekomandime për emërimet, ngritje në detyrë, transferime ose shkarkime. Përveç kësaj, ai kishte autoritetin të caktonte dhe të largonte drejtuesit dhe zëvendësdrejtuesit në departamentet e prokurorisë, të vendoste prokurorët në role të përkohshme, të fillonte masat disiplinore dhe të vendoste se çfarë sanksionesh do të zbatoheshin. Pavarësia e sistemit të prokurorisë u ndikua nga ky rregullim, i cili përqendroi vendimmarrje të rëndësishme në duart e prokurorit të përgjithshëm.<sup>128</sup> Në këtë kontekst, bazuar në rekomandimet e ekspertëve dhe organizatave ndërkombëtare, u ngrit një domosdoshmëri për të krijuar këshilla, ku për shembull, "një këshill prokurorie duhet të jetë në gjendje të japë pavarësi nga qeveria dhe të ndajë sistemin e prokurorisë nga politika, si dhe të kufizohet në çështje personale, të disiplinës, të caktimit të prokurorëve, trajnimit, vlerësimit dhe çështje të buxhetit".<sup>129</sup>

Pikat e mëposhtme janë reflektime të përgjithshme mbi pavarësinë e gjyqësorit në periudhën para reformës në drejtësi, duke u fokusuar në procesin disiplinor të anëtarëve të gjyqësorit:

---

<sup>127</sup>Komisioni Parlamentar Ad Hoc, Analiza e Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri (2015), f 8.

<sup>128</sup>po aty, f 280.

<sup>129</sup>po aty, f 15.



- KLD dhe Ministria e Drejtësisë, të cilat kontrollojnë disiplinën e gjyqtarëve, gjatë kryerjes së detyrës, nuk u kufizuan vetëm në detyrën e trajnimit të gjyqtarëve, por shqyrtonin edhe vendimet gjyqësore, duke shprehur mendimin e tyre sesi gjyqtarët zbatojnë ligjin material dhe procedural.
- Statistikat e KLD-së - pjesa dërrmuese e procedimeve disiplinore dhe shkarkimit nga detyra, bazohen në argumentin se gjyqtari ka zbatuar gabim ligjin material ose procedural në dhënien e vendimeve gjyqësore, çka përbën shkelje të pavarësisë së pushtetit gjyqësor.
- Realizimi i kontrollit të gjyqtarit nga pikëpamja e profesionalizmit dhe mospërfillja me detyrimin për të interpretuar ligjet, mund të ushtrohej nga KLD nëpërmjet kriterëve për rezultatet e arritura nga gjyqtari, duke mbajtur parasysh numrin e vendimet e tij, ato të ankimuara nga nivelet më të larta të gjyqtarëve në raport me ata që kanë mbetur në fuqi.
- Veprimtaria e KLD-së dhe ajo e Ministrisë së Drejtësisë ishte e diskutueshme. Ministria e Drejtësisë ka pasur të drejtën të kryejë inspektime në gjykata dhe gjyqtarë, si dhe të drejtën ekskluzive t'i propozojë KLD-së marrjen e masave disiplinore, përfshirë shkarkimin e gjyqtarëve. Edhe pse kjo nuk është shkelje e ndarjes së pushteteve dhe e pavarësisë së gjyqtarëve si parim, në demokracinë e brishtë të një vendi postkomunist si Shqipëria, linte hapësirë për ndërhyrje nga ekzekutivi dhe të tjerë.
- Gjykata Kushtetuese, në një kërkesë të Kolegjeve për ndikimin e Ministrisë së Drejtësisë në sistemin e drejtësisë, arsyetoi se ndikimi i Ministrisë së Drejtësisë do të ishte i pallogaritshëm nëse verifikimi dhe propozimi i masave disiplinore do të bëhej nga KLD në bazë të rregullimit ligjor (Vendimi nr. 3/2003).
- Shkelje e parimit të procesit të rregullt ligjor nga KLD është evidentuar në disa raste nga Gjykata Kushtetuese. Gjykata Kushtetuese ka shfuqizuar gjithashtu një nga nenet e rregullores "Për kompetencën për të ushtruar veprimtarinë e Këshillit të Lartë të Drejtësisë", e cila lejonte që vendimet për mënyrën e shqyrtimit të masave disiplinore t'i lireshin autoritetit që ka kërkuar veprimin.
- Gjykata Kushtetuese është shprehur se Inspektoratet e KLD-së dhe të MD, kanë të drejtë të kontrollojnë jo dhënien e drejtësisë, por administrimin e saj nga gjykatat e shkallës së parë dhe ato të apelit, të cilat të dyja janë bazë për fillimin dhe procedimin disiplinor. , i cili përfundon me vendimin e KLD-së, duke respektuar kërkesat dhe parimet e procesit të rregullt ligjor në kuptimin kushtetues.



Nga një këndvështrim teorik, Gloppen thekson se "një gjyqësor që funksionon mirë është thelbësor për të luftuar korrupsionin"<sup>130</sup>, por problemi është se "institucionet e drejtësisë janë vetë të korruptueshme".<sup>131</sup> Kjo konsiderohet një sfidë për gjyqësorin, veçanërisht kur korrupsioni mund të rrezikojë të ndërhyjë në mbajtjen e anëtarëve të gjyqësorit përgjegjës për shkeljet e disiplinës në punë - duke çuar në paprekshmërinë e gjyqësorit (shkelje e parimit të pavarësisë së gjyqësorit).<sup>132</sup>

---

<sup>130</sup>S Gloppen, Gjukata, korrupsioni dhe pavarësia gjyqësore (2014), f. 1.

<<https://www.cmi.no/publications/file/5091-courts-corruption-and-judicial-independence.pdf>>.

<sup>131</sup>ibid.

<sup>132</sup>ibid, f 158.



## 4 Inspektori i Lartë të Drejtësisë

Në sistemin gjyqësor para ndryshimeve të reformës në drejtësi, problematikat kryesore të evidentuara ishin të lidhura me (1) efikasitetin dhe (2) besimin e publikut në sistemin gjyqësor.<sup>133</sup> Të dyja këto elementë janë të lidhura me korrupsionin, dhe ndikimin nga jashtë mbi vendimmarrjen dhe administrimin e drejtësisë nga strukturat e gjyqësorit.

Gjatë periudhës së tranzicionit, një problematikë e evidentuar ishte elementi i pandëshkueshmërisë së anëtarëve të gjyqësorit - mosmbajtja e përgjegjësisë mbi mënyrën se si ata kryenin administrimin e drejtësisë. Periudha para reformës në drejtësi karakterizohej nga një mistifikim i figurës së gjyqtarit, mbrojtje e punës së prokurorëve, dhe paprekshmëri të anëtarëve të KLD.<sup>134</sup>

Në bazë të standarteve të garantimit të pavarësisë së gjyqësorit, parashikimi i rregullt i përgjegjësisë mbi shkeljet e disiplinës është një element që mund të garantojë ruajtjen e pavarësisë nga ndikimet e jashtme.<sup>135</sup> Përveç rasteve që kanë të bëjnë me vendimmarrjen e një gjyqtari apo prokurori që nuk janë të parashikuara si shkelje të ligjit apo si rezultat i sjelljeve të kundërligjshme<sup>136</sup>, disiplinimi i anëtarëve të gjyqësorit kur janë në shkelje të ligjit është thelbësore për ruajtjen e integritetit dhe besimit në sistemin gjyqësor.<sup>137</sup> Me qëllim zhbërjen e punës së KLD-së dhe inspektoratit të Ministrisë së Drejtësisë<sup>138</sup> në cenimin e parimit të ndarjes së pushteteve dhe pavarësisë së gjyqësorit në Shqipëri, në vitin 2016, u propozua krijimin i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, si një institucion i ri kushtetues<sup>139</sup> me

<sup>133</sup> E Mërkuri, "Reforma në Drejtësi: Roli i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë (ILD)", ISP (2023), f 5. <<https://ild.al/sq/2023/05/02/reforma-ne-drejttesi-rol-i-inspektoratit-te-larte-te-drejtetesise/>>

<sup>134</sup> Komiteti Shqiptar i Helsinkit, Raport: Krijimi dhe funksionimi i organeve të reja të drejtësisë (2019), f 19. <<https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2019/08/RAPORT-%E2%80%93-KRIJIMI-DHE-FUNKSIONIMI-I-ORGANEVE-T%C3%8B-REJA-T%C3%8B-QEVERISJES-S%C3%8B-DREJT%C3%8BSIS%C3%8B.pdf>>

<sup>135</sup> Rekomandimi CM/Rec(2010)12, Chapter VII; the CCJE Opinion No. 3 (2002). Procedurat disiplinore mund të pasojnë kur gjyqtarët nuk i kryejnë detyrat e tyre në mënyrë efikase dhe të duhur. Procedura të tilla duhet të kryhen nga një autoritet i pavarur ose një gjykatë me të gjitha garancitë e një gjykimi të drejtë dhe t'i sigurojë gjyqtarit të drejtën për të kundërshtuar vendimin dhe sanksionin. Sanksionet disiplinore duhet të jenë proporcionale.

<sup>136</sup> CCJE Opinion No. 3 (2002), paras 75, 76; Recommendation CM/Rec(2010)12, parass 66-71.

<sup>137</sup> CCJE (2010), Magna Carta of Judges (Fundamental Principles). <https://rm.coe.int/168063e431> (2010)

Pavarësia dhe paanësia e gjyqësorit janë parakushte thelbësore për funksionimin e drejtësisë. Pavarësia e gjyqësorit do të garantohet në lidhje me veprimtaritë gjyqësore dhe në veçanti në lidhje me rekrutimin, emërimin deri në moshën e pensionit, ngritjet në detyrë, palargueshmërinë, trajnimin, imunitetin gjyqësor, disiplinën, shpërblimin dhe financimin e gjyqësorit. Procedimi disiplinor zhvillohet para një organi të pavarur me mundësi rekursi para gjykatës.

<sup>138</sup> Në sistemin para ndryshimeve të vitit 2016, Ministri i Drejtësisë kishte të drejtë për të kryer inspektime të gjykatave dhe gjyqtarëve, si dhe kishin të drejtë të propozonin te KLD marrjen e masave disiplinore, përfshirë edhe shkarkimin e gjyqtarëve; kjo çenonte parimin e ndarjes së pushteteve dhe parimin e pavarësisë së gjyqtarëve.

<sup>139</sup> ILD është një nga organet e reja për administrimin e sistemit gjyqësor, së bashku me KLGJ, KLP dhe KED. Bazuar në nenin 283, pika 8, të ligjit "Për organet që qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, "Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë do të konsiderohet e krijuar ditën e parë të muajit që vjen pas emërimit të



qëllim të qartë: "të bënte sistemin e drejtësisë më të përgjegjshëm dhe të pengonte që sistemi i ri të kthehej në formën e mëparshme".<sup>140</sup>

Meqenëse siç do të parashtrohet më tej, ILD-ja luan një rol kyç në mbikëqyrjen e sjelljes dhe integritetit të individëve brenda sistemit gjyqësor, rrjedhimisht, ky institucion mund të ndikojë në përmirësimin e kulturës gjyqësore në Shqipëri në këto drejtime:

- (i) Me kryerjen e hetimeve, ankesave, dhe adresimin e shkeljeve etike, ILD-ja përforcon rëndësinë e sjelljes etike mes gjyqtarëve, e cila është integrale për të nxitur një kulturë të shëndetshme gjyqësore;
- (ii) ILD-ja mund të organizojë sesione trajnimi, ose seminare për gjyqtarët ose anëtarët e gjyqësorit mbi standardet profesionale dhe rëndësinë e ruajtjes së pavarësisë së gjyqësorit. Sigurimi i udhëzimeve dhe burimeve mund të ndikojë ndjeshëm në mentalitetin dhe sjelljen e gjyqtarëve, prokurorëve dhe anëtarëve të Këshillave brenda sistemit. Pavarësisht se kryerja e trajnimeve mund të dalë jashtë kompetencave funksionale të ILD-së, ILD-ja është institucioni kyç në zbërthimin e të dhënave, trendeve dhe qasjeve që kanë individët e gjyqësorit ndaj kulturës gjyqësore. Në këtë rast, kjo strukturë është më adekuatja për të përcaktuar se ku janë boshllëqet në lidhje me shkeljet e disiplinës;
- (iii) ILD-ja mund të propozojë politika ose udhëzime që synojnë rritjen e kulturës gjyqësore, që mund të përfshijnë kode sjelljeje, praktika të mira, ose rekomandime drejtuar gjykatave, prokurorive dhe këshillave, për promovimin e një gjyqësori të drejtë, transparent dhe të pavarur;
- (iv) Gjithashtu, duke siguruar procese transparente për hetimet e kryera mbi ankesat e depozituara te ILD-ja, ai mund të nxisë llogaridhënien brenda gjyqësorit. Kjo transparencë mund të ndikojë pozitivisht në perceptimin e sistemit gjyqësor nga publiku dhe komuniteti ligjor;
- (v) Me evidentimin e problematikave në lidhje me shkelje të vazhdueshme të disiplinës, ILD mund të propozojë bashkëpunime brenda gjyqësorit, si me Këshillat dhe me prokurorinë, për të advokuar mbi reforma dhe praktika që mbështesin një kulturë gjyqësore pozitive.
- (vi) Gjatë hetimeve për shkeljen e disiplinës për shkak të presioneve apo ndikimeve nga jashtë, ILD-ja mund të marrë dhe rol mbrojtës ndaj

---

Inspektorit të Lartë të Drejtësisë nga Kuvendi". Inspektorit i Lartë i Drejtësisë u zgjodh nga Kuvendi me vendimin nr.2/2020.

<sup>140</sup> Mërkuri, f 5.



gjyqtarëve, prokurorëve, dhe anëtarëve të Këshillave për të garantuar pavarësinë individuale të tyre.

Pikat e mësipërme janë rekomandime që vijnë nga leximi i një literature të gjerë mbi praktikën që ndjekin homologët të ILD-së në vende dhe sisteme të ndryshme.<sup>141</sup> Elementi kryesor që i definon këto rekomandime është proaktiviteti, ose ajo që njihet në fushën e ligjit, *motu proprio* (Latinisht që do të thotë "me iniciativën e tij"), që përshkruan një veprim zyrtar të marrë pa kërkesë formale nga një palë tjetër.

Përveç hetimeve disiplinore dhe inspektimeve të parashikuara në ligj<sup>142</sup> (të cilat do të analizojnë më tej), ndërmarrja e rekomandimeve të mësipërme mund të konsiderohen si tejkalime të fushë-veprimit të ILD-së (ose siç thonë amerikanët "That's above my pay grade."<sup>143</sup>). Ndoshta, rekomandimet e dhëna mund të konsiderohen si një barrë e shtuar për Zyrën e ILD-së e cila momentalisht nuk po funksionon me kapacitet të plotë; gjithsesi, nëse shihet në planin afatgjatë, përpjekjet mbi përmirësimin e kulturës gjyqësore sot mund të ulin numrin e ankesave në të ardhmen.

Si shembull, në nëntor të 2021, në Mbretërinë e Bashkuar, u dërgua për konsultim publik procedura e disiplinës gjyqësore në Angli dhe Uells.<sup>144</sup> Këtu konstatohet se Zyra e Hetimeve mbi Sjelljen Gjyqësor (JCIO), ekuivalentja e ILD-së në Angli dhe Uells, është marrë me 10,000 ankesa që nga momenti i krijimit të zyrës në vitin 2013.<sup>145</sup> Në Angli dhe Uells, me një popullsi të kombinuar prej 60 milion banorësh<sup>146</sup>, dhe 22,000 funksionarë gjyqësorë<sup>147</sup>, regjistrohen rreth 50 çështje në vit në lidhje me shkeljen e disiplinës së personave që mbajnë mandat gjyqësor.<sup>148</sup> Në vitin e dytë të punës, por duke marrë në konsideratë *backlog-un* nga institucionet pararendëse të ILD-së, ILD-ja ka trajtuar mbi 5,669 ankesa (rreth 56% të numrit të ankesave që JCIOs i ka trajtuar për 10 vjet). Logjikisht, krahasimi këtu është ilustrues pasi nivelet

---

<sup>141</sup> G. Gee, *The Persistent Politics of Judicial Selection: A Comparative Analysis*, in A. Seibert-Fohr (ed.) *Judicial Independence in Transition* (Heidelberg: Springer 2012), 132-133. S. Shetreet, and C Forsyth, eds, *The culture of judicial independence: conceptual foundations and practical challenges*. Martinus Nijhoff Publishers, 2011. M. Bobek, 'The Fortress of Judicial Independence and The Mental Transitions of The Central European Judiciaries' (2008) 14 *European Public Law*, 101.

<sup>142</sup> Ligji Nr. 115/2016, Neni 194.

<sup>143</sup> "Më tepër seç paguhem" është një idiomë që përshkruan një situatë që është jashtë fushës së përgjegjësisë së dikujt, një vendim që duhet të merret nga njerëz të një rangu më të lartë. Diçka që është mbi pragun e pagës së dikujt kërkon më shumë njohuri se sa ka ai person, ose më shumë autoritet sesa mund të zotërojë ai person.

<sup>144</sup> UK Ministry of Justice, *Judicial Discipline, Consultation on proposals about the judicial disciplinary system in England and Wales*, A consultation by the Lord Chancellor and Lord Chief Justice of England and Wales, (2021). <<https://consult.justice.gov.uk>> Kjo procedurë kishte 10 vite që nuk ishte ndryshuar, dhe qëllimi ishte përshtatja e procedurës së disiplinimit gjyqësor me ndryshimet në kontekstin social dhe kulturor.

<sup>145</sup> *ibid*, f 6.

<sup>146</sup> Population UK <<https://www.ukpopulation.org/>>

<sup>147</sup> UK Ministry of Justice, *Judicial Discipline Proposal*, f 6.

<sup>148</sup> *ibid*.



e formësimit të kulturës gjyqësore në sistemin gjyqësor anglez dhe atë shqiptar nuk janë në të njëjtin nivel.<sup>149</sup> Por vlen për t'u ndalur këtu në dy pika:

- Së pari, numri i lartë i ankesave drejtuar ILD-së nuk janë domosdoshmërisht një indikator suksesi i sistemit gjyqësor; përkundrazi, është një indikator që reflekton problemet e qytetarëve me individët që janë pjesë e sistemit gjyqësor. Në rast se ankesat trajtohen individualisht, pa trajtuar kornizën që lejon apo nxit një sjellje specifike të individët të gjyqësorit për të qenë subjekt ankimi të ILD-ja, ky numër mund të shtohet. Siç do të trajtohet më poshtë, inspektimet tematike të ILD-së mbi problematika që evidentohen nga ankesat janë një përpjekje e mirë për të ndryshuar kulturën gjyqësore në vend.
- Së dyti, në sistemin gjyqësor anglez, problematikat e sistemit të procedimit disiplinor të tyre që duan të përmirësojnë janë: (1) në një numër të çështjeve të tyre, hetimet marrin kohë të gjatë, dhe (2) ka nevojë për t'u bërë më tepër në lidhje me informimin e publikut që ata të kuptojnë më mirë vendimmarrjen mbi lidhjen shkak-pasojë ndërmjet një shkeljeje disiplinore dhe një sanksioni disiplinor.<sup>150</sup>

Në Deklaratën mbi Integritetin Gjyqësor, UNODC u shpreh se me qëllim forcimin e përpjekjeve për të siguruar që gjyqtarët të vendosin mbi çështje në bazë të fakteve dhe në përputhje me ligjin, pa pengesa, influenca të papërshtatshme, kërcënime dhe ndërhyrje, direkte ose jo direkte, është e rëndësishme të përkrahet krijimi dhe përforcimi i mekanizmave disiplinues, kontrollorë, vlerësues dhe që vendosin para përgjegjësisë aktorë të gjyqësorit, pa cënuar pavarësinë e tyre.<sup>151</sup>

Ky seksion do të fokusohet në elementët që janë bërë pjesë të sistemit gjyqësor në Shqipëri: dispozitat kushtetuese dhe ligjore që rregullojnë rastet e shkeljes së disiplinës së aktorëve të gjyqësorit, autoriteti që kryen hetimin e këtyre shkeljeve, dhe autoriteti që është përgjegjës në caktimin e masës së disiplinës në një çështje specifike. Në vlerësimin e sjelljeve ndërvepruese ndërmjet ligjit, ILD dhe KLP/KLGJ (dhe sipas rastit, rishikimit në gjykatë), ky seksion synon të nxjerrë në pah rolin e ILD-së në garantimin e parimit të pavarësisë së gjyqësorit.

#### 4.1 Statusi dhe mandati kushtetues i ILD

##### *Statusi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*

Në bazë të parashikimeve kushtetuese, Inspektori i Lartë i Drejtësisë zgjidhet “me tri të pestat e anëtarëve të Kuvendit, për një periudhë 9 vjeçare, pa të drejtë rizgjedhjeje, nga rradhët e juristëve të spikatur me jo më pak se 15 vjet përvojë

---

<sup>149</sup> Sistemi gjyqësor anglez konsiderohet si një nga më të mirët dhe më të pavarurit në botë. Shih më tepër Judicial Office UK, The judicial System in England and Wales: A visitor's guide <<https://www.judiciary.uk/wp-content/uploads/2016/05/international-visitors-guide-10a.pdf>>.

<sup>150</sup> UK Ministry of Justice, Judicial Discipline Proposal, f 6.

<sup>151</sup> UNODC, Declaration on Judicial Integrity, Global Judicial Integrity Network (2018).



pune në profesion, me integritet të lartë moral dhe profesional".<sup>152</sup> Inspektori i Lartë i Drejtësisë gëzon statusin e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë, dhe mund të shkarkohet nga Kushtetuta për (i) kryerjen e shkeljeve të rënda profesionale ose etike, si dhe (ii) kur është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë.<sup>153</sup>

Neni 147/d, pika 3 e Kushtetutës, parashikon se Inspektori i Lartë i Drejtësisë zgjidhet nga Kuvendi me një shumicë të cilësuar prej 3/5 të anëtarëve. Legjislatori ka zgjedhur këtë mënyrë zgjedhje të drejtuesit të Zyrës së ILD-së me qëllim largimin nga influenza e ekzekutivit. Kjo është në përputhje me standartet ndërkombëtare, ku thuhet se "mekanizmat disiplinues duhet të jenë efektivë, objektivë, dhe të mbrojtur nga ndikimet politike".<sup>154</sup>

Ndryshe nga pararendësi i tij funksional (*për sa i përket procedurave të hetimit disiplinor*)--KLD, Inspektori i Lartë i Drejtësisë konsiderohet një institucion i drejtësisë vetëqeverisës, i cili nuk merr për bazë asnjë kërkesa mbi masat disiplinuese që do t'i dërgojë KLP dhe KLGJ për procedim disiplinor, sipas rastit.<sup>155</sup>

Gjatë intervistave, të intervistuarit në unanimitet shprehën se kuadri ligjor në fuqi për garantimin e pavarësisë dhe ndarjes së ILD-së është i përshtatshëm, i mirë dhe shterues. Ata evidentojnë se problemi qëndron tek zbatimi në praktikë i tij. ILD vlerësohet se ka nevojë për burime njerëzore dhe staf të specializuar, pasi aktualisht ka mungesa në rradhët e inspektorëve profili gjyqtar, si dhe duhen gjetur format dhe mekanizmat e duhur për të rekrutuar staf cilësor të profileve të ndryshme. Nevojitet të ekzistojë vullneti i të gjithë aktorëve që ILD të kryejë në mënyrë adekuate rolin dhe detyrat e saj.

Që performanca/qëndrimi i ILD-së të përmirësohet, të intervistuarit sugjerojnë se aktorët që e kanë detyrim ligjor 'referimin', si drejtuesit e prokurorive edhe gjykatave, Prokurori i Përgjithshëm apo Ministri i Drejtësisë, duhet të jenë më proaktiv.

### *Mandati i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*

Krijimi i këtij institucioni, ashtu sikurse dhe të institucioneve kryesore qeverisëse të drejtësisë, erdhi si domosdoshmëri e një gjyqësori të pavarur, të përgjegjshëm dhe efektiv në garantimin e sundimit të ligjit, aksesit të barabartë në drejtësi, si dhe përmbushjes së reformave të nevojshme për anëtarësimin në BE.

<sup>152</sup> Kushtetuta, Neni 147/d. Kushtetuta, neni 147/d pika 4; Ligji nr.115/2016, neni 199, pika 2 dhe neni 201.

KED përzgjedh dhe rendit 5 kandidatura sipas vlerësimit të tij, të cilat i dërgohen Kuvendit për të votuar. Procedura e përzgjedhjes duhet të jetë publike dhe transparente. ILD duhet të zgjidhet me shumicën 3/5 nga ana e kuvendit brenda 30 ditëve. Në rast se kjo nuk arrihet, atëherë kandidati i parë i renditur nga KED shpallet i emëruar. Inspektori i Lartë i Drejtësisë aktual, Artur Metani, u zgjodh me vendimin nr. 2/2020, me 98 vota pro.

<sup>153</sup> Ibid, Neni 147/e. Mbrojtja e bërë Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me përfshirjen e GJK në shkarkimin e tij për shkelje të disiplinës, është një garanci e madhe përkundrejt pavarësisë individuale dhe institucionale të ILD-së.

<sup>154</sup> CDCJ, Review of the implementation of the council of Europe plan of action on strengthening judicial independence and impartiality (2022) < <https://rm.coe.int/cdcj-2022-07e-sofia/1680a930ee>>.

<sup>155</sup> Ndryshe nga KLD, i cili u evidentua në disa raste me vendime të GJK, se ndikohej nga Ministria e Drejtësisë, mbi shkeljet procedurale të hetimit të disiplinës së anëtarëve të gjyqësorit.






Kuadri ligjor në bazë të të cilit ILD u krijua, janë amendimet kushtetuese të miratuara nga Kuvendi me Ligjin nr.76/2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligji nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe Ligji nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

ILD, si një institucion i krijuar rishtazi, përbën risi për sistemin tonë gjyqësor, pasi këtij organi i njihen kompetenca të rëndësishme, sa gjyqësore aq edhe administrative. Ai është institucioni përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin me nismë të shkeljeve dhe fillimin e procedimit disiplinor ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësorit, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, dhe të Prokurorit të Përgjithshëm.

Për verifikimin e ankesave ose hetimin e shkeljeve disiplinore ndaj subjekteve, Inspektori mund të vihet në lëvizje bazuar në ankimin me shkrim të çdo personi fizik, juridik ose organi publik të interesuar. Inspektori i Lartë i heton shkeljet e dyshuara edhe kryesisht, bazuar në të dhëna publike ose të siguruara në kuadrin e inspektimeve institucionale e tematike, mbi çdo aspekt të punës së gjykatave, administratës gjyqësore, zyrave të prokurorive dhe administratës së prokurorisë, bazuar në kërkesën e motivuar me shkrim të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, të Ministrit të Drejtësisë, të Prokurorit të Përgjithshëm dhe në planin vjetor të inspektimeve.

Tabela 2: Procedimi disiplinor ndaj Inspektorit të Lartë të Drejtësisë



Burimi: Kushtetuta e Shqipërisë, Neni 147/e.



Ligj nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes në sistemin e drejtësisë”, i ndryshuar, në Pjesën IV, Krerët I-IV, nenet 193-216, rregullon çështjet organizative. Pra, rregullon në mënyrë të detajuar normat kushtetuese që kanë të bëjnë me objektin e veprimtarisë së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, pavarësinë, buxhetin dhe strukturën e institucionit, statusin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, papajtueshmëritë, përzgjedhja, mandati, kompetencat, Zëvendës-inspektorin e Lartë të Drejtësisë, hetimin e shkeljeve disiplinore, mënyrën e emërimit, shkeljet disiplinore dhe statusin e inspektorëve.

ILD zhvillon vlerësime të rregullta të performancës së gjyqtarëve dhe prokurorëve. Ky vlerësim përfshin vlerësimin e kualitetit të vendimeve dhe respektimin e standardeve etike dhe ligjore, duke promovuar kulturën e drejtësisë së paanshme. Por,

Është thelbësore të mos ngatërrohen parimet etike me çështjet disiplinore. Përkundrazi, duhet pranuar se parimet etike rrjedhin nga përvoja profesionale e të gjithë gjyqtarëve dhe janë të përcaktuara për të avancuar drejtësinë në përgjithësi dhe për të kontribuar në kuptimin e punës së gjyqtarëve. Parimet etike duhet të ndihmojnë gjithashtu zhvillimin e një kulture gjyqësore e cila vetë do të kontribuojë në kohezionin social.<sup>156</sup>

Pas vlerësimeve, ILD ofron rekomandime për të përmirësuar praktikën dhe sjelljet brenda sistemit gjyqësor. Këto rekomandime shpesh adresojnë sfidat e identifikuar në përdorimin e ligjit dhe në ruajtjen e pavarësisë së gjyqtarëve dhe prokurorëve.

ILD ka detyrën të monitorojë pavarësinë e gjyqtarëve dhe prokurorëve nga ndikime të jashtme. Kjo përfshin identifikimin dhe raportimin e çdo lloji presioni apo ndërhyrjeje që mund të ndikojnë në vendimmarrjen e tyre.

Përmes rekomandimeve dhe raporteve të tyre, ILD kontribuon në përmirësimin e kulturës së institucioneve gjyqësore, duke promovuar pavarësinë, integritetin dhe profesionalizmin në procesin e vendimmarrjes.

#### 4.2 Roli dhe performanca e ILD

Në Deklaratën mbi Integritetin Gjyqësor, UNODC u shpreh se me qëllim forcimin e përpjekjeve për të siguruar që gjyqtarët të vendosin mbi çështje në bazë të fakteve dhe në përputhje me ligjin, pa pengesa, influenca të papërshtatshme, kërcënime dhe ndërhyrje, direkte ose jo direkte, është e rëndësishme të përkrahet krijimi dhe përforcimi i mekanizmave disiplinues, kontrollorë, vlerësues dhe që vendosin para përgjegjësisë pjesëtarë të gjyqësorit, pa cënuar pavarësinë e tyre.<sup>157</sup>

<sup>156</sup>International Association of Judges, Judicial Administration and status of Judiciary, <<http://www.iaj-uum.org/iuw/wp-content/uploads/2013/02/I-SC-2004-conclusions-E.pdf>>

<sup>157</sup> UNODC, Declaration on Judicial Integrity, Global Judicial Integrity Network (2018).



Ky seksion do të fokusohet në elementët që janë bërë pjesë të sistemit gjyqësor në Shqipëri: dispozitat kushtetuese dhe ligjore që rregullojnë rastet e shkeljes së detyrës së gjyqësorit, autoriteti që kryen hetimin e këtyre shkeljeve, dhe autoriteti që është përgjegjës në caktimin e masës së disiplinës në një çështje specifike. Në vlerësimin e sjelljeve ndërvepruese ndërmjet ligjit, ILD dhe KLP/KLGJ (dhe sipas rastit, rishikimit në gjykatë), ky seksion synon të nxjerrë në pah rolin e ILD-së në garantimin e parimit të pavarësisë së gjyqësorit.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë<sup>158</sup> është institucioni përgjegjës për verifikimin e e ankesave, hetimin me nismë të shkeljeve dhe fillimin e procedimit disiplinor ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, anëtarëve të KLGJ dhe KLP, Prokurorit të Përgjithshëm, sipas procedurës së përcaktuar me ligj.<sup>159</sup> Gjithashtu, ILD është përgjegjës për inspektimin institucional të gjykatave dhe prokurorisë.<sup>160</sup> Nga studimi i Mërkurit mbi rolin e ILD-së në reformën në drejtësi, u konstatua se kompetencat kushtetuese të ILD-së i japin prerogativën "një njeriu të vetëm" [*bëhet fjalë për Inspektorin e Lartë të Drejtësisë*] për të proceduar të gjithë sistemin e drejtësisë, përfshirë gjyqtarë, prokurorë, anëtarë të këshillave, dhe Prokurorin e Përgjithshëm.<sup>161</sup> Siç thuhet se "me fuqi të madhe vjen përgjegjësi e madhe", ILD mund të ketë momentin për të ndikuar në (1) krijimin e një kulture gjyqësore pozitive, nëpërmjet praktikave dhe standardeve që ai kontrollon, dhe (2) rritjen e besimit të qytetarëve në sistemin gjyqësor.

Grupi i funksioneve të para të ILD-së janë të lidhura ngushtësisht me hetimin disiplinor.

Sipas Bist, disiplina gjyqësore do të thotë

---

<sup>158</sup> Në bazë të parashikimeve kushtetuese, Inspektori i Lartë i Drejtësisë zgjidhet "me tri të pestat e anëtarëve të Kuvendit, për një periudhë 9 vjeçare, pa të drejtë rizgjedhjeje, nga radhët e juristëve të spikatur me jo më pak se 15 vjet përvojë pune në profesion, me integritet të lartë moral dhe profesional". Inspektori i Lartë i Drejtësisë gëzon statusin e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë, dhe mund të shkarkohet nga Kushtetuta për (i) kryerjen e shkeljeve të rënda profesionale ose etike, si dhe (ii) kur është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë. Neni 147/d, pika 3 e Kushtetutës, parashikon se Inspektori i Lartë i Drejtësisë zgjidhet nga Kuvendi me një shumicë të cilësuar prej 3/5 të anëtarëve. Legjislatori ka zgjedhur këtë mënyrë zgjedhje të drejtuesit të Zyrës së ILD-së me qëllim largimin nga influenca e ekzekutivit. Kjo është në përputhje me standardet ndërkombëtare, ku thuhet se "mekanizmat disiplinues duhet të jenë efektivë, objektivë, dhe të mbrojtur nga ndikimet politike".

<sup>159</sup> Kushtetuta, Neni 147/a, pika 3.

<sup>160</sup> Kushtetuta, Neni 147/d, pika 2. Në 2023, ILD publikoi raportin e inspektimit "Mbi procedurën e shpalljes dhe arsyetimit të vendimeve gjyqësore të Gjykatës së Shkallës së Parë të juridiksionit të përgjithshëm Tiranë (dhoma civile) dhe Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë. Ky inspektim u iniciua për shkak të numrit të lartë të ankesave të paraqitura pranë ILD, ku ngriheshin pretendime për të zbardhjen e vendimeve gjyqësore përtej afateve ligjore. ILD gjeti se në raste ku mosrespektimi i afateve procedurale nga ana e gjyqtarëve nuk duhet të konsiderohet apriori si një shkelje e mundshme disiplinore, por kjo duhet të jetë objekt hetimi rast pas rasti. Ky raport do të jetë i rëndësishëm për ILD-në për të filluar me konsolidimin e praktikës dhe me numrin e ankesave që do të paraqiten pranë ILD-së, si dhe eficientë e trajtimit të tyre. Shih më tej <<https://ild.al/wp-content/uploads/2023/10/Raporti-i-Inspektimit.pdf>>.

<sup>161</sup> Mërkuri, f 6. Gjykata Kushtetuese është i vetmi subjekt i cili nuk mund të procedohet nga ILD.



rregullimi i sjelljes në atë mënyrë që [gjyqtari apo funksionari gjyqësor në rastin tonë] të japë drejtësi pa paragjykim (...). Disiplina vetë mund të dallohet si (a) disiplinë personale, (b) disiplinë familjare, (c) disiplinë sociale, (d) disiplinë personale, dhe (e) disiplinë etike."<sup>162</sup>

Ndërsa sipas Lubet, pavarësia e gjyqësorit nuk kërkon "imunitet absolut", ku imuniteti duhet të shihet ngushtësisht i lidhur me vendimmarrjen e lirë nga ndikimet, kufizimet dhe presionet e jashtme.<sup>163</sup> Në një analizë mbi rastet kur disiplinimi mund të cenojë pavarësinë e gjyqtarëve, Lubet parashikon rastet kur (i) gjyqtarët ndëshkohen ose kufizohen në mënyrën e interpretimit të ligjit, (ii) gjyqtari disiplinohet kur ka cenuar në gabim të drejtat e palëve të parashikuara në ligj, (iii) për çështje me sensibilitet publik, gjyqtarët kritikohen nga media dhe politikanë mbi vendimmarrjen e tyre.<sup>164</sup>

Pra, në këtë proces janë dy aspekte. Së pari, magjistratët (duke përfshirë të gjithë pjesëtarët e vetëqeverisjes gjyqësore) duhet të jenë subjekt i përgjegjësisë disiplinore për rastet e parashikuara në ligj<sup>165</sup>, dhe së dyti, ky proces disiplinues nuk duhet të cenojë pavarësinë e këtyre personave në vendimmarrjen dhe ushtrimin e detyrave të tyre në mirëbesim.

### *Procedura disiplinore në modelin shqiptar të gjyqësorit*

Në bazë të Nenit 147/d, ILD është përgjegjës për "(1) verifikimin e ankesave, (2) hetimin me nismë të shkelje të shkeljeve, dhe (3) fillimin e procedimit disiplinor",

---

<sup>162</sup> Justice V.K. Bist, *Judicial Discipline*, f 2. Bist jep këto sqarime mbi secilën formë të disiplinës. Disiplina personale përfshin sjellje të drejtë, veshje të denjë, mënyrë komunikimi të mirë, dhe mbajtje të vlerave morale si preferencë personale. Disiplina familjare ka të bëjë me mbarëvajtjen e moralit, sjelljeve etike dhe paqes në familje. Disiplina sociale ka të bëjë me faktin që një gjyqtar duhet të synojë një jetë introverte. Disiplina profesionale ka të bëjë me krijimin e një atmosfere ku secila palë ndihet e lirë për të diskutuar çështjen në mënyrë të lirë dhe pa frikë në një gjyq të hapur. Disiplina etike është bazuar në premisën se një gjyqtar duhet të jetë i disiplinuar në çdo aspekt të jetës. Pavarësisht se këtu flitet për disiplinën e gjyqtarit, diskutimi mbi këto vlera vlejné dhe për institucionet e reja të drejtësisë në Shqipëri. Këto parime janë të parashikuara përgjithësisht në parimet dhe rregullat e sjelljes në kodet e etikës së gjyqtarëve dhe prokurorëve, përta i përket rregullimit të sjelljes së tyre në sferën publike dhe private, si dhe marrëdhëniet me institucione të tjera. Shih më tepër CoE, "Magistrates ethics and deontology".

<<https://www.coe.int/t/dghl/cooperation/lisbonnetoork/themis/Ethics/Paper>>

<sup>163</sup> S Lubet, *Judicial Discipline and Judicial Independence, Law and Contemporary Problems*, f 16.

<sup>164</sup> *ibid*, f 13. Lubet bën një dallim për vendimmarrje në mirëbesim të gjyqtarëve. Pavarësisht rasteve kur vendimmarrja e gjyqtarëve mund të jetë në përputhje apo në gabim të leximit të ligjit, pasojat që mund të vijnë si kërcënimi i humbjes së pozicionit të punës, dëmtim i reputacionit, shpenzime mbi procedura hetimore nga organi disiplinues dhe të tjera, mund të cojnë në cedim të parimit të pavarësisë së gjyqësorit. Ky parashtrim i sistemit juridik të SHBA-së së analizuar nga Lubet është në përputhje me standardet ndërkombëtare mbi pavarësinë e gjyqësorit, si dhe përbën një rekomandim të këtij studimi. Zyra e ILD-së duhet të jetë e kujdesshme në lidhje me rastet të cilat heton, për të mos krijuar një fryme intimidimi të gjyqtarët që mund të cenojë vendimmarrjen e tyre.

<sup>165</sup> Në Shqipëri, institucioni që kryen procesin e hetimit për këto shkelje është Inspektori i Lartë i Drejtësisë. Por, sisteme të ndryshme juridike kanë modele të ndryshme.



ndaj kategorive të përcaktuara më sipër, pra gjyqtar, prokuror, anëtar i KLGJ-së dhe anëtar i KLP-së.<sup>166</sup>

Subjekte të legjitimuar për të kërkuar në ILD hetimin e shkeljeve disiplinore për magjistratët te ILD, janë:

- (i) Kryetari i Gjykatës, në rastin e gjyqtarëve;
- (ii) Prokurori i Përgjithshëm, në rastin e prokurorëve<sup>167</sup>;
- (iii) Ministri i Drejtësisë<sup>168</sup>;
- (iv) Një anëtar i vetëm i Këshillit.<sup>169</sup>

Në bazë të Ligjit nr.96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve", shkeljet disiplinore dallohen në tre lloje: shkelje disiplinore (neni 101), shkelje disiplinore në lidhje me ushtrimin e funksionit (neni 102), shkelje disiplinore jashtë ushtrimit të funksionit (neni 103), dhe shkelje disiplinore për shkak të kryerjes së një vepre penale (neni 104). Në këto dispozita, për secilin rast janë parashikuar për secilën rast, një numër i konsiderueshëm sjelljesh dhe veprimesh që mund të shkaktojnë përgjegjësi disiplinore.

**Tabela 3: Shkelje disiplinore dhe Masat disiplinore**

Shkelje disiplinore	Masa disiplinore
Shkelje disiplinore "e thjeshtë"	vërejtje konfidenciale
Shkeljet disiplinore në lidhje me ushtrimin e funksionit	vërejtje publike
Shkeljet disiplinore jashtë ushtrimit të funksionit	ulje e përkohshme e pagës <ul style="list-style-type: none"><li>• deri në 40 për qind për një periudhë jo më të gjatë se një vit</li></ul>

<sup>166</sup> Kushtetuta, Neni 147/d.

<sup>167</sup> Gjithashtu, parashikimi se Prokurori i Përgjithshëm mund të depozitojë kërkesë të ILD për hetimin e shkeljeve disiplinore të evidentuara gjatë raporteve mujore nga drejtuesit e prokurorive, në rast se zbatohet, është një qasje pozitive drejt krijimit të një kulturë të sundimit të ligjit. Nuk mund të jetë realiste që ILD të marrë rolin për të hetuar *proprio motu* shkeljen disiplinore të kategorive të përcaktuara më sipër. Për këtë arsye, përfshirja e PP, Ministrisë së Drejtësisë (neni 107), Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme (neni 106) dhe prokurorëve të rretheve, në lidhje me detyrimin të informojnë ILD mbi shkelje disiplinore dhe problematika që hasin në ushtrimin e veprimtarisë të tyre, mund të krijojë një kulturë përgjegjësie dhe eventualisht, në një kulturë gjyqësore pozitive në sistemin gjyqësor.

<sup>168</sup> Ligji nr. 98/2016, Neni 119, pika 2(a).

<sup>169</sup> Ligji nr. 98/2016, Neni 119, pika 2(b).



	<ul style="list-style-type: none"><li>• në rastin e magistratëve që kanë dhënë dorëheqjen, gjobë në një masë të barabartë me uljen e përkohshme të pagës</li></ul>
<b>Shkeljet disiplinore për shkak të kryerjes së një vepre penale</b>	ulje në detyrë nga një pozicion më i lartë në një më të ulët ose nga një pozicion në GJKKO ose në Prokurorinë e Posaçme në një gjykatë të juridiksionit të përgjithshëm ose në një prokurori tjetër
	pezullim nga detyra për një periudhë nga tre muaj deri në dy vjet, me të drejtë për përfitimin e pagës minimale  shkarkim nga detyra

Sistemi i disiplinës gjyqësore në Shqipëri administrohet nga ILD dhe KLGJ/KLP sipas rastit, dhe hallka e fundit, Gjykata (ose k.<sup>170</sup>

Shkeljet disiplinore hetohen nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë. Në varësi të subjektit i cili hetohet, përcaktohet dhe baza ligjore.<sup>171</sup> Hetimi nis në bazë të një ankimi.<sup>172</sup> Sipas ILD, procesi i ankimimit shërben për "verifikimin e ankesave, hetimin e shkeljeve disiplinore dhe fillimin e procedimit disiplinor ndaj:

1. Gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve;
2. Anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor;
3. Anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë; dhe
4. Prokurorit të Përgjithshëm."<sup>173</sup>

Çdo person fizik ose juridik mund t'i drejtohet ILD-së me një ankim për "veprime ose mosveprime, të cilat përbëjnë mos përmbushje të detyrës, apo sjellje joprofesionale

<sup>170</sup> Në përgjithësi, shkeljet disiplinore hetohen nga ILD, bazuar në procedurat dhe rregullat e parashikuara në ligjin nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

<sup>171</sup> Ligji nr.115/2016, Neni 6: "Shkeljet disiplinore të anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor hetohen nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në bazë të procedurave dhe rregullave të parashikuara në ligjin "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë". Procedura disiplinore ndaj anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor zhvillohet nga Gjykata Kushtetuese, e cila vendos në bazë të ligjit "Për Gjykatën Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë", dhe ligjit "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

<sup>172</sup> ILD ka miraturar një formular-tip ankese, i cili gjendet në faqen e internetit të ILD-së. Ai mund të plotësohet dhe dërgohet në tri mënyra: online, me postë ose personalisht.

<sup>173</sup> ILD, Pyetje të Shpeshta. <<https://ild.al/sq/pyetje-te-shpeshta/>>



ose jo etike gjatë ushtrimit të funksionit apo jashtë tij, të cilat diskreditojnë pozitën dhe figurën e gjyqtarëve dhe prokurorëve të gjitha niveleve në Republikën e Shqipërisë, e anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, e anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, e Prokurorit të Përgjithshëm, ose dëmtojnë besimin e publikut në sistemin gjyqësor ose të prokurorisë.<sup>174</sup>

Subjektet që janë jashtë fokusit të ankimit janë: kancelarët, ndihmësit ligjorë, kryesekretari, sekretarët gjyqësorë, ftuesit, nëpunësit e tjerë të administratës gjyqësore, oficerët e policisë gjyqësore, avokatët apo përmbaruesit gjyqësorë shtetërorë ose privatë, apo subjekte të tjera që marrin pjesë në një proces hetimor apo gjyqësor.<sup>175</sup>

Me marrjen e ankesës, ILD duhet të njoftojë brenda 5 ditëve konfirmimin e ankesës, dhe të konfirmojë vërtetësinë e pretendimeve.<sup>176</sup> Për shkak të stokut të dosjeve që erdhën si pasojë e vonesave në krijimin e ILD-së<sup>177</sup>, shqyrtimi mund të zgjatet pasi ILD po punon në bazë të një metodologjie të re për shqyrtimin e ankesave në bazë të një sërë kriteresh<sup>178</sup>.

Pas shqyrtimin fillestar, ILD vendos: (1) arkivimin e ankesës, pasi nuk përmbush një ose më shumë kriteret për të qënë e pranueshme<sup>179</sup>; (2) verifikimin e pretendimeve

---

<sup>174</sup> ibid.

<sup>175</sup> ibid.

<sup>176</sup> ibid.

<sup>177</sup> "Vonesat në ngritjen e ILD-së krijuan ngërçe për ushtrimin e kompetencave ligjore që ky institucion ka në drejtim të verifikimit të shkeljeve me natyrë disiplinore të kryera nga gjyqtarë dhe prokurorë si dhe për fillimin e procedimit disiplinor pranë dy KLGJ-së dhe KLP-së. Ndaj KShH vlerëson se, ngritja e ILD-së duhej ti kishte paraprirë ngritjes së dy Këshillave."<sup>177</sup>

- ILD duhet të ishte ngritur brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e ndryshimeve kushtetuese
- Afat prekluziv për KED - institucioni që realizoi procedurën e vlerësimit të përmbushjes së kriterëve dhe renditjen e kandidatëve për ILD dt. 1 shkurt 2017 (afat i pa respektuar). KED 2017 nuk u mblodh asnjëherë (dafuu) dhe KED 2018 u mblodh vetëm 1 herë dhe pezulloi veprimtarinë e saj
- Vonesat në ngritjen e ILD - ngërç në ushtrimin e kompetencave ligjore të institucionit në drejtim të verifikimit të shkeljeve me natyrë disiplinore të kryera nga gjyqtarë dhe prokurorë si dhe për fillimin e procedimit disiplinor pranë dy KLGJ dhe KLP. ILD u ngrit pas dy Këshillave
- KED 2017 dhe KED 2018 - situatë ekstra ligjore pasi nuk funksiononin
- KED 2019 ka parashtruar se procedurat e verifikimit dhe vlerësimit të kandidaturave nuk mund të fillonin dhe të zhvilloheshin pa miratuar paketën e akteve nënligjorë normative (urdhërohej nga neni 229 i ligjit nr 115/2016.
- KED filloi veprimtarinë në dt. 15 Janar 2018

<sup>178</sup> Ankesat do të shqyrtohen sipas kriterëve që lidhen me:


- Datën e dorëzimit
- fazën e trajtimit të ankesave të trashëguara;
- tipologjinë apo urgjencën e trajtimit;
- afatet e parashkrimit të ankesës.

<sup>179</sup> Ligji nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, neni 120, pika 1, shkronja "d". Në rast se ILD ka arkivuar ankesën ose ka marrë vendim për mbylljen e hetimit, subjekti ankues mund të ankimojë vendimin e ILD-së pranë (1) KLGJ, në rast se personi është ankuar për gjyqtar, (2) KLP, në rast se personi është ankuar për prokuror, dhe (3) Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në rast se ankimi është ndaj një anëtari të KLGJ apo KLP.



në ankesë kur ka të dhëna të paplota ose të paqarta, nga burime të ndryshme (organe të tjera; me subjektin e hetimit disiplinor; kryetarin a drejtuesin e organit ku ushtron detyrën magjistrati etj) apo të kërkojë sqarime a dokumentacion tjetër nga ankuesi; dhe (3) të fillojë hetimin, kur nga analizimi i të dhënave ka dyshime të arsyeshme se shkelja mund të jetë kryer.<sup>180</sup>

Figura 1: Ankesat në ILD



Burimi: ILD < [https://ild.al/wp-content/uploads/2021/07/VERSION-OK\\_page-0001.jpg](https://ild.al/wp-content/uploads/2021/07/VERSION-OK_page-0001.jpg)>

ILD fillon hetimin me iniciativën e tij, bazuar në të dhëna thelbësore mbi fakte që rezultojnë nga burime të besueshme, mbi bazën e të cilave lind dyshimi i arsyeshëm se shkelja mund të jetë kryer.<sup>181</sup> Në rast se rezultatet e hetimit konfirmojnë ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm se magjistrati ka kryer shkeljen disiplinore<sup>182</sup>,

<sup>180</sup> < <https://ild.al/sq/pyetje-te-shpeshta/>>

<sup>181</sup> ILD, Raporti Vjetor i Punës 2022. <<https://ild.al/wp-content/uploads/2023/05/RAPORTI-I-PUNES-VITI-2022.pdf>>

<sup>182</sup> Ligji nr. 96/2016, nenet 102-104. Shkeljet disiplinore gjatë ushtrimit të funksionit mund të jenë:  
 mos përbushje e pajustificuar ose e përsëritur e funksioneve gjatë gjykimit ose hetimit;  
 •vonesa të përsëritura ose që sjellin pasoja të rënda apo zvarritje të pajustificuara të veprimeve dhe/ose akteve procedurale;  
 • veprimi, mosveprimi ose sjellja e magjistratit, që sjell përfitime të padrejta ose dëme për palët në një proces gjyqësor ose procedurë hetimore, në kundërshtim me ligjin;  
 • shkelje e rëndë ose e përsëritur e dispozitave ligjore dhe nënligjore që rregullojnë organizimin dhe funksionimin e gjykatave ose prokurorive;





ILD fillon procedimin disiplinor pranë Këshillave, duke paraqitur raportin e hetimit së bashku me dosjen hetimore.<sup>183</sup>

Këshillat shqyrtojnë kërkesat e ILD-së dhe munden (1) të pranojnë kërkesën pjesërisht<sup>184</sup>, (2) të pezullojnë procedimin disiplinor, ose (3) të mos pranojnë masën e propozuar. Këshillat kanë diskrediton përsa i përket gjykimit të shkeljeve dhe vlerësimin mbi masat disiplinore të propozuara nga ILD.<sup>185</sup>

Procedimi disiplinor është momenti përmbyllës i veprimtarisë hetimore, i cili kryhet sipas rastit, nga KLGJ, KLP ose Gjykata Kushtetuese.<sup>186</sup> Në bazë të dosjes hetimore të ILD dhe sanksionit të rekomanduar prej tij, subjekti rishikues dhe disiplinues sipas rastit, jep vendimin mbi procedimin disiplinor.<sup>187</sup> Pavarësisht se nuk ekziston praktika në lidhje me vendimmarrjen e KLP-së ose KLGJ-së në kundërshtim të plotë me masën disiplinore të propozuar nga ILD, pyetja lind se çfarë do të ndodhte në një situatë të tillë hipotetike? *(këtu përfshijmë dhe rastet kur ILD propozon një masë disiplinore të rëndë, dhe KLGJ/KLP vendosin për një masë më të lehtë).*

Së pari, vendimi i KLGJ/KLD mbi masën disiplinore dhe procesin disiplinor nuk është përfundimtar por mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit (KPA).<sup>188</sup>

Mërkuri në raportin e tij mbi "Reforma në drejtësi: Roli i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë", ka rekomanduar që ILD-ja të mos ketë të drejtën e ankimit kundër vendimeve të këshillave që nuk pranojnë masat disiplinore të kërkuara prej tij, pasi Kushtetuta nuk ka të parashikuar rrugë ankimore kundër vendimmarrjes së këshillave.<sup>189</sup> Sipas këtij arsyetimi, ankimimi i vendimit mbi masën disiplinore ndaj

---

- moszbatimi pa shkaqe të justifikuara i vendimeve të dhëna nga këshilli ose refuzimi i zbatimit të masës disiplinore të dhënë ndaj magjistratit;

- mosrespektimi i rëndë ose i përsëritur i legjislacionit procedural dhe material ose zbatimi i gabuar i legjislacionit procedural dhe material, kur konstatohet nga një gjykatë më e lartë.

<sup>183</sup> Ligji nr. 96/2016, neni 138.

<sup>184</sup> Sipas Raportit të punës për vitin 2022, praktika e Këshillave në lidhje me ndryshimin e vendimit pjesërisht kanë pasur të bëjnë me vlerësimin e masës së dhënë, por në asnjë rast "cenuar ligjshmëria e hetimit, verifikimit të shkeljeve apo vetë ekzistenca e saj, por ndryshimi ka të bëjë me llojin e masës disiplinore të kërkuar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë".

<sup>185</sup> ibid, f 21.

<sup>186</sup> ILD, Raporti për punën gjatë vitit 2022, f 21. <<https://ild.al/wp-content/uploads/2023/05/RAPORTI-I-PUNES-VITI-2022.pdf>>

<sup>187</sup> Sipas ILD-së, "Nga praktika e ndjekur deri më tani me Këshillat, në disa raste propozimet për masë disiplinore janë ndryshuar pjesërisht. Ndryshimet kanë patur të bëjnë me vlerësimin e Këshillave, për sa i takon llojit të masës së dhënë. Në asnjë rast nuk është cenuar ligjshmëria e hetimit, verifikimit të shkeljeve apo vetë ekzistenca e saj, por ndryshimi ka të bëjë me llojin e masës disiplinore të kërkuar nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë." Sipas Mërkurit, numri i ulët i vendimeve të ILD-së që ankimohen, apo dhe fakti që Këshillat nuk kanë kthyer vendimet e arkivimit, është indikator mbi punën profesionale të ILD-së.

<sup>188</sup> Aneksi i Kushtetutës.

<sup>189</sup> Mërkuri, Reforma në Drejtësi: Roli i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ISP, f 9. Mërkuri rekomandon që ILD të ketë mundësi të ankimojë vendimet e Këshillave për shkaqe të rënda procedurale, por jo për themelin e vendimmarrjes. <<https://www.aksesdrejtesi.al/dokumenta/1691489721ISP-Reforma-ne-drejtesi-Roli-i-Inspektorit-te-Larte-te-Drejtesise-2023.pdf>>



magjistratëve do t'i jepte të drejtën gjykatës për t'u shprehur -- e drejtë e cila nuk është e parashikuar në Kushtetutë.<sup>190</sup>

Pavarësisht se KLP dhe KLGJ nuk kanë ato problematika në lidhje me ekzekutivin si paraardhësi i tyre KLD, mungesa e kulturës gjyqësore të konsoliduar dhe qarkullimit të profesionistëve nga pushteti ekzekutiv në institucionet e gjyqësorit mund të çojë në cenim të parimit të pavarësisë, si individual dhe institucional. Për këtë arsye, krijimi i një kulture të fortë gjyqësore nuk ka të bëjë vetëm me sjelljen individuale, por edhe me normat institucionale.

Në një skenar hipotetik ku ILD-ja propozon masa disiplinore të cilat janë të ndryshme nga vendimmarrja e KLGJ/KLP, inspektorët e ILD-së mund të ndihen si një pjesë e procesit vetëm formalisht, pa pasur ndikim real. Pavarësisht kësaj, nga fokus-grupi me ILD, rezulton se momentalisht nuk ka probleme me vendimmarrjen e KLGJ/KLP. Ekzistenca e garancive për ankimim të vendimeve të KLGJ/KLP, si dhe praktika e deritanishme e KLGJ/KLP në lidhje me pranimin e standardit të ILD, konsiderohet pozitive nga Zyra e ILD-së dhe që nuk cenon parimin e pavarësisë institucionale. Kjo qasje pranohet dhe në jurisprudencë të huaja. Për ilustrim,

Kërkuesja ishte një gjyqtare e Gjykatës së Quebec-ut, kundër së cilës kryegjyqtarja e Gjykatës së Quebec-ut paraqiti një ankesë në Këshillin Gjyqësor, duke pretenduar se ajo kishte shkelur Kodin e Etikës. Kërkuesi argumentoi se dispozitat e Aktit të Gjykatave të Drejtësisë së Quebec-ut, që lejojnë kryegjyqtarin e Gjykatës së Quebec-ut të paraqesë një ankesë në Këshillin Gjyqësor kundër një gjyqtari të asaj gjykate, shkelin parimet e paanshmërisë dhe pavarësisë gjyqësore. Gjykata e Lartë e hodhi poshtë ankesën e ankuesit dhe deklaroi se, nga shqyrtimi i kompetencave që i janë dhënë kryegjyqtarit të Gjykatës së Kebekut nga Akti i Gjykatave të Drejtësisë, nuk mund të konkludohet se ato mund të rrezikojnë paanshmërinë e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor ose komisioni hetimor në trajtimin e një ankesë të paraqitur nga kryegjyqtari". Gjykata e Lartë u shpreh se kur kryegjyqtari përdor procesin disiplinor duke marrë iniciativën për të paraqitur një ankim, nuk ka arsye të mendohet se Këshilli dhe komisioni i tij, në kryerjen e detyrave të tij, po tregohet i anshëm.<sup>191</sup>

### *Inspektime tematike*

Përveç ankesave, ILD mund të kryejë dhe inspektime tematike.

Përsa i përket disiplinës në punë të gjyqtarëve, së pari, kryetari i gjykatës i cili konsiderohet si "menaxheri" i administratës gjyqësore ka si detyrë "të mbikëqyrë

---

<sup>190</sup> *ibid*, f 11.

<sup>191</sup> Canada, Supreme Court, Date of issuance: 14- 12-2002, Number of case: CAN-1996-1-002, [English](#). CEELI Institute Manual.



disiplinën në punë të gjyqtarëve dhe të kërkojë fillimin e hetimit kur dyshohet shkelje disiplinore e gjyqtarëve në gjykatat e tyre".<sup>192</sup> Pavarësisht se nuk përmendet shprehimisht institucioni të cilit do t'i referohet kryetari, nga leximi i nenit 147/d, kuptojmë që bëhet fjalë për ILD-në. Pra, ILD-ja, i cili do të vihet në lëvizje nga Kryetari i gjykatës, kryen hetimin. Pyetja lind në rastin kur ILD-ja fillon hetime të vazhdueshme për gjyqtarët e një gjykate në bazë të ankesave drejtuar Zyrës së ILD; a duhet ILD-ja të nisë një inspektim mbi mundësinë që kryetari i gjykatës mund të jetë i implikuar përderisa lejon, më dijeni apo neglizhencë, gjyqtarët të shkelin normat disiplinore.<sup>193</sup> Normalisht, kjo është dilemë parimore, e cila lidhet me pro aktivitetin e ILD-së dhe trajtimin e ankesave në mënyrë substanciale, tematike dhe duke synuar ndryshimin e kulturës gjyqësore në Shqipëri.

Për këtë arsye, dhe numri i lartë i ankesave drejtuar ILD duhet vlerësuar në mënyrë kritike. Nga njëra anë, numri i lartë tregon besimin në institucionin e ILD-së për trajtimin e këtyre ankesave; nga ana tjetër, në rast se ka raste që vazhdojnë të ndodhin në sistemin gjyqësor, mund të kemi një problem kritik me trajtimin e thelbit të ankesave. Qasja e ILD-së në lidhje me inspektimet tematike është pozitive. Në fokus-grupin me Zyrën e ILD-së, me qëllim adresimin e çështjes së sapo përmendur, inspektorët ndanë se me qëllim adresimin e numrit të lartë të ankesave të paraqitura pranë Zyrës së ILD, specifikisht mbi pretendimet për vonesa në zbardhjen e vendimeve gjyqësore përtej afateve ligjore ndaj magjistratëve gjyqtarë të Gjykatës së Rrethit të Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe ndaj magjistratëve gjyqtarë të Gjykatës Administrative Tiranë, ata kryen një inspektim tematik me objekt "Mbi procedurën e shpalljes dhe arsyetimit të vendimeve gjyqësore të vendimeve gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, dhomës civile dhe Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë".<sup>194</sup> Pavarësisht debatit me pjesëmarrësit e fokus-grupit mbi kompleksitetin e nocionit të kulturës gjyqësore dhe rolit të ILD-së në ndryshimin e kulturës gjyqësore në Shqipëri, raporte dhe inspektime të tilla ndihmojnë në mbështetjen e hipotezës<sup>195</sup> së ngritur në këtë studim.

Në bazë të gjetjeve të raportit të sipërcituar, rekomandimi i kryer nga ILD që të mbahet "një regjistër për njoftimin e vendimit palëve për të cilin të evidentohet

<sup>192</sup> Ligji nr. 98/2016 "Për organizimin e pushtetit gjyqësor", Neni 37, para d.

<sup>193</sup> Ngjashëm dhe në rastin e prokuroreëve, Prokurori i Përgjithshëm " mbikëqyr disiplinën në punë të prokurorëve dhe i bën kërkesë ILD për fillimin e inspektimit për shkelje disiplinore të prokurorëve". Ligji Nr.97/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në republikën e Shqipërisë", neni 38, pika 2(i). Është interesante si në kete rast, ILD-ja është parashikuar shprehimisht si institucioni përgjegjës për fillimin e inspektimit për shkelje disiplinore të prokurorëve, ndërsa në rastin e gjyqtarëve, ligji kishte nevojë për interpretim.

<sup>194</sup> ILD, Raporti i inspektimit tematik me objekt "Mbi procedurën e shpalljes dhe arsyetimit të vendimeve gjyqësore të vendimeve gjyqësore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, dhomës civile dhe Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë" (2023). <<https://ild.al/sq/2023/10/04/raport-i-inspektimit-mbi-proceduren-e-shpalljes-dhe-arsyetimit-te-vendimeve-gjyqesore-te-gjykares-se-shkalles-se-pare-te-juridiksionit-te-pergjithshem-tirane-dhoma-civile-dhe-gjykares-administrat/>>

<sup>195</sup> Hipoteza 1: Niveli i vërtetë i pavarësisë së gjyqësori ndikohet jo vetëm nga ndryshimet ligjore dhe strukturore të sistemit, por dhe nga niveli i kuptimit dhe operacionalizimit të gjyqësorit nga nëpunësit që punojnë në këtë sistem.



data njoftimit (...)”<sup>196</sup> dhe "libri i pasqyrimeve të lëvizjes së dosjeve të mbajë datën e dorëzimit të dosjes nga gjyqtari tek sekretari i seancës, datën e dorëzimit nga sekretari i seancës tek sekretari gjyqësor, të numërtohet në çdo fletë, të nënshkruhet nga kancelari/sekretari gjyqësor"<sup>197</sup>, kontribuon dukshëm në krijimin e një kulture të mirëfilltë gjyqësore, atë të zbatimit të ligjit.<sup>198</sup>

Një element tjetër që mund të cenojë parimin e pavarësisë gjyqësore është transparencja mbi ndarjen e çështjeve. Në rastin e gjykatave, KLGJ është organi i cili miraton rregullat e hollësishme mbi programin dhe procedurat e ndarjes së çështjeve me short.<sup>199</sup> Por dhe në këtë rast, ILD ka detyrën dhe përgjegjësinë për të kryer inspektime të ndarjes së çështjeve dhe kontrollimin e raporteve elektronike të paktën një herë në vit.<sup>200</sup> Duke njohur problematikën e ndërhyrjes në ndarjen e çështjeve me short si mundësi për të ndërhyrë në vendimmarrjen e gjyqësorit, detyrimi ligjor i ILD-së për të mbajtur në kontroll çdo vit këtë element, eventualisht, mund të kontribuojë në zhdukjen *de facto* të një praktike të dëmshme për pavarësinë e gjyqësorit.<sup>201</sup>

Gjykatat dhe prokurorët nuk janë të vetmit aktorë të korruptuar në sistem. Ka të ngjarë që edhe administratorët dhe kancelarët të marrin pjesë në korrupsion. Ekziston mundësia që administratorët dhe kancelarët marrin pjesë në korrupsion. Kjo ka të bëjë më së shumti me caktimin dhe ndarjen e çështjeve me short. Gjyqtarët janë ankuar publikisht në analizat vjetore të gjykatave, mbi problemin se çështjet "me fitim" nuk iu caktoheshin atyre, por u jepeshin gjyqtareve të preferuar. Ekzistojnë prova që kryetarët e gjykatave instruktojnë administratorët e rrjetit kompjuterik/kancelarëve të gjykatës të caktojnë çështje specifike gjyqtarëve specifike.<sup>202</sup>

Gjatë intervistave, të intervistuarit në unanimitet shprehen se kuadri ligjor në fuqi për garantimin e pavarësisë dhe ndarjes së ILD-së është i përshtatshëm, i mirë dhe shterues. Ata evidentojnë se problemi qëndron tek zbatimi në praktikë i tij. ILD vlerësohet se ka nevojë për burime njerëzore dhe staf të specializuar, pasi aktualisht

---

<sup>196</sup> Ild, Raporti i inspektimit tematik, f 25.

<sup>197</sup> ibid.

<sup>198</sup> Sipas parashikimit të Strategjisë së Reformës në Sistemin e Drejtësisë (2015) ku parashikohet se "reforma në drejtësi do të synojë të krijojë një sistem ligjor koherent që u përgjigjet traditës sonë ligjore, nevojave dhe shkallës së zhvillimit të vendit si dhe nevojës për të mundësuar zhvillimin tonë të qëndrueshëm ekonomik e shoqëror në të ardhmen. Kjo nënkupton përpjekje për krijimin e një legjislacioni të konsoliduar, të sistemuar e të harmonizuar së brendshmi dhe me standardet ndërkombëtare e që zbatohet njëtrajtësisht nga institucionet e sistemit të drejtësisë."

<sup>199</sup> Ligjit nr.98/2016, "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", Neni 25, pika 3.

<sup>200</sup> ibid, Neni 25, pika 4.

<sup>201</sup> Në bazë të Progres Raportit 2022, për shkak se mbetja pezull e funksionimit të një Sistemi i Menaxhimit të Çështjeve, dhe pasja e një numri të pakët të gjyqtarëve në Gjykata, ndarja e çështjeve me short nuk aplikohet gjerësisht. Pavarësisht se kjo situatë mund të lejojë ndikimin e influencës mbi një gjyqtar apo prokuror, raste të tilla nuk janë raportuar nga prokurorët dhe gjyqtarët.

<sup>202</sup> Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë, Grupi i Ekspertëve të Lartë, Analiza mbi sistemin gjyqësor në Shqipëri, f 253.



ka mungesa në radhët e inspektorëve profili gjyqtar, si dhe duhen gjetur format dhe mekanizmat e duhur për të rekrutuar staf cilësor të profileve të ndryshme. Nevojitet të ekzistojë vullneti i të gjithë aktorëve që ILD të kryejë në mënyrë adekuate rolin dhe detyrat e saj.

Që performanca/qëndrimi i ILD-së të përmirësohet, të intervistuarit sugjerojnë se aktorët që e kanë detyrim ligjor 'referimin', si drejtuesit e prokurorive edhe gjykatave, Prokurori i Përgjithshëm apo Ministri i Drejtësisë, duhet të jenë më proaktiv.

Siç u përmend më sipër, pavarësia e gjyqësorit duhet të garantohet si në nivel institucional, pra pavarësia nga pushtetet e tjera, por dhe në nivel individual, pra pavarësia individuale e anëtarëve të sistemit gjyqësor nga krerët ose drejtuesit e institucioneve të drejtësisë. Rasti i ushtrimit të ndikimit në ndarjen e çështjeve nga kryetarët e gjykatave, është një shkelje e pavarësisë së gjyqësorit,<sup>203</sup> dhe rrjedhimisht, një element që ndikon negativisht në formësimin e kulturës së pavarësisë së gjyqësori, i cili mund të ndryshohet me ndërhyrjen dhe kontrollin nga ILD-ja.

Në përfundim të këtij seksioni, mund të kolaudojmë se roli i ILD-së në sistemin gjyqësor në Shqipëri pas reformës në drejtësi mund të theksohet në tre drejtime:

- 1.** Përmirësimi i performancës së personelit gjyqësor;
- 2.** Promovimi i integritetit dhe pavarësisë së institucioneve të drejtësisë; dhe
- 3.** Krijimi i një kulture gjyqësore pozitive.

#### **4.3 ILD si një institucion kyç për të promovuar dhe mbrojtur kulturën gjyqësore dhe pavarësinë e institucioneve gjyqësore**

Në arkitekturën e re të drejtësisë, ILD ka potencialin që nëpërmjet ushtrimit të detyrave të tij të ndikojë në përmirësimin e kulturës gjyqësore dhe zbatimit të pavarësisë në vend. Dy detyrime ligjore dhe praktika të ILD-së që mund të ndikojnë ndjeshëm pozitivisht në formësimin e kulturës së sundimit të ligjit në Shqipëri janë (1) detyrimi i kryerjes, të paktën çdo vit, të inspektimit tematik mbi praktikën dhe shkaqet e zëvendësimit të prokurorëve; si dhe (2) kryerja e

---

<sup>203</sup> Rekomandimi(94)12 i cili përmban parimet 1.2.d dhe f, parashikon se "ndarja e çështjeve nuk duhet të ndikohet nga asnjë palë e çështjes ose person i cili mund të ketë interes mbi rezultatin e çështjes". Gjithashtu, Komisioni i Venecias ka thënë se "procedura e ndarjes së gjyqtareve duhet të ndjekë kriteret objektive" (CDL-AD(2002)026 at 70.7).



inspektimeve periodike mbi caktimin e çështjeve dhe ndarjeve të çështjeve me short.

Sipas të dhënave zyrtare të ILD-së, vihet re kjo panoramë në lidhje me shkeljet disiplinore të subjekteve të gjyqësorit:

- 5653+ ankesa të konfirmuara<sup>204</sup>
- 4788 ankesa të trajtuara<sup>205</sup>
- 865 ankesa në proces trajtimi, nga ku 219 ankesa në proces verifikimi pas shqyrtimit fillestar
- 105 magjistratë të hetuar, nga ku 32 kërkesa për procedim disiplinor<sup>206</sup>

Referuar Rezolutës së Kuvendit "Për vlerësimin e veprimtarisë së Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për vitin 2022"<sup>207</sup>, vihet re se ILD ka qenë mjaft pro aktiv duke u angazhuar në shumë drejtime si psh. në verifikimin e ankesave të mbartura nga organet e mëparshme, hartimin dhe miratimin e raporteve vjetore dhe periodike, përgatitjen e kuadrit rregullues të veprimtarisë institucionale, shqyrtimin e ankesave dhe marrjen e vendimeve për fillimin e hetimit disiplinor, përfundimin e inspektimeve tematike, bashkëpunimin me partnerët kombëtarë dhe ndërkombëtarë, nënshkrimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit, angazhimin me qytetarët, etj.

Për sa i përket impaktit që performanca e ILD-së ka në anëtarësimin e Shqipërisë në BE, Progres Raporti i BE për Shqipërinë e vitit 2023 mbi Shqipërinë është ndalur në elementin e *përgjegjësisë*, si pjesë të Kapitulli 23: Gjyqësori dhe të drejtat themelore, e cilat lidhet me funksionin e ILD-së. Në tërësi, gjyqësorit sipas KE-së është nivelin *disi i përgatitur dhe i përgatitur në mënyrë të moderuar* për sa i përket përafrimit të standardeve të gjyqësorit me *acquis* e BE-së, dhe *e përgatitur në mënyrë të moderuar* për sa i përket funksionimit të gjyqësorit.<sup>208</sup> Progres i mirë është bërë për sa i përket implementimit të reformës në drejtësi.<sup>209</sup>

---

<sup>204</sup> Fakti që është një plus pas numrit 5653 lë vend për interpretim. 5653+ mund të jetë 5654 ose 119029. ILD ka nevojë të jetë më i qartë, dhe për hir të ekzistencës së simboleve të tjera matematikore, një simbol matematikor më adekuat mund të jetë  $\approx$  (i cili përkthehet 'afërsisht e barabartë').

<sup>205</sup> Trajtim do të thotë

<sup>206</sup> <<https://ild.al/sq/kreu/>>, aksesuar më 20.11.2023.

<sup>207</sup> Kuvendi i Shqipërisë, Rezolutë "Për vlerësimin e veprimtarisë së Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për vitin 2022", 12.07.2023. Vlen të ngrihet në pikëpyetja vonesa e Kuvendit të Shqipërisë në nxjerrjen e kësaj rezolute. Miratimi i saj në korrik të vitit 2023, me pesë muaj të mbetur nga përfundimi i vitit, ngre pyetjen mbi validitetin e rekomandimeve dhe kontrollin e Kuvendit ndaj ILD-së. <<https://ild.al/ep-content/uploads/2023/09/REZOLUTE-E-KUVENDIT-PER-VLERESIMIN-E-PUNES-SE-INSPEKTORIT-TE-LARTE-TE-DREJTESISE-PER-VITIN-2022.pdf>>

<sup>208</sup> Progress Report Albania 2023, f 19.

<sup>209</sup> *ibid.*



Problematika në lidhje me funksionimin e ILD-së me gjysmën e inspektorëve të planifikuar është shqetësuese për Komisionin Evropian.<sup>210</sup> Kuptueshëm, detyrat, përgjegjësitë dhe roli i ILD-së në funksionimin e sistemit gjyqësor janë të një rëndësie të lartë. Burime e pamjaftueshme financiare, barra e rëndë e punës, si dhe presioni për të vendosur mbi çështje brenda afateve ligjore janë konsideruar si indikatorë potencialë të korrupsionit.<sup>211</sup> Edhe gjatë fokus-grupit me ILD-në, inspektorët shfaqën problematikën e tyre në lidhje me mbushjen e vakancave së inspektorëve magjistratë. Legjislatori, me qëllim për të vendosur pranë ILD-së profesionistët më të zotë dhe më me eksperiencë, ka krijuar një problematikë për sa i përket vendosjes së një standardi tepër të lartë, ku kërkesat ligjore për t'u konsideruar për rolin e një inspektori pranë ILD-së barazohet për nga niveli me ato të një gjyqtari të Gjykatës së Lartë.<sup>212</sup> Inspektorët gjatë fokus-grupit ndanë se personat që përmbushin kushtet për të qenë inspektorë magjistratë, preferojnë të jenë pjesë e gjykatave, me qëllim arritjen e pikësnyimeve në karriere. Përsa më sipër, sugjerohet që , kërkesat ligjore për pozicionin e inspektorit pranë Zyrës së ILD-së, duhet të zbuten.

Në lidhje me reformën në drejtësi, pavarësisht se procesi i vetingut po ecën, Progres Raporti ngre shqetësime në lidhje me ndërhyrjet në sistemin e drejtësisë si dhe pavarësinë e tij. Ndërkohë, si pasojë e stokut të lartë të dosjeve në shumë gjykata të vendit, efica e sistemit gjyqësor përbën ende një shqetësim madhor.

Çështje të tjera të ngritura në Progres Raportin kanë të bëjnë me rritjen e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve pjesë të qeverisjes gjyqësore<sup>213</sup>, si dhe rritjen e komunikimit strategjik për sa i përket politikave kyçe ndërmjet institucioneve të drejtësisë.<sup>214</sup>

Duke qënë se një nga qëllimet kryesore të reformës në drejtësi ishte rritja e besimit në institucionet e drejtësisë dhe në sistemin gjyqësor, është e rëndësishme të vlerësojmë gjithashtu perceptimin e publikut ndaj sigurisë dhe institucioneve të drejtësisë, në bazë të raporteve të Barometrit të Sigurisë Shqipëri. Në 2019<sup>215</sup>, institucionet e gjyqësorit perceptoheshin nga publiku si institucionet më të ndikuara nga politika<sup>216</sup>, ku "gjyqësori, prokuroria dhe gjykata perceptohen si më të korruptuarat".<sup>217</sup> Një situatë e ngjashme paraqitet dhe gjatë gjetjeve të raportit mbi

<sup>210</sup> Progress Report Albania 2023, f 21.

<sup>211</sup> The International Bar Association, Judicial Integrity Initiative: Judicial System Corruption.

<sup>212</sup> Gjetje nga konsultimi me fokus-grupin e ILD-së.

<sup>213</sup> Progress Report Albania 2023, f 22.

<sup>214</sup> ibid.

<sup>215</sup> Kohë gjatë së cilës ILD-ja nuk ishte funksionale për shkak të vonesave të implementimit të reformës në drejtësi.

<sup>216</sup> A Dyrmishi, Albanian Security Barometer, National Survey, CSDG(2019), f 20. <<https://csdgalbania.org/ep-content/uploads/2020/02/The-Albanian-Security-Barometer-2019-1.pdf>>. 53.54% e të anketuarëve thanë që gjykatat nuk janë të pavarura, dhe 49.51% thanë të njëjtën gjë për prokurorinë.

<sup>217</sup> ibid, f 20. Gjatë anketimit, qytetarët gjetën se gjyqësori është insitucioni gjyqësor më i korruptuar, ku 71.21% thanë se Gjykatat janë të korruptuara "shumë", ndërsa 66.91% dhanë të njëjtën përgjigje për prokurorinë. Studimi gjeti gjithashtu që pavarësisht se besimi ishte i ulët në këto institucione, publiku ka besim të lartë se



Barometrën e Sigurisë Shqipëri 2020, ku besimi në gjykatë (51.93% u përgjigjën që nuk kanë besim fare), për shkak të perceptimit të nivelit të korrupsionit të tyre (71.21% thanë që gjykatat janë shumë të korruptuara).<sup>218</sup> Në 2021, SPAK (37.67%) dhe GJKKO (29.55%) konsideroheshin si institucionet e drejtësisë më të pavarura nga ndikimi i politikës, ndërsa besimi në gjykatë dhe prokurori vazhdon të ishte i ulët për shkak të perceptimit të nivelit të lartë të korrupsionit.<sup>219</sup> Në 2022, fokusi i raportit ishte mbi korrupsionin, ku publiku është i ndarë nëse vettingu kontribuoi ose jo në pakësimin e korrupsionit në gjyqësor.<sup>220</sup> Gjithashtu, në 2023, gjetjet e Barometrit të Sigurisë, besimi i qytetarëve ndaj institucioneve të drejtësisë, mbetet i ulët.<sup>221</sup>

Sipas Bashkimit Evropian, pavarësia e gjyqësorit është element kyç për të rritur besimin e qytetarëve në sistemin ligjor.<sup>222</sup> Për BE-në, pavarësia formale nuk është e mjaftueshme për të arritur objektivat në drejtësi, por sistemi ka nevojë të perceptohet si i pavarur nga qytetarët, me qëllim fitimin e besimit të tyre.<sup>223</sup> Sipas Opinioneve Nr.4(2003) të Këshillit Konsultativ të Gjyqtarëve Evropianë,

Besimi që qytetarët kanë në sistemin gjyqësor do të forcohet nëse gjyqtarët kanë një thellësi dhe diversitet njohurish që shtrihen përtej fushës teknike të ligjit në fusha me interes të rëndësishëm shoqëror, si dhe zhvillimit të aftësive të nevojshme në sallën e gjyqit që u mundëson atyre të menaxhojnë çështjet dhe të merren me të gjithë personat e përfshirë në mënyrë të përshtatshme dhe të ndjeshme.<sup>224</sup>

Në diskutimin me fokus-grupin e ILD-së për sa i përket trajnimeve mbi koncepte dhe parime, ata u shprehën se inspektorët magjistratë ndjekin trajnimet e Shkollës së Magjistraturës.<sup>225</sup> Në studimin e kalendarit të trajnimeve të publikuar nga Shkolla e Magjistraturës për vitin 2023-2024<sup>226</sup>, vërejmë se nga 161 trajnime të parashikuara me tema specifike ligjore që lidhen me çështje ligjore, vetëm tre prej tyre lidhen

---

luftën e SPAK kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, në momentin që GJKKO dhe SPAK do të bëheshin operacionale.

<sup>218</sup> A Dyrmishi, Albanian Security Barometer, National Survey, CSDG, (2020). <[https://csdgalbania.org/ep-content/uploads/2021/03/Security\\_barometer\\_2020\\_ENGLISH-ËEB.pdf](https://csdgalbania.org/ep-content/uploads/2021/03/Security_barometer_2020_ENGLISH-ËEB.pdf)>

<sup>219</sup> A Dyrmishi, R Shehu, Albanian Security Barometer, National Survey, CSDG (2021), f 11. <<https://csdgalbania.org/ep-content/uploads/2022/01/Barometer-2021-Albania-1-ENG-1.pdf>>

<sup>220</sup> A Dyrmishi, Albanian Security Barometer, National Survey, CSDG (2022), f 60. <<https://csdgalbania.org/ep-content/uploads/2022/06/ASB-2022-ENG.pdf>>

<sup>221</sup> M Hallunaj, N Strati, Public Perception towards security and justice institutions and corruption issues in Albania, Albanian Security Barometer, National Survey, CSDG (2023), f 18. <[https://csdgalbania.org/ep-content/uploads/2023/01/ËBSB-2022\\_Albania-Report-2\\_Jan-2023\\_ENG.pdf](https://csdgalbania.org/ep-content/uploads/2023/01/ËBSB-2022_Albania-Report-2_Jan-2023_ENG.pdf)>

<sup>222</sup> European Union, Best practice guide for managing supreme courts (2017).

<sup>223</sup> ibid.

<sup>224</sup> Opinion no. 4 (2003) of the Consultative Council of European Judges (CCJE) to the attention of the committee of ministers of the council of europe on appropriate initial and in-service training for judges at national and european levels, council of europe (2003). <<https://rm.coe.int/1680747d37>>

<sup>225</sup> Ndërsa inspektorët jo-magjistratë jo. Kjo gjë shihet si një shkelje mbi përgatitjen dhe formimin e karakterit dhe kulturës gjyqësore në insitucion, i cili duhet të rivlerësohet.

<sup>226</sup> <<https://www.magjistratura.edu.al/sq/kalendari-i-trajnimeve>>





me formësimin e vlerave në kulturën gjyqësore shqiptare.<sup>227</sup> Por, në rastin kur Bell thotë se "vlera të përbashkëta, si 'pavarësia e gjyqësorit', marrin kuptime të ndryshme në kultura gjyqësore të ndryshme"<sup>228</sup>, mendimi ynë është që ekziston një mungesë e mendimit kritik mbi atashimin e vlerave dhe standardeve në mënyrë arbitrare në sistemin tonë gjyqësor. Kjo kontribuon në një pavarësi fiktive, ku sipas pjesëtarëve të fokus-grupit dhe disa prej të intervistuarve, me parashikimin në nivel kushtetues për ndarjen e pushteteve dhe pavarësisë së gjyqësorit, gjyqësori është i pavarur. Në mbështetje të tezës së Bell, koncepti i gjyqësorit të pavarur duhet parë "i lidhur ngushtësisht me një shtet të caktuar, gjatë një periudhë të caktuar, duke parë me kujdes kontekstin historik he politik në të cilën do të zbatohet".<sup>229</sup> Dhe si rrjedhojë, niveli i vërtetë i pavarësisë së gjyqësorit do të evidentohet jo vetëm nga ndryshimet ligjore dhe strukturore të sistemit, por dhe nga niveli i kuptimit dhe operacionalizmit të gjyqësorit nga nëpunësit që punojnë në këtë sistem.

Së fundmi, për të dhënë një panoramë më të gjerë në lidhje me performancën e ILD-së në rritjen e besimit, ne kemi marrë dhe perceptimet e gjyqtarëve, prokurorëve, anëtarë të KLGJ dhe anëtarë të KLP me anë të intervistave. Të intervistuarit shprehen në unanimitet se kuadri ligjor në fuqi për garantimin e pavarësisë dhe ndarjes së ILD-së është i përshtatshëm, i mirë dhe shterues. Ata evidentojnë se problemi qëndron tek zbatimi në praktikë i tij. ILD vlerësohet se ka nevojë për burime njerëzore dhe staf të specializuar, aktualisht ka mungesa në radhët e inspektorëve profili gjyqtar, si dhe duhen gjetur format dhe mekanizmat e duhur për të rekrutuar staf cilësor të profileve të ndryshme. Nevojitet të ekzistojë vullneti i të gjithë aktorëve që ILD të kryejë në mënyrë adekuate rolin dhe detyrat e saj.

Të intervistuarit kanë evidentuar një sërë problematikash të cilat ndikojnë në arritjen e pavarësisë së plotë të gjyqësorit, probleme të cilat lidhen me anën financiare dhe atë funksionale. Konsiderohen si të tilla, konfigurimet e reja në piramidën e sistemit të drejtësisë, të cilat kanë sjellë konfuzion, e ndihmuar kjo nga individët që përfaqësojnë në këshilla, sidomos pjesa civile që ka mangësi të theksuara profesionale dhe dëshirën për t'u ndjerë "omnipotent". Një nga problematikat që sillen në vëmendje nga të intervistuarit është hendeku në edukim midis magjistratëve "të rinj" dhe atyre "të vjetër". Kjo bën që edhe vendimet gjyqësore për të njëjtat çështje apo rrethana të jenë shpesh herë të ndryshme. Institucioni që duhet të unifikojë praktikën është Gjykata e Lartë e cila ndërkohë ka

---

<sup>227</sup> Trajnimi 1, Komunimi Jo-Verbal për Gjyqtarët. Trajnimi 149, Aftësitë oratore; Gjuha e takimeve Përqendrimi në të folurit, të shkruarit, aftësitë e të lexuarit dhe të dëgjuarit. Trajnimi 150, "Kuptimi, respektimi i normave etike dhe Integriteti i gjyqtarit", si kushte themelore për një gjyqësor të besueshëm". F Caka dhe E Mërkuri në "Judicial Culture and the Role of Judges in Developing the Laë in Albania" janë ndalur në rëndësinë e trajnimit mbi aftësi të buta, dhe rëndësinë e edukimit ligjor mbi interpretimin më të mirë të normave ligjore dhe debatit mbi zhvillimin e ligjit.

<sup>228</sup> J Bell, *Judicial Cultures and Judicial Independence*, Cambridge University Press.

<https://doi.org/10.5235/152888712802761798> P

<sup>229</sup> *ibid*, f 60.



mijëra çështje të pashqyrtuara. Pavarësia e gjyqësorit nuk sigurohet vetëm me integritetin e trupës gjyqësore por edhe me pavarësinë financiare të tij, i cili në rastin konkret ka qenë tejet i kufizuar apo i varur nga vullneti i pushtetit ekzekutiv. Të intervistuarit shprehen se sistemi gjyqësor dhe institucionet e tij mund të jenë të pavarur kur Kuvendi dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë t'ju japin autonominë financiare.

Një aspekt interesant është konstatimi se të intervistuarit nuk e shohin gjyqësorin të izoluar nga ndikimet politike. Në asnjë moment sistemi i vetëqeverisjes gjyqësore nuk mund të jetë i izoluar nga politika, ku gati gjysma e kompozicionit të këshillave është e përbërë me persona të zgjedhur nga politika. Është e pamundur të jesh i pavarur nga politika për sa kohë në praktikë ndodh që Ministri i Brendshëm bën deklaratat politike në media, me ankesa në ILD ku kërkon të procedohet një magjistrat pasi ka shpallur të pafajshëm një individ. Pavarësia i referohet lirisë nga presionet e jashtme mbi vendimmarrjen gjyqësore dhe nënkupton ekzistencën e garancive kundër ndikimeve të papërshtatshme mbi gjyqtarët gjatë kryerjes së rolit të tyre gjykues.

Një element shumë domethënës është vlerësimi që i bëhet KLGJ dhe KLP nëse ato mbrojnë efektivisht interesat e gjyqtarëve apo elitave politike dhe/ose biznesit, si dhe nëse vendimet e tyre, nxiten nga interesat e tyre individuale, apo nga motivimi për të mbështetur pavarësinë e gjyqësorit. Në disa raste, disa të intervistuar kanë preferuar të mos përgjigjen. Të tjerë e vlerësojnë KLGJ pozitivisht, si një institucion që ka vepruar dhe vazhdon të veprojë duke mbrojtur interesat e gjyqtarëve. Tregues i kësaj qasje madje janë deklaratat për shtyp në mbrojtje të magjistratëve, pavarësisht se ka dalë kundër moralit të qytetarëve, sikurse mund të përmendet rasti i magjistrates Suela Dashi. Krejt e kundërta vërehet për KLP. Për këtë organ, vlerësimi është jo pozitiv, duke e cilësuar si një organ klientelist, me të shkuar dhe të ardhme të errët për shkak të 'pazareve' që bëhen. Sipas vlerësimit të një të intervistuarit, në KLP vlerat nuk promovohen. Madje në vëmendje silltet një rast ilustrues për të kuptuar atë çka përfaqësojnë të punësuarit në këtë organ, duke ju referuar një video në YouTube, ku festohet ditëlindja e njërit prej anëtarëve. KLP gjithashtu etiketohet si një organ që mbron ekskluzivisht interesat e veta, duke bërë auto promovime, sikurse ka pasur raste që në kundërshtim me ligjin duke qenë anëtarë të këshillit, janë promovuar dy prej tyre, e gjithashtu një i tretë pasi mbaroi mandatin si anëtar këshilli, në kundërshtim me ligjin e caktoi veten drejtues me vendimmarrje të përbashkët. Ndërkohë që ka pasur dhe raste kur janë bërë prokurorë njerëz të cilët ishin shkarkuar më parë me dekret Presidenti.

Në tërësi, të intervistuarit ngrenë problemin në mënyrë alarmante se nëse KLGJ dhe KLP marrin vendime në bazë të interesave personale, atëherë sistemi një ditë do të bjerë dhe ndryshimet kushtetuese nuk do të kenë efekt.



Në lidhje me pyetjen nëse sistemi për disiplinimin dhe sanksionimin e gjyqtarëve/prokurorëve është i përshtatshëm, efektiv dhe i pavarur nga ndikimet e jashtme, të intervistuarit janë shprehur se problemet nuk vijnë nga ligji por nga njerëzit. Kuadri ligjor është mëse i mjaftueshëm, madje janë miratuar edhe rregulla etike nga ana e Këshillave, pra kuadri është i plotë. Një prej të intervistuarve shprehet se drejtësia e re udhëhiqet nga një mentalitet i vjetër me qasje negative. Ndërkohë, një tjetër i intervistuar shprehet se proceset e disiplinës janë pjesë përbërëse e të gjithë pasqyrës së reformës në drejtësi. Vlerësimi, zhvillimi i karrierës dhe disiplina janë shtylla kryesore të nevojshme në këtë proces. Për sa i përket vlerësimit të efektivitetit dhe ndikimeve, mbetet subjektive dhe ka vend për diskutim rast pas rasti.

Përsa më sipër, në këto pak vite ekzistencë, ILD ka treguar se pavarësisht sfidave, ka luajtur një rol të qenësishëm në sistemin e vetëqeverisjes gjyqësore shqiptare, duke prodhuar të dhëna faktike në kuadër të konsolidimit të parimit të ligjshmërisë dhe forcimit të pavarësisë dhe efikasitetit të sistemit të drejtësisë.

Në seksionin vijues, do të ndalemi në pikën e fundit të këtij studimi, mbi elementët e kulturës gjyqësore në Shqipëri.



## 5 Formalizmi dhe mungesa e mendimit kritik, si karakteristika të kulturës

Studiuesi Preshova, në vlerësimin e tij për kulturën gjyqësore në Maqedoninë e Veriut, vëren se edhe nëse rregullat formale dhe strukturat institucionale janë në përputhje me standardet evropiane, pengesat në arritjen e atij standardi të artë të gjyqësorit vazhdojnë. Hipoteza e tij është se pengesat mund të gjenden jashtë kornizës formale institucionale dhe se transformimi i praktikave informale dhe kulturës gjyqësore është ngushtësisht i lidhur me edukimin ligjor dhe trajnimin e vazhdueshëm gjyqësor.<sup>230</sup>

Situata reflektohet ngjashëm dhe nga përgjigjet e të intervistuarve në këtë studim. Në rastin kur të intervistuarit pyeten nëse ka mosbesim se sistemi po ruan interesat politike në gjyqësor, në vend të pavarësisë së gjyqësorit. Thuhet në unanimitet të plotë, të intervistuarit shprehen se ekziston një atmosferë mosbesimi në radhët e prokurorëve dhe gjyqtarëve mbi pavarësinë e gjyqësorit. Procesi i vettingut ka krijuar një mosbesim ndaj trupës së gjyqësorit dhe ajo pjesë që e ka kaluar me sukses atë, shihet me hije dyshimi dhe mosbesimi. Mosbesimi është në rritje dhe i vërtetuar madje me prova hera herës.

Në rastin kur pyeten nëse ka klientelizëm në sistemin gjyqësor që çon në apati dhe pasivitet të përgjithshëm në kërkimin e pavarësisë së gjyqësorit, pjesa dërrmuese e të intervistuarve shprehet se ky fenomen ekziston. Fatkeqësisht vihet re se me kalimin e kohës magjistratët janë të lodhur për sa kohë zëri i tyre nuk dëgjohet. Magjistratët nuk janë vetëm SPAK dhe kush prodhon lajme në kronikën e zezë. Ka pasivitet të përgjithshëm si pasojë e mos zgjidhjes së problemeve të kaluarës. Vetëm njëri prej të intervistuarve shprehet se klientelizëm të tillë nuk ka.

Për sa kohë ende nuk ka një analizë të performancës për të gjithë komponentët në institucionet që ka prodhuar reforma në drejtësi, ka një hendek midis rregullave formale dhe strukturës institucionale. Në raste të caktuara ekziston informalitet në vendimmarrje.

Referuar konceptit se vlerat dhe parimet janë të rëndësishme për shndërrimin e sistemit në një sistem realisht të pavarur, një pjesë e të intervistuarve mendojnë se vlerat që ndajnë magjistratët janë të rëndësishme dhe pjesa dërrmuese e tyre ndajnë të njëjtën pikëpamje për një sistem të pavarur. Por qasja e politikës që kërkon përherë të ndërhyjë, pavarësisht asaj që predikon, tregon se politika nuk është shkëputur kurrë nga gjyqësori. Vlerat dhe parimet duhet që jo vetëm të ekzistojnë si koncept por duhet të jenë të aplikueshme efektivisht. Të intervistuarit janë të ndarë në dy qëndrime të ndryshme kur bëhet fjalë për të vlerësuar nëse nga

---

<sup>230</sup> D Preshova, Separate but not Independent: The (In)Combatibility of the Judicial Culture ëith Judicial Culture ëith Judicial Self-governance in North Macedonia (2022), f 38.



sistemi ka vëmendje ose jo, zhvillimin e kushteve adekuate për promovimin e vlerave dhe parimeve të pavarësisë së gjyqësorit. Disa mendojnë se ka një qasje dhe shtyrje drejt promovimit të këtyre vlerave dhe ndërgjegjësimit të shoqërisë për to. Ndërkohë që disa të tjerë mendojnë se sistemi nuk e ka në vëmendje diçka të tillë. Drejtësia e re konsiderohet njësoj si drejtësia e vjetër, me dallimin se ndryshojnë vetëm emrat dhe niveli i të qenit i paskrupullt.

Pa diskutim që rol të rëndësishëm në arritjen e objektivave të përcaktuara nga drejtësia, luajnë mentaliteti dhe zakonet ekzistuese. Për këtë, nevojitet një përpjekje e madhe shoqërore që mentaliteti i vjetër të ndryshojë. Jo çdo ndryshim vjen nga ndryshimet ligjore. Përbushja e objektivave ndikojnë tek ndryshimi. Një ndër objektivat e vëna nga drejtësia është rritja e besimit të publikut, por rritja e besimit të publikut nuk matet vetëm përmes intervistave televizive apo fushatave informuese. Nëse magjistratit i plotësohen kushtet të punojë në ngarkesë optimale, atëherë dhe vendimarrja është më cilësore. Besimi i publikut rritet, kështu gradualisht ndryshon dhe ndikimi që ka mentaliteti dhe zakonet në arritjen e objektivave të përcaktuara nga drejtësia.

Një aspekt interesant për të cilin janë pyetur të intervistuarit është vlerësimi që ata kanë për sistemin ekzistues të arsimit ligjor, nëse po u siguron anëtarëve (të rinj dhe të vjetër) të gjyqësorit (magjistratët, anëtarët e këshillave, etj.) mësimin adekuat mbi pavarësinë e gjyqësorit. Thuajse të gjithë shprehen se forma dhe qasja e sistemit arsimor në krijimin e gjyqtarëve të rinj, ka krijuar një qasje jo shumë të mirë dhe ka nevojë për ristrukturim dhe riformim. Fakt është që në brezat e rinj të gjyqësorit vihet re arrogancë dhe mungesa e dëshirës për të mësuar. Prurjet e tepërta nga Shkolla e Magjistraturës kanë ulur ndjeshëm nivelin kulturor, profesional dhe personal të brezave të rinj të magjistratëve.

Shqetësues është konstatimi që vjen nga përgjigjet e të intervistuarve kur shprehen se ekziston një atmosferë mosbesimi në radhët e prokurorëve dhe gjyqtarëve mbi pavarësinë e gjyqësorit. Një aspekt domethënës është konstatimi se magjistratët ndihen të lodhur për sa kohë zëri i tyre nuk dëgjohej. Qasja e politikës që kërkon përherë të ndërhyjë, tregon se politika jo vetëm nuk është shkëputur nga gjyqësori por edhe ndikon negativisht në cenimin e vlerave dhe parimeve të magjistratëve. Pavarësisht emrave të rinj, drejtësia e re ka ende pasqyrimin e drejtësisë së vjetër.

Gjatë kryerjes së fokus-grupit me ILD-në, përgjigjet e inspektorëve magjistratë/këshilltarë reflektojnë gjetjet nga studiuesit Caka dhe Mërkuri.<sup>231</sup> Caka dhe Mërkuri, në analizën e tyre mbi kulturën gjyqësore dhe rolin të gjyqtarëve në zhvillimin e ligjit në Shqipëri, shprehen se gjyqtarët e kufizojnë pavarësinë e tyre

---

<sup>231</sup> F Caka, E Mërkuri, Judicial Culture and the role of judges in developing the laë in Albania (2021).



në interpretimin e ngushtë të ligjit, duke mos tejçuar vlera morale në vendimet e tyre.<sup>232</sup> Në vijim, studiuesit gjejnë se

*Kur gjyqtarët perceptojnë se ekzekutivi po i kontrollon ata, ata priren të shkojnë drejt formalizmit, të glorifikojnë ligjin si vullnetin e shumicës, të hezitojnë për të goditur akt të qeverisës, dhe të përputhen sa më shumë që është e mundur me politikat e tyre të brendshme. Formalizmi është parë si një mburojë kundër kërcënimeve të mundshme të së ardhmes nga qeveria, duke qënë se kur diçka parashikohet nga ligji, konsiderohet se është e barabartë me të qënit e drejtë.<sup>233</sup>*

Të dheënat nga fokus-grupi me zyrtarë e ILD-së tregojnë se ka hezitim në përfshirjen e kulturës si kriter analitik dhe operacional për të orientuar punën për zbatimin e reformës, ç'ka tregon për një horizontalitet në qasjen formaliste tek institucionet e drejtësisë.

---

<sup>232</sup> ibid, f 29.

<sup>233</sup> ibid, f 30.



## 6 Përfundime

Ky studim bën një përpjekje për të trajtuar sistemin e drejtësisë në një mënyrë holistike, duke parë ndryshimin në *status quo* me prezantimin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Duke analizuar rolin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe elementin e kulturës së pavarësisë të gjyqësorit, ky punim ka si qëllim të parin e sistemit të drejtësisë me një lente tjetër.

Para këtij studimi, disa hulumtime të tjera kanë gjetur që "ndryshimet kushtetuese dhe ligjet e reformës në drejtësi kanë themeluar një numër mekanizmesh që synojnë një gjyqësor të pavarur dhe jo të korruptueshëm. Gjithsesi, implementimi i tyre në praktikë varet nga disa faktorë, ndër të tjera kultura gjyqësore".<sup>234</sup>

Sistemi gjyqësor në këto 30 vite drejtësi ka kaluar disa reforma, të cilat mbështeten në të njëjtat themele: korrupsioni, ndërhyrje e politikës në gjyqësor, cenim të të drejtave të njeriut, duke përmendur disa. Me reformën në drejtësi dhe prezantimin e institucioneve të reja të drejtësisë, sistemi gjyqësor aktual është dizajnuar sipas standardeve më të mira të pavarësisë dhe funksionimit të gjyqësorit, të cilat ndoshta mund të mos zbatohen dhe në disa modele kulturash gjyqësore në vendet e Bashkimit Evropian. Por, mosparashikimi ligjor i disa standardeve nuk sjell gjithnjë cenim të parimit të pavarësisë gjyqësore, ashtu sic parashikimi i tyre nuk sjell domosdoshmërisht pavarësinë e gjyqësorit. Në të gjitha rastet, pavarësisht modelit të gjyqësorit, elementi i përbashkët i kulturave gjyqësore pozitive është garantimi i të drejtave të njeriut, besim në sistemin gjyqësor dhe promovim i drejtësisë së pavarur.

ILD-ja ka perspektivën dhe kuadrin ligjor tepër adekuat për të ndryshuar qasjen e kulturës gjyqësore në Shqipëri. Ndërmjet standardit që vendos gjatë hetimeve dhe nisjes së procedimeve disiplinore, si dhe me anë të inspektimeve tematike dhe raporteve, ky institucion mund ndikojë në ndryshimin e qasjes pozitiviste të pjesëtarëve të gjyqësorit ndaj parimeve themelore të ligjit.

---

<sup>234</sup> A Anastasi, 'The Albanian justice reform in the framework of the European integration process', f 20.



## 7 Rekomandime

Kultura gjyqësore shqiptare reflekton ndikimet historike, sociale dhe ligjore që i japin formë sjelljeve dhe qasjeve të individëve brenda gjyqësorit, si dhe gjyqësorit në tërësi. Ajo përfshin aspekte si perceptimi i pavarësisë së gjyqësorit, ndjekja e parimeve ligjore, standardet etike, si dhe qasja ndaj interpretimit dhe aplikimit të ligjit.

Në vitet e fundit janë bërë përpjekje për të përmirësuar kulturën gjyqësore në Shqipëri, duke synuar nxitjen e transparencës, llogaridhënies dhe profesionalizmit brenda gjyqësorit. Kjo përfshin promovimin e vlerave të tilla si drejtësia, paanshmëria dhe respektimi i shtetit të së drejtës ndërmjet gjyqtarëve dhe profesionistëve të ligjit.

Gjithsesi, ajo çka doli si gjetje nga kombinimi i metodave të ndryshme kërkimore gjatë shkrimit të këtij hulumtimi, është se ndryshimi i ligjeve mund të ndikojë në sjelljen e gjyqësorit, por jo gjithmonë mund të përkthehet në mënyrë të drejtpërdrejte në ndryshime të menjëhershme ose gjithëpërfshirëse në sjelljen ose kulturën e gjyqësorit. Ndërsa reformat ligjore përcaktojnë kornizën dhe udhëzimet për mënyrën se si duhet administruar drejtësia, zbatimi dhe ndikimi aktual varen nga faktorë të ndryshëm, si interpretimi dhe zbatimi i ligjit, kultura institucionale, trajnimet e vazhdueshme, zbatimi i rregullt i ligjeve, si dhe perceptimi dhe besimi i publikut mbi sistemin gjyqësor. Këto elementë janë analizuar më sipër, dhe gjetjet në lidhje me to mund të evidentohen si risia e këtij studimi.

Së pari, reforma në drejtësi solli një ndryshim në strukturën e gjyqësorit, nëpërmjet themelimit të institucioneve të reja, siç janë Këshilli Gjyqësor i Lartë, Këshilli i Lartë i Prokurorisë dhe Inspektori i Lartë i Drejtësisë. Këto institucione u krijuan me detyrën kryesore për të rritur pavarësinë dhe profesionalizmin e gjyqësorit. Pavarësisht kësaj, praktikat dhe kulturat e rrënjësura historike brenda gjyqësorit, si korrupsioni, nepotizmi, apo ndikimi i paligjshëm, mund t'i rezistojë ndryshimit të menjëhershëm. Edhe me një kuadër ligjor gjithëpërfshirës, elementë kulturorë si hierarkia, zakonet, si dhe rrjetet informale, mund të jenë faktorë që mund të ndikojnë në rezistencën ndaj ndryshimit pozitiv.

Së dyti, perceptimet e kaluara dhe eksperiencat e lidhura me korrupsionin në sistemin gjyqësor ndikojnë në besimin e njerëzve të sistemi gjyqësor. Pavarësisht reformës, akoma ekzistojnë shqetësime mbi prezencën e korrupsionit apo ndikimit të paligjshëm në sistemin gjyqësor. Për këtë arsye, institucionet e sistemit gjyqësor nuk mund të konformohen në premisën se ndryshimi i kuadrit ligjor, do të rezultojë në rritjen e besimit të publikut në sistemin gjyqësor. Sistemi gjyqësor, dhe specifikisht, secila pjesë përbërëse e saj, ka nevojë të ketë një nivel më të lartë transparence në lidhje me proceset dhe vendimmarrjen e tyre. Gjithashtu,





përpjekjet për përmirësimin e kulturës gjyqësore mund të arrihen duke përmirësuar besimin e publikut në sjelljen dhe praktikën e gjyqësorit.

Së treti, nga interpretimi i disa përgjigjeve gjatë intervistave me gjyqtarë, prokurorë, dhe anëtar KLGJ apo KLP, si: *“Nuk e njoh sa duhet dhe nuk mund të shprehem për këtë çështje; Pa përgjigje; Është një pyetje me karakter tepër individual dhe nuk mund të përgjigjem për përgjithësinë; E pavërtetuar; Nuk jam në gjendje ti jap përgjigje kësaj pyetjet”* mund të dilet në konkluzionin se disa prej të intervistuarve nuk ndihen mjaftueshëm të lirshëm dhe të sigurtë në shprehjen e mendimit të tyre. Në disa raste, funksionarët e gjyqësorit mund të ndihen të kufizuar për të shprehur opinionet e tyre në lidhje me gjyqësorin, për disa faktorë të ndryshëm, si: (i) frika se mund të përballen me pasoje ose 'hakmarrje' nëse shprehin kritika ndaj sistemit duke ndikuar në karrierën e tyre; (ii) mungesa ose efektiviteti i sinjalizuesve brenda gjyqësorit që mund të pengojë individë të flasin në mënyrë kritike për çështje ose vlera anti-kulturore që mund të dëshmojnë brenda sistemit; (iii) struktura hierarrike ose norma kulturore mbizotëruese brenda gjyqësorit mund të dekurajojnë diskutimet e hapura dhe debatin konstruktiv; (iv) presionet e jashtme, duke përfshirë ndikimet politike, mund të kufizojnë lirinë e anëtarëve të gjyqësorit për të shprehur mendimet e tyre të vërteta si dhe (v) mungesa e platforma të pavarura që u japin mundësinë anëtarëve të gjyqësorit për të shprehur mospajtimet e tyre në një mënyrë të sigurtë. Në disa raste, nëse ky proces i të shprehurit mendim mund të sjellë një rezultat të dëmshëm te personi ankues, ky person mund të ndihet i prirur për të qëndruar i heshtur përkundrejt sjelljeve të dëmshme. Rrjedhimisht, kjo ndikon dhe në pavarësinë e këtij personi.

Gjithashtu, pavarësisht ndryshimeve ligjore dhe zhvillimit shoqëror ende nuk ka një shprehje nga mendësia e varësisë nga politika. Si dhe, pavarësisht se modeli i ri i qeverisjes gjyqësore krijon mundësi për të garantuar një sistem të pavarur gjyqësor, ai vijon të ketë nevojë për ndryshime ligjore si pasojë e vakumeve ligjore ekzistuese. Një rast që mund të përmendet për të përkrahur këtë gjetje është ekzistenca e evidentuar gjatë intervistave e trinitetit në konkurrencë të vazhdueshme “Prokurori i Përgjithshëm, Këshilli i Lartë i Prokurorisë dhe Drejtuesi i SPAK” për të cilët ligji jo vetëm nuk parashikon (në kuadër të decentralizimit) cili organ është i pavarur nga tjetri por me ndryshimet e fundit ligjore të vitit 2023, fuqizohet roli i “Prokurorit të Përgjithshëm” i cili ndërhyr në karrierën e magistratëve duke përmbysur kështu konceptin e “decentralizimit”.

Së katërti, prezantimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë si një institucion kyç që mundet të përmirësojë gjendjen e pavarësisë së gjyqësorit në vend konsiderohet një sfidë herkuliane, nëse nuk merren në konsideratë elementët e tjera të ekuacionit. Parimisht, kuadri ligjor për sistemin e disiplinimit dhe sanksionimit të magistratëve është i plotë. Gjithashtu, kuadri ligjor në fuqi për garantimin e pavarësisë dhe ndarjes së ILD-së është i përshtatshëm, i mirë dhe shterues. Por, ILD aktualisht ka mungesa në radhët e inspektorëve profili gjyqtar, e cila është një çështje që i duhet



dhënë prioritet. Gjithashtu, ILD ka nevojë për burime njerëzore dhe staf të specializuar. Elementi i mungesës së pavarësisë financiare është evidentuar si shqetësues si gjatë intervistave, dhe fokus-grupit.

Së pesti, aktorët që e kanë detyrim ligjor 'referimin', si drejtuesit e prokurorive edhe gjykatave, Prokurori i Përgjithshëm apo Ministri i Drejtësisë, duhet të jenë më proaktiv. ILD mund të vlerësojë ankesat e dërguara te institucioni si në nivel personal, por dhe institucional. Në rast se ndodhin sjellje në kundërshtim me ligjin dhe normat kulturore në vijueshmëri, eprori i institucionit ose personat në hierarki të cilët kanë detyrimin ligjor për të monitoruar administrimin e drejtësisë në mënyrë të rregullt, ILD mund të hetojë vetë kontekstin e lejimit të shkeljes së disiplinës nga subjekti i hetimit.

Së gjashti, në rast se pavarësia individuale dhe institucionale e gjyqësorit mbetet formalisht e lidhur me parashikimet ligjore, dhe nuk kthehet në një element kyç të kulturës gjyqësore, ky sistem mund të jetë i destinuar të dështojë në përmbushjen e misionit të tij.

Përsa i përket diskutimit në këtë hulumtim, boshti kryesor i kuptimit në lidhje me përmirësimin e kulturës gjyqësore ka të bëjë me ndryshimin e botëkuptimit se ndryshimi i ligjit sjell domosdoshmërisht ndryshimin e sjelljes apo kulturës gjyqësore, të formësuar nga sjellje, zakone dhe norma historike, sociale dhe ligjore të kultivuara prej dekadash. Pra, premisa se ndryshimet ligjore në Kushtetutë dhe ligjet vijuese pas vitit 2016, ku parashikohet një sistem i papenetrueshëm nga ekzekutivi apo ndikime të paligjshme, nuk ka një bazë të fortë logjike për të qëndruar si argument. Për këtë arsye, shihet si domosdoshmëri një ndryshim thelbësor kulturor brenda gjyqësorit për të praktikuar pavarësinë e vertetë gjyqësore. Në këtë vijë logjike, ky dokument diskutimi propozon rekomandimet vijuese për sa i përket përmirësimin të kulturës gjyqësore në Shqipëri:

- Të evitohen ndërhyrjet në sistemin e drejtësisë si dhe të rriten përpjekjet për pavarësinë e tij;
- Edukimi është baza mbi ku mund të ngrihet reformimi i kulturës gjyqësore në Shqipëri. Programe dhe iniciativa edukuese me fokus anëtarët e gjyqësorit do të ishte pikënisja e duhur për të nisur një ndryshim në kulturën gjyqësore. Trajnimet nuk duhen fokusuar vetëm në ndryshimet ligjore apo strukturore, por dhe në krijimin e një botëkuptimi të thellë mbi parimet dhe rëndësinë e pavarësisë gjyqësore. Gjithashtu, këto programe afatgjata trajnimi, me fokus përforsimin e vlerave të kulturës gjyqësore në vend, mund të përfshijnë trajnime mbi etikën profesionale dhe integritetin, pavarësinë gjyqësore, komunikimin transparent, dhe respekti mbi sundimin e ligjit. Gjyqësori ka



nevojë për më tepër punë në brendësimin e vlerave të tilla, si dhe të kuptuarin e rëndësisë së parimeve juridike;

- Promovimi i rëndësisë së një kulture gjyqësore të fortë, që ka në fokus advokimin mbi pavarësinë, integritetin, dhe sjelljen etike. Kjo mund të arrihet nëpërmjet fushatave ndërgjegjësuese, forumeve, dhe bashkëpunimeve me organizata ndërkombëtare ose ekspertë që specializohen në zhvillimin e kulturës gjyqësore;
- Përmirësimin e dialogut dhe bashkëpunimit ndërmjet ILD, KLGJ dhe KLP mbi rëndësinë e përmirësimit dhe mënyrës së përmirësimit të kulturës gjyqësore në institucionet e tyre, si reflektim i gjyqësorit në tërësi;
- Për të adresuar problemet ekzistuese me pavarësinë e gjyqësorit duhet të arrihet pavarësia ekonomike, të rritet bashkëpunimi ndër-institucional, të zhvillohen fushata sensibilizimi dhe edukim ligjor në komunitet, magjistratët të përfaqësohen në shoqata të vetme dhe jo të fragmentarizuara, të forcohet parimi i meritokracisë në promovim dhe trajtim financiar, si dhe të përzgjidhen kandidatë me nivel formimi të lartë dhe cilësor;
- Sistemit arsimor në krijimin e magjistratëve të rinj ka nevojë për ristrukturim dhe riformim, si dhe të zhvillohen trajnime të vazhdueshme nga Shkolla e Magjistraturës, veçanërisht për sa i përket kultivimit të kulturës gjyqësore;
- Në mënyrë të tillë që vendimmarrja të jetë më cilësore, nevojitet që magjistratëve t'u plotësohen kushtet të punojnë me ngarkesë optimale, si dhe zhvillimin e kushteve adekuate për promovimin e vlerave dhe parimeve të pavarësisë së gjyqësorit.

Së fundmi, ky studim evidenton boshllëqe në literaturë në lidhje me reflektimin e ndryshimeve ligjore dhe implementimin e tyre, si dhe fokusin në çështje mikro të problemeve dhe sfidave të sistemit gjyqësor. Ky studim njeh limitet se nuk mund të pasqyrojë të gjitha elementët që mund të ndikojnë në kulturën gjyqësore apo mënyrat se si mund të përmirësohet ajo. Thënë kjo, duke përdorur metoda të ndryshme të hulumtimit, si analiza krahasimore, intervista dhe fokus grupe, synuam të trajtojmë në mënyrë holistike të gjitha pikëpamjet mbi pavarësinë dhe kulturën gjyqësore të pavarësisë. Gjithsesi, kultura gjyqësore është një element joformal i cili nuk mund të matet me indikatorë, dhe aq më pak në vakum. Për këtë arsye, rekomandimi kryesor i këtij dokumenti diskutimi është thellimi i mëtejshëm nga hulumtues të fushës mbi përmirësimin e kulturën gjyqësore në Shqipëri.



# Bibliografia

## Legjislacion

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë
- Ligji nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar
- Ligji nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.
- Ligj nr.98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”
- Ligj nr. 97/2016 për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”
- Ligj nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i përditësuar"
- Ligj nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, i përditësuar
- Ligj nr. 115/2016 për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë
- Ligj nr.49/2012 "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”
- Vendim i këshillit të ministrave për krijimin e kushteve për inspektorin e lartë të drejtësisë për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe të kriterëve ligjore, verifikimin e figurës e të pasurisë së kandidatëve jomagjistratë për pozicionin e inspektorit

## Dokumente ndërkombëtare

- Basic Principles on the Independence of the Judiciary. 1985  
<https://www.ohchr.org/en/instruments-mechanisms/instruments/basic-principles-independence-judiciary>
- European Council (1993), Presidency Conclusions, Copenhagen, 21-22 June, available at: [www.consilium.europa.eu/media/21225/72921.pdf](http://www.consilium.europa.eu/media/21225/72921.pdf)
- United Nations, Bangalore Principles of Judicial Conduct (“Bangalore Principles”) 2003.  
<https://www.unodc.org/documents/ji/training/bangaloreprinciples.pdf>
- United Nations, Basic Principles on the Independence of the Judiciary.  
<https://www.ohchr.org/EN/ProfessionalInterest/Pages/IndependenceJudiciary.aspx>



- Council of Europe (2010), Judges: Independence, Efficiency and Responsibilities. Recommendation CM/Rec(2010)12 and Explanatory Memorandum. <https://rm.coe.int/16807096c1>
- CCJE (2010), Magna Carta of Judges (Fundamental Principles). <https://rm.coe.int/168063e431>
- Venice Commission (2010), Report on the Independence of the Judicial System. Part I: The Independence of Judges. <https://rm.coe.int/1680700a63>
- Council of Europe Plan of Action on “Strengthening judicial independence and impartiality” was adopted by the Committee of Ministers. April 2016. <https://rm.coe.int/1680700125>
- Review of the implementation of the Council of Europe Plan of Action on Strengthening Judicial Independence and Impartiality. November 2022. <https://rm.coe.int/cdcj-2022-07e-sofia/1680a930ee>

## Studime

- S. Benvenuti and D. Paris, ‘Judicial Self-Government in Italy: Merits, Limits and the Reality of an Export Model’ (2018) 19 German Law Journal 7, 1642-1643.
- P. Castillo-Ortiz, ‘The Politics of Implementation of The Judicial Council Model in Europe’ (2019) European Political Science Review 11, 505.
- L. Louërese, and E. Kassoti, ‘Revisiting the European Commission’s Approach towards the Rule of Law in Enlargement’ (2019) Hague Journal on the Rule of Law, Vol. 11, No. 1 (April) 223-250.
- Damjanovski, C. Hillion and D. Preshova, ‘Uniformity and Differentiation in the Fundamentals of EU Membership: The EU Rule of Law Acquis in the Pre- and Post-accession Contexts’ (2020) EU IDEA Research Paper No. 4, Istituto Affari Internazionali,
- M. Bobek, ‘The Fortress of Judicial Independence and The Mental Transitions of The Central European Judiciaries’ (2008) 14 European Public Law, 101.
- D. Kosař (ed.) ‘Judicial Self-Governance in Europe’. Volume 19 No 7 (2018). <https://germanlawjournal.com/vol-19-no-7/>.
- H. Petter Graver and P. Čuro, ‘Judges Under Stress: Understanding Continuity and Discontinuity of Judicial Institutions of the CEE Countries’. German Law Journal , Volume 22 , Special Issue 7: Judges Under Stress , October 2021 , pp. 1147 - 1158.
- M. Urbanikova and K. Šipulová, ‘Failed Expectations: Does the Establishment of Judicial Councils Enhance Confidence in Court?’ Model’ (2018) 19 German Law Journal 7, 2135.



- M. Tushnet, 'The New Fourth Branch: institutions for protecting constitutional democracy'. Cambridge University Press (2021).
- G. Gee, 'The Persistent Politics of Judicial Selection: A Comparative Analysis', in A. Seibert-Fohr (ed.) Judicial Independence in Transition (Heidelberg: Springer 2012), 132-133.
- S. Shetreet, and C Forsyth, eds, 'The culture of judicial independence: conceptual foundations and practical challenges'. Martinus Nijhoff Publishers, 2011
- J Omejec, 'Strengthening Confidence in the Judiciary Appointment, promotion and dismissal of judges and ethical standards'. [https://www.echr.coe.int/documents/d/echr/Speech\\_20190125\\_Omejec\\_J\\_Y\\_ENG](https://www.echr.coe.int/documents/d/echr/Speech_20190125_Omejec_J_Y_ENG).
- J Hamilton, 'Prosecutorial Independence and Accountability. Venice Commission 2011. [https://www.venice.coe.int/ëebforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-UDT\(2011\)008-e](https://www.venice.coe.int/ëebforms/documents/default.aspx?pdffile=CDL-UDT(2011)008-e).
- The Independence of Prosecutors in Eastern Europe, Central Asia and Asia Pacific. OECD (2020). <https://www.oecd.org/corruption/The-Independence-of-Prosecutors-in-Eastern-Europe-Central-Asia-and-Asia-Pacific.pdf>.
- Guidelines on the Role of Prosecutors, UN (1999). <https://www.ohchr.org/sites/default/files/prosecutors.pdf>.
- The Status and Role of Prosecutors: A United Nations Office on Drugs and Crime and International Association of Prosecutors Guide, UNODC/IAP (2014). [https://www.unodc.org/documents/justice-and-prison-reform/14-07304\\_ebook.pdf](https://www.unodc.org/documents/justice-and-prison-reform/14-07304_ebook.pdf).
- The Role of Public Prosecution in the Criminal Justice Systems, Committee of Ministers of Justice of the Council of Europe (2000). <https://rm.coe.int/16804be55a#:~:text=In%20all%20criminal%20justice%20systems%2C%20public%20prosecutors%3A%20%2D%20decide%20ëhether,all%20or%20some%20court%20decisions>.
- Report on European Standards as regards the Independence of the Judicial System: Part II, the Prosecution Service, Venice Commission (2008). <https://rm.coe.int/1680700a60>

## Raporte

- Rezoluta e Kuvendit "Për vlerësimin e veprimtarisë së Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për vitin 2022"



- EU Justice Scoreboard (from 2013 to 2023). [https://commission.europa.eu/strategy-and-policy/policies/justice-and-fundamental-rights/upholding-rule-laë/eu-justice-scoreboard\\_en](https://commission.europa.eu/strategy-and-policy/policies/justice-and-fundamental-rights/upholding-rule-laë/eu-justice-scoreboard_en)
- European Network of Council for the Judiciary (ENCJ). Reports and data from surveys: <https://www.encj.eu/node/250>
- Horizontal Facility joint-cooperation initiative of the EU and the CoE for the Western Balkans and Turkey - Phase I. <https://www.coe.int/en/ëeb/tirana/horizontal-facility-for-ëestern-balkans-and-turkey>
- Horizontal Facility joint-cooperation initiative of the EU and the CoE for the Western Balkans and Turkey - Phase II. <https://www.coe.int/en/ëeb/ankara/horizontal-facility-for-the-ëestern-balkans-and-turkey>
- Horizontal Facility joint-cooperation initiative of the EU and the CoE for the Western Balkans and Turkey - Phase III (from 2023 until 2026). [https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2018-12/ipa\\_ii\\_2018\\_040-113.05\\_mc\\_eu-coe\\_horizontal\\_facility.pdf](https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2018-12/ipa_ii_2018_040-113.05_mc_eu-coe_horizontal_facility.pdf)
- <https://pjp-eu.coe.int/en/web/horizontal-facility/home>

#### Faqe në internet

- Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. <https://ild.al/>
- Këshilli i Lartë Gjyqësor. <https://klgj.al>
- Këshilli i Lartë i Prokurorisë. <https://klp.al>
- Gjykata Kushtetuese. <https://www.gjk.gov.al>
- Gjykata e Lartë. <http://www.gjykataelarte.gov.al>
- Gjykata e Posaçme. <https://www.gjp.gov.al>
- Prokuroria e Përgjithshme. <https://www.pp.gov.al>
- Prokuroria e Posaçme. <https://spak.gov.al>
- Byroja Kombëtare e Hetimit. <https://bkh.al/category/bkh/>
- Shkolla e Magjistraturës. <https://www.magjistratura.edu.al/sq/>